



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 461 Akti

Nr. 491 Vendimi  
Tiranë, më 21.12.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Kryesuese
<b>Olsi Komici</b>	Relator
<b>Xhensila Pine</b>	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datën 21.12.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Gjon Kodra**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

**OBJEKTI:** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, dëgjoji subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore publike në tërësinë e tij vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Gjon Kodra, i cili kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Subjekti i rivlerësimit Gjon Kodra ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në bazë të nenit 179/b/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit u shortua me shortin e datës 16.12.2019 dhe do t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Xhensila Pine, Valbona Sanxhaktari dhe Olsi Komici. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioner Olsi Komici.
3. Me vendimin e datës 9.1.2020, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e subjektit të rivlerësimit Gjon Kodra, për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; si dhe rivlerësimin e aftësive profesionale. Si kryesuese e trupit gjykues u caktua komisionere Valbona Sanxhaktari.
4. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Subjekti deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Gerrit Sprenger.
5. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Grupi i Punës në Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.
6. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.
7. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Gjon Kodra, si dhe njoftimin tij për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.
8. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 19.11.2021 mbi përbërjen e trupit gjykues, rezultatet e hetimit, si dhe mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfutuara nga hetimi kryesisht zhvilluar nga Komisioni.

9. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe dosjen, në datën 1.12.2021, me anë të postës elektronike, kërkoi nga Komisioni zgjatje afati për prapësimet e tij dhe sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm për arsye të marrjes në shtetin italian.

10. Komisioni, me anë të postës elektronike, njoftoi subjektin se vendosi të pranojë kërkesën e tij për shtyrje të afatit të dërgimit të prapësimeve dhe provave të nevojshme, duke i dhënë një afat të ri deri në datën 13.12.2021.

11. Subjekti i rivlerësimit, në datën 13.12.2021 ka dërguar me postë elektronike dhe dorazi në protokollin e Komisionit prapësimet e tij për rezultatet e hetimit të dërguar, si dhe provat mbi të cilat mbështeten prapësimet e tij.

12. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë në rrugë elektronike nga Komisioni në datën 13.12.2021, për seancën dëgjimore që do të zhvillohej më 17.12.2021, ora 10:00.

13. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 17.12.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger.

14. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe me avokatin e tij mbrojtës, z. P.B., të cilin e deklaroi si përfaqësues të tij në seancën dëgjimore. Subjekti dhe mbrojtësi i tij parashtruan shpjegimet e tyre. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit Gjon Kodra kërkoi konfirmimin në detyrë.

## **II. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

15. Z. Gjon Kodra ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur, kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur.

## **III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

16. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit anëtarët e Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

17. Për subjektin e rivlerësimit Gjon Kodra, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit përfshin të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; si dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

18. Pavarësisht se në kreun IV të ligjit nr. 84/2016 2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të kryer vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me këtë vlerësim pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetues dhe kreut II të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një

proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

### **A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

19. ILDKPKI-ja<sup>1</sup>, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Gjon Kodra, i cili është subjekt deklarues pranë këtij institucioni që prej vitit 2003, me nr. indeksi \*\*\*, duke konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mosdeklarim pasurie ndër vite dhe ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

### **A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

20. Bazuar në ligjin nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të kontrollit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të. Referuar neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit.

21. Subjekti i rivlerësimit Gjon Kodra e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë (duke përfshirë edhe personat e lidhur me të), në bazë të ligjit nr. 84/2016, datë 20.1.2017, brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë, shtojca 2 (deklarata *Vetting*), janë si vijojnë:

#### **Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit**

##### **1. Apartament me sip. 100 m<sup>2</sup>, Tiranë**

Ky apartament ndodhet në rrugën “\*\*\*\*”, hyrja \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, me certifikatë pronësie, datë 3.5.2016<sup>2</sup>, në bashkëpronësi me motrën e subjektit P.K. Pjesa takuese: 7/10. Burimi i krijimit: trashëguar nga prindërit dhe heqje dorë nga trashëgimia e dy motrave P.P. dhe M.L.

1.1 Agjencia Shtetërore e Kadastrës (në vijim ASHK)<sup>3</sup> konfirmon apartamentin me sip. 100 m<sup>2</sup>, në rr. “\*\*\*\*”, shk. \*\*\*, k. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, në bashkëpronësi të shtetasve Gjon dhe P.K. Nga dokumentacioni rezulton se ky apartament është përfituar nga kontrata e shitjes, datë 7.7.1998<sup>4</sup>, me shitës Gj. dhe P.P. (motra e subjektit) dhe blerës M.K. (babai i subjektit), me çmimin 1,900,000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

---

<sup>1</sup>Raporti nr. \*\*\* prot., datë 4.10.2018, i ILDKPKI-së.

<sup>2</sup>Subjekti, me deklaratën *Vetting*, ka depozituar certifikatën e pronësisë, datë 3.6.2016, për apartamentin me sip. 100 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, me adresë: rr. “\*\*\*\*”, h. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, në bashkëpronësi të Gjon Kodra me 7/10 dhe P.K. 3/10 pjesë takuese, si dhe kartelën e pasurisë për këtë apartament.

<sup>3</sup>ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tirana Veri, me nr. \*\*\* prot., datë 8.5.2020.

<sup>4</sup>Kontrata e shitjes nr. \*\*\*, datë 7.7.1998, me shitës Gj. dhe P.P. dhe blerës M.K.

1.1.1 Subjekti e ka përfituar pjesën takuese të këtij apartamenti si pasojë e: (a) testamentit të vitit 2012 të nënës së tij L.K., e cila përcakton si përfitues të pjesës së saj djalin Gjon Kodra; (b) dëshmisë së trashëgimisë testamentare të vitit 2015 për trashëgimlënësen L. K., ku përfitues janë Gjon dhe P.K.; si dhe (c) trashëgimisë ligjore të vitit 2015 të babait M. K., ku përcaktohet se shtetasit Gjon dhe P.K. trashëgojnë me 1/2 secili<sup>5</sup>.

1.2 Subjekti, i pyetur nga Komisioni me pyetësorin nr. 2 për mosdeklarimin e këtij apartamenti me sip. 100 m<sup>2</sup> në DIPP-të e viteve 2015<sup>6</sup> dhe 2016, ka shpjeguar se mosdeklarimi është harruar në mënyrë të paqëllimshme dhe se kjo është e qartë, pasi pasuria është përfituar nga trashëgimia, dhe nuk ka të bëjë me ndonjë qëllim për fshehjen e burimit të krijimit të saj.

1.2.1 Subjektit i është kërkuar të shpjegojë mospërputhjen në lidhje me pjesët takuese, pasi në certifikatën e pronësisë pasqyrohej 7/10 Gjon Kodra dhe 3/10 e motra P.K., ndërsa, sipas dëshmisë së trashëgimisë, datë 14.4.2016, ata janë trashëgimtarë me 1/2 pjesë takuese. Subjekti ka shpjeguar se është gabim i ZVRPP-së në përlllogaritjen e pjesëve takuese dhe kjo nuk e ngarkon subjektin me përgjegjësi, për sa kohë që palët e interesuara kanë të drejtën të kërkojnë ndreqjen e gabimeve sipas kërkesave ligjore.

1.2.2 Subjekti ka depozituar deklaratat noteriale për heqje dorë nga pronësia e motrave P.P., e datës 13.2.2015, dhe M.L., e datës 28.11.2015<sup>7</sup>, të cilat deklarojnë se *heqin dorë vullnetarisht nga pjesa që u takon nga trashëgimia e të ndjerit, babait M. K., duke kaluar pjesa në favor të vëllait Gjon Kodra.*

1.3 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar pasaktësi në mosdeklarimin e pjesës takuese në apartamentin me sip. 100 m<sup>2</sup> në DIPP-të e viteve 2015 dhe 2016 nga subjekti i rivlerësimit.

Për konstatimin e mësipërm, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Aneksit të Kushtetutës.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

1.4 Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me konstatimin e Komisionit, në prapësimet e tij ka shpjeguar se dëshmia e trashëgimisë ligjore ka datën 14.4.2016 dhe pasojat e saj duhej të ishin përfshirë në deklaratën periodike të vitit 2016 dhe jo në deklaratën periodike të vitit 2015. Mosdeklarimi i

---

<sup>5</sup>Me testamentin nr. \*\*\* rep., datë 3.8.2012, të çelur me dëshminë e trashëgimisë testamentare nr. \*\*\*, datë 2.11.2015, testatorja L.K. deklaroi se u lë në pronësi pas vdekjes fëmijëve Gjon Kodra dhe P.K. pjesën e saj takuese dhe pjesën e pjesës që përfiton nga i ndjeri, bashkëshorti saj M. K., në pasurinë apartament me sip. 100 m<sup>2</sup>, i ndodhur në rr. “\*\*\*”, regjistruar në ZVRPP në emër të z. M. K., të cilët do ta trashëgojnë në pjesë të barabarta dhe të pandara. Me dëshminë e trashëgimisë ligjore nr. \*\*\*, datë 28.11.2015, për trashëgimlënësin M. K., përcaktohen si trashëgimtarë të radhës së parë: L.K., bashkëshortja; P. K. (P.) e bija; M. K. (L.), e bija; Gjon Kodra, i biri; dhe P. K., e bija, të cilët trashëgojnë 1/5 pjesë e pasurisë trashëgimore.

Me vendimin nr. \*\*\*, për ndreqje gabimi për lëshimin e trashëgimisë ligjore, datë 14.4.2016, referuar deklaratave noteriale nr. \*\*\*, datë 28.11.2015, me deklaruese M. L. dhe nr. \*\*\*, datë 13.2.2015, me deklaruese P. P., që kanë hequr dorë nga trashëgimia, ndreqet gabimi duke përcaktuar si trashëgimtarë të radhës së parë: Gjon Kodra dhe P.K., të cilët trashëgojnë secili nga 1/2 pjesë të pasurisë trashëgimore. Dokumente të përcjella nga notere M. Ll., me shkresën datë 26.4.2021.

<sup>6</sup>Periudha kur ka përfituar pjesën e këtij apartamenti me trashëgimi.

<sup>7</sup>Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 13.2.2015, e shtetas P. P. dhe deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 28.11.2015, e shtetas M. L.

pjesës takuese në deklaratën periodike të vitit 2016 është harresë, sepse pjesa takuese është deklaruar në deklaratën *Vetting*, plotësuar në janar të vitit 2017.

## **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

1.5 Komisioni vëren se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme, fakti i mosdeklarimit të pjesës takuese në DIPP-të e viteve 2015 dhe 2016 është pasaktësi me karakter minimal, pasojat e së cilës subjekti i ka rregulluar në deklaratën *Vetting*.

## **Nuk konstatohen problematika në lidhje me deklarimin e kësaj pasurie.**

### **2. Apartament me sip. 129 m<sup>2</sup>, Tiranë**

Ky apartament ndodhet në “\*\*\*\*”, pallati “\*\*\*\*”, k. \*\*\*, h. \*\*\*, ap. \*\*\*. Blerë me kontratë shitblerjeje datë 12.10.2016<sup>8</sup>. Vlera: 50,952 euro. Pjesa takuese: 100 %. Burimi i krijimit: nuk është deklaruar.

Subjekti, po në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar: *“Nga rimatja e objektit para përpilimit të kontratës përfundimtare ka rezultuar 11 metër më shumë se sa është pasqyruar në kontratën e shitblerjes së mëparshme 118 m<sup>2</sup>. Vlera e kësaj diference do të zgjidhet me marrëveshje me investitorin e objektit në të ardhmen. Ky apartament është deklaruar më parë në kontratën e shitblerjes dhe vërtetimit përkatës të noterit R. K.”*

2.1 Në deklaratimet periodike për këtë apartament, subjekti ka deklaruar:

Në DIPP-në e vitit 2006: *“Prenotim apartamenti me sip. 115.8 m<sup>2</sup>, sipas kontratës së sipërmarrjes me shoqërinë ‘\*\*\*’ sh.p.k., me vlerë 50,952 euro, me adresë: rr. ‘\*\*\*’, pallati \*\*\*-katësh pas ambulancës. Paguar deri më 31.12.2006 shuma 35,952 euro. Duke përdorur kursime të deklaruara më parë në vitet 2005 - 2006, si dhe shumën prej 30,000 euro nga të ardhurat e bashkëshortes. Pjesa takuese: 50 %. Detyrimi i shlyer 35,952 euro, detyrimi i mbetur 15,000 euro”*.

Në DIPP-në e vitit 2007: *“Paguar gjatë vitit 2007 shuma 5,000 euro për apartamentin e prenotuar sipas deklarimit të mëparshëm. Shuma e shlyer: 5,000 euro. Gjendja e detyrimit të mbetur: 10,000 euro. Detyrimi i shlyer 5,000 euro, detyrimi i mbetur 10,000 euro”*.

Në DIPP-në e vitit 2008: *“Paguar gjatë vitit 2008 shuma 10,000 euro për apartamentin e prenotuar në vitin 2006 me shoqërinë ‘\*\*\*’ sh.p.k. Shuma e shlyer: 10,000 euro. Gjendja e detyrimit të mbetur: 0 euro. Detyrimi i shlyer 10,000 euro, detyrimi i mbetur 0 euro”*.

2.2 Subjekti, bashkë me deklaratën *Vetting*, ka depozituar kontratën e shitblerjes, datë 12.10.2016<sup>9</sup>, me shitës shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori A. A. dhe blerës Gjon Kodra, për apartamentin me sip. 129 m<sup>2</sup>, të ndodhur në “\*\*\*\*”, h. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë. Në kontratë është cilësuar se çmimi i shitjes është 50,952 euro dhe është likuiduar totalisht sipas dokumenteve bashkëlidhur (nuk ka dokumentacion bashkëlidhur në kontratë).

2.3 Me pyetësorin standard subjekti ka depozituar aktmarrëveshjen e datës 22.2.2017, të lidhur midis shtetasit A. A., si përfaqësues i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe blerësit Gjon Kodra, ku shtetasi A.A., ndër të tjera, ka deklaruar se apartamenti me sip. 118 m<sup>2</sup> i blerë nga z. Gjon Kodra me kontratën e sipërmarrjes, pas rimatjes së tij në momentin e përpilimit të kontratës së shitjes,

---

<sup>8</sup>Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 12.10.2016; certifikatë pronësie nr. \*\*\*, datë lëshimi 21.10.2016.

<sup>9</sup>Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 12.10.2016.

rezultoi 11 m<sup>2</sup> më e madhe se sipërfaqja e pasqyruar në kontratën e sipërmarrjes dhe çmimi i sipërfaqes prej 11 m<sup>2</sup> në atë kohë rezultoi 4,752 euro. Sipas marrëveshjes verbale të bërë, z. Gjon Kodra ka kryer me shpenzimet e tij punime në këtë apartament dhe nëse ato do të kryheshin nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. vlera e tyre do ishte 4,850 euro. Meqë këto punime janë njohur nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe vlera e punimeve të kryera përkon dhe me vlerën e sip. 11 m<sup>2</sup>, palët nuk kanë detyrime financiare ndaj njëri-tjetrit.

2.4 ASHK-ja<sup>10</sup> ka konfirmuar se në emër të z. Gjon Kodra është regjistruar apartamenti me sip. 129 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*. Është bashkëlidhur dokumentacioni i pronësisë së këtij apartamenti (kontrata e shitjes datë 12.10.2016; certifikata e pronësisë së apartamentit me sip. 129 m<sup>2</sup> në emër të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.; si dhe kartela e pasurisë së shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., format kontratë shitblerjeje e vitit 2006, pa datë).

2.5 Komisioni ka analizuar çmimin e blerjes së apartamentit, duke e krahasuar me çmimin referues të EKB-së për vitin 2006 në tregun e lirë të apartamenteve, ku për qytetin e Tiranës<sup>11</sup> llogaritet 79,615 lekë/m<sup>2</sup>. Duke llogaritur sipërfaqen fillestare prej 115.8 m<sup>2</sup> x 79,615 lekë = 9,219,417 lekë, në total (9,219,417 – 6,302,915<sup>12</sup> = 2,916,502 lekë diferenca).

2.6 Komisioni ka administruar përgjigjet datë 29.4.2021 dhe datë 30.9.2021, të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., ku administratori/ortaku A. A. konfirmon blerjen e apartamentit nga z. Gjon Kodra. Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. ka depozituar të njëjtin dokumentacion të përcjellë më parë nga subjekti<sup>13</sup> dhe konfirmon se z. Gjon Kodra nuk ka asnjë detyrim financiar kundrejt saj, por kjo shoqëri nuk ka vënë në dispozicion kopje të dokumentacionit të pagesave të bëra nga subjekti.

Gjithashtu, për kontrata të ngjashme të lidhura në vitin 2006 me persona të tjerë në të njëjtin pallat, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. deklaroi se nuk disponon dokumentacion, pasi aktiviteti i ndërtimit është mbyllur vite më parë.

2.7 Subjektit të rivlerësimit, me anë të pyetësorit nr. 2 i është kërkuar të shpjegojë mospërputhjen në lidhje me pjesën takuese në këtë apartament, pasi është konstatuar se në DIPP-në e vitit 2006 subjekti ka deklaruar 50 %, në deklaratën *Vetting* 100 % dhe certifikata e pronësisë pasqyron subjektin si pronar të vetëm. Subjekti ka shpjeguar se deklarimi në deklaratën periodike dhe në atë *Vetting* është bërë duke iu referuar kontratës së sipërmarrjes, kontratës përfundimtare të shitjes dhe certifikatës së pronësisë. Kalimi i pronësisë së apartamentit në emrin e subjektit është bërë me mirëkuptimin e bashkëshortes, pasi ajo është edhe kontribuuesja kryesore në blerjen e tij.

2.7.1 Për burimin e pagesave të kryera për apartamentin, subjekti ka sqaruar se të ardhurat kanë qenë në pjesën më të madhe të vlerës nga të ardhurat e bashkëshortes dhe një pjesë e të ardhurave të tij.

---

<sup>10</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.5.2020; dhe nr. \*\*\* prot., datë 13.8.2021, nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tirana Veri.

<sup>11</sup>Udhëzim nr. 5, datë 7.9.2006, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave” nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2006.

<sup>12</sup>Vlera e apartamentit 50,952 euro x 123.703 = 6,302,915 lekë.

<sup>13</sup>Certifikatë pronësie, datë 5.11.2015, e apartamentit me sip. 129 m<sup>2</sup>, të ndodhur në “\*\*\*\*”, h. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, në pronësi të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.; kontratë shitblerjeje e apartamentit, e vitit 2006, pa datë të saktë, pa rep. dhe kol., me shitës shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe blerës Gjon Kodra, për apartamentin me sip. 129 m<sup>2</sup>, të ndodhur në “\*\*\*\*”, Tiranë me çmimin 50,952 euro; kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 12.10.2016; aktmarrëveshje datë 22.2.2017.

2.7.2 Subjekti i rivlerësimit, në pyetësin nr. 2, ka depozituar si kontratë sipërmarrjeje format kontratë shitblerjeje noteriale, pa datë, e vitit 2006 (pa nr. rep., pa nr. kol., pa firmë dhe vulë të noterit) me shitës shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe blerës Gjon Kodra, për apartamentin 4 (1+1), me sipërfaqe totale 115.8 m<sup>2</sup>, i ndodhur në katin e \*\*\* të banesës 3,7 dhe \*\*\*-katëshe, me dy kate parkim nëntokë, rruga “\*\*\*”, kundrejt çmimit 50,952 euro. Vlera është likuiduar plotësisht nga blerësi në favor të shitësit, pa asnjë pretendim të mëtejshëm nga palët.

Kontrata rezulton të jetë e nënshkruar nga shitësi “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe blerësi Gjon Kodra. Ndërkohë, në deklaratimet periodike, subjekti deklaron shlyerjen e detyrimit në 3 vite [në DIPP-në e vitit 2006 deklaron *shlyer 35,952 euro, detyrimi i mbetur 15,000 euro*, në DIPP-në e vitit 2007 deklaron *shlyer 5,000 euro, mbetur 10,000 euro*, në DIPP-në e vitit 2008 deklaron *shlyer 10,000 euro dhe mbetur 0 (zero)*].

2.8 Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë konflikt interesi, dhe për këtë qëllim ka administruar përgjigjen e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>14</sup>. Ka rezultuar se shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe administratori/ortaku A. A. kanë pasur çështje penale pranë kësaj prokurorie<sup>15</sup>, ku ndër to edhe procedimi penal nr. \*\*\*, i cili është hetuar nga subjekti Gjon Kodra.

Ka rezultuar se në këtë procedim, shtetasi A.A. ka bërë kallëzim për veprën penale “shpërdorim detyre” ndaj punonjësve të OSHEE-së. Pas veprimeve hetimore të kryera për disa muaj, subjekti i rivlerësimit, në datën 31.3.2011, ka vendosur pushimin e procedimit penal për mungesë të elementeve të veprës penale.

2.8.1 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit dhe shtetasi A. A., ortak/administrator i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., kanë lidhje për shkak të kontratës së sipërmarrjes për apartamentin e blerë në vitin 2006, si dhe në vitin 2016, përsëri me këtë shtetas dhe me këtë shoqëri, kanë lidhje me kontratën e shitjes për apartamentin e blerë.

Subjekti i rivlerësimit, në pyetësin nr. 1, ka deklaruar se ka udhëtuar disa herë me shtetasin A. A., pasi janë edhe fqinj, njohur që prej vitit 2005, të cilët kanë krijuar lidhje shoqërore e familjare dhe prej vitesh frekuenton ambientet e bar-kafes në pronësi të tij, e cila ndodhet në katin e parë të pallatit ku banon.

2.9 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se:

- Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie në deklaratën *Vetting*.
- Ka mospërputhje deklarimi në lidhje me pagesat e bëra për apartamentin me sip. 129 m<sup>2</sup>, pasi në deklaratat periodike subjekti deklaron shlyerje të pagesave të apartamentit në 3 vite [në DIPP/2006 deklaron shlyer 35,952 euro, në DIPP/2007 deklaron shlyer 5,000 euro, në DIPP/2008 deklaron shlyer 10,000 euro dhe mbetur 0 (zero)], ndërsa në kontratën format të

---

<sup>14</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.6.2021, e Prokurorisë së Rrethit Tiranë.

<sup>15</sup>Kallëzimi penal nr. \*\*\*, datë 31.7.2014, hetuar nga prokurori A. Ç; kallëzimi nr. \*\*\*, i vitit 2015, hetuar nga prokurori H. M; procedimi penal nr. \*\*\*, i vitit 2016, hetuar nga prokurori D. Rr.; procedimi penal nr. \*\*\*, i vitit 2016, hetuar nga prokurori A. P.; kallëzimi nr. \*\*\*, i vitit 2018, hetuar nga prokurori E. M.; kallëzimi nr. \*\*\*, i vitit 2018, hetuar nga prokurori A. Q.; kallëzimi nr. \*\*\*, i vitit 2018, hetuar nga prokurori E. I.; kallëzimi nr. \*\*\*, i vitit 19.6.2020, hetuar nga prokurori I. A.; kallëzimi nr. \*\*\*, i datës 15.5.2020, hetuar nga prokurori E. Sh.; kallëzimi nr. \*\*\*, datë 15.2.2007, i hetuar nga prokurori G. O.



shitblerjes, e cilësuar nga subjekti si sipërmarrje, cilësohet se shuma e apartamentit 50,952 euro është likuiduar totalisht.

- Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokument ligjor pagesat e kryera për apartamentin me sip. 129 m<sup>2</sup> ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. sipas viteve të deklarimit.
- Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar dhe nuk ka provuar me dokument ligjor pagesat e kryera për apartamentin me sip. 129 m<sup>2</sup> për punime dhe pajisje, sipas aktmarrëveshjes datë 22.2.2017, në shumën 4,850 euro.
- Subjekti i rivlerësimit ka përfituar apartamentin me sip. 115.8 m<sup>2</sup> me çmim rreth 2,916,502 lekë më të ulët se çmimi referues i EKB-së për vitin 2006.
- Subjekti i rivlerësimit është ndodhur në situatën e konfliktit të interesit kur ka hetuar çështjen penale me kallëzues A. A., administrator i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me të cilin ka pasur marrëdhënie interesi, si dhe marrëdhënie shoqërore në vazhdimësi.

Për konstatimet e mësipërme, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Aneksit të Kushtetutës.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

2.10 Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me konstatimet e Komisionit, në prapësimet e tij ka shpjeguar, si vijon:

2.10.1 Për mosdeklarimin e burimit të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën *Vetting*, subjekti ka shpjeguar se kjo nuk vjen si pasojë e mungesës së burimit, por sepse për këtë deklaram i është referuar vetëm dokumentit ligjor, certifikatës së pronësisë. Burimi i krijimit të kësaj pasurie është pasqyruar në DIPP-të e viteve 2006, 2007 dhe 2008.

2.10.2 Për mospërputhjen e deklarimit në lidhje me pagesat e bëra për apartamentin me sip. 129 m<sup>2</sup>, subjekti ka shpjeguar se pagesat për shlyerjen e detyrimit prej 50,952 euro janë bërë sipas deklarimeve në DIPP-të e viteve 2006 - 2008, ku shuma 35,952 euro është paguar në vitin 2006, shuma 5,000 euro është paguar në vitin 2007 dhe shuma 10,000 euro është paguar në vitin 2008. Përshkrimi në kontratën format të shitblerjes se shuma totale e apartamentit prej 50,952 euro është likuiduar totalisht, ka qenë element në formatin e kontratës tip dhe jo për të vërtetuar ose konfirmuar pagesën e kryer.

2.10.3 Për mungesën e dokumentacionit provues për pagesat e kryera për apartamentin me sip. 129 m<sup>2</sup> ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., subjekti, në prapësime, ka vënë në dispozicion të Komisionit 6 mandatpagesa<sup>16</sup>.

2.10.4 Për mosdeklarimin e pagesës së kryer për apartamentin me sip. 129 m<sup>2</sup> për punime dhe pajisje sipas aktmarrëveshjes datë 22.2.2017, në shumën 4,850 euro, subjekti ka shpjeguar se nëpërmjet aktmarrëveshjes u formalizuan detyrimet e ndërsjella midis palëve, shuma që subjekti i rivlerësimit i detyrohej shoqërisë ndërtuese për 11 m<sup>2</sup>, përfituar më shumë se kontrata e shitjes dhe shuma që shoqëria ndërtuese i detyrohej subjektit të rivlerësimit në lidhje me punimet e kryera prej tij. Në lidhje me mungesën e dokumentacionit provues për pagesat e kryera për punimet dhe

---

<sup>16</sup>Mandatarkëtimet: nr. \*\*\*, datë 2.9.2006, për shumën 25.000 USD; nr. \*\*\*, datë 16.12.2006, për shumën 5,000 USD; nr. \*\*\*, datë 16.12.2006, për shumën 5,000 euro; nr. \*\*\*, datë 20.12.2006, për shumën 8,000 euro; nr. \*\*\* datë 11.7.2007, për shumën 5,000 euro; nr. \*\*\*, datë 11.8.2008, për shumën 10,000 euro.

pajisjet subjekti ka shpjeguar se nuk disponon dokumentacion sepse për transaksionet me individët, shoqëritë tregtare nuk kanë pasur detyrim për të dhënë kupon tatimor.

Për përfitimin e apartamentit me sip. 115.8 m<sup>2</sup>, me çmim rreth 2,916,502 lekë më të ulët se çmimi referues i EKB-së për vitin 2006, subjekti shpjegon se Komisioni ka bërë referim të gabuar në lidhje me vlerën, sepse i referohet vlerës mesatare të apartamenteve në tregun e lirë, pa diferencuar zonën ku ndodhet sipërfaqja e banimit apo llojin e sipërfaqes (destinacionin e saj). Çmimet varen edhe nga disa faktorë si, pozicioni i ndodhjes së sipërfaqes banuese, afati i shlyerjes së detyrimit, kushtet e kërkesë/ofertës, si dhe nevoja për gjendje *cash* e shoqërisë në momentin e hartimit të kontratës, ku shpeshherë aplikohen edhe çmime më të ulëta. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se nuk e ka realizuar shitjen me EKB-në, por me subjekt privat. Udhëzimi nr. 5/2006 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave, dhe të koeficientit ‘K’ për vitin 2006”, ka të bëjë me miratimin e kostos mesatare e ndërtimit të banesave në shkallë republike për vitin 2006, në vlerë 29.220 lekë, për sipërfaqe të shfrytëzueshme, si dhe me vlerën mesatare të apartamenteve në tregun e lirë të banesave, sipas qyteteve, për vitin 2006, pasqyruar në tabelat nr. 1 e nr. 2. Ndërsa, në aktin tjetër, vendimi nr. 173, datë 29.3.2006, “Për miratimin e kostos minimale fiskale në ndërtim dhe për mënyrën e përcaktimit të çmimit të shitjes të banesave” ka të bëjë me miratimin e kostos minimale fiskale në ndërtim dhe për mënyrën e përcaktimit të çmimit të shitjes së banesave, çka do të thotë se subjektet private janë të detyruara t’i zbatojnë këto kërkesa të vendimit, pasi mbi bazën e tyre llogariten dhe paguhet detyrimet tatimore.

Udhëzimi nr. 5/2006 është i detyrueshëm për zbatim nga Enti Kombëtar i Banesave, si për koston mesatare të ndërtimit të banesave në shkallë vendi për vitin 2006, ashtu edhe për vlerën mesatare të apartamenteve në tregun e lirë të banesave, sipas qyteteve, për vitin 2006, të përcaktuar në tabelat nr. 1 e nr. 2.

Për këtë, çmimi në kontratën e shitblerjes është në përputhje me kërkesat e përlllogaritjes së detyrimeve tatimore të aplikueshme mbi to në bazë të dokumentit kontabël dhe rregullave specifike, të përcaktuara në aktet ligjore tatimore, konkretisht në vendimin nr. 173, datë 29.3.2006, “Për miratimin e kostos minimale fiskale në ndërtim dhe për mënyrën e përcaktimit të çmimit të shitjes të banesave”. Sipas kësaj reference rezulton se çmimi i shitjes së apartamentit të jetë më i madh se çmimi minimal fiskal i llogaritur sipas vendimit nr. 173/2006. Konkretisht, po të krahasojmë çmimin minimal fiskal prej 404,52 euro, të llogaritur sipas vendimit nr. 173/2006, me çmimin për m<sup>2</sup> sipas shumës të pasqyruar në kontratë prej 431,8 euro (shuma e paguar 50,952 euro + shuma e kompensuar për punimet e kryera nga subjekti prej 4,850 euro = shuma totale e blerjes së apartamentit prej 55,802 euro/sipërfaqe prej 129 m<sup>2</sup> = 432,6 euro) rezulton se çmimi i shitjes së apartamentit të jetë më i madh se çmimi minimal fiskal i llogaritur sipas vendimit nr. 173/2006 për shumën prej 28,08 euro (çmimi i sipërfaqes së apartamentit sipas subjektit të rivlerësimit prej 432,6 euro – çmimi minimal fiskal sipas vendimit nr. 173/2006 prej 404,52 euro = 28,08 euro).

2.10.5 Subjekti i rivlerësimit, me qëllim vërtetimin e faktit se çmimi i aplikuar në kontratën e tij të shitjes nga subjekti ndërtues nuk ka qenë aspak preferencial, ka depozituar kontrata të ngjashme të shitjes së apartamenteve në të njëjtin pallat dhe në të njëjtin vend nga subjekti ndërtues dhe ortaku i tij, të cilat vërtetojnë se çmimet mesatare të shitjes së apartamenteve në atë zonë variojnë në 393,4 euro/m<sup>2</sup>, 433,68 euro/m<sup>2</sup> dhe 408,3 euro/m<sup>2</sup><sup>17</sup>.

---

17Kontratë shitblerjeje apartamenti me nr. \*\*\*, datë 17.4.2019, me sip. 93.68 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “\*\*\*”, me çmim 36,854 euro (393.40 euro/m<sup>2</sup>); kontratë sipërmarrjeje apartamenti, datë 9.4.2004, i ndodhur në rrugën “\*\*\*”,

2.10.6 Në lidhje me situatën e konfliktit të interesit, ku subjekti ka hetuar çështjen penale me kallëzues A.A., administrator/ortak i shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. ka shpjeguar se ka kontaktuar me drejtuesin e sektorit në prokurori dhe e ka vënë në dijeni të marrëdhënies së tij me këtë shtetas. Pavarësisht vënies në dijeni, drejtuesi ka vlerësuar se subjekti duhej të kryente veprimet hetimore dhe nëse nga këto veprime do të konkludohej në përgjegjësinë penale të punonjësve të OSSH-së, do të procedohej me dorëheqjen e tij. Pas kryerjes së veprimeve hetimore subjekti i rivlerësimi ka vendosur pushimin e procedimit penal, pasi nuk ka konstatuar elemente të veprës penale. Ky vendim është ankimuar nga kallëzuesi A. A. në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka lënë në fuqi vendimin e pushimit të prokurorit, subjekt rivlerësimi.

2.10.7 Subjekti ka argumentuar në mënyrë të detajuar marrëdhënien me shtetasin A.A., duke dhënë edhe arsyet përkatëse se pse në veprimtarinë e tij profesionale nuk ndodhet në situatë konflikti interesi me këtë shtetas<sup>18</sup>.

---

me sip. 138.35 m2 dhe çmim shitjeje 60,000 euro (433.68 euro/m2); kontratë shitblerjeje apartamenti, e vitit 2005, i ndodhur në rrugën “\*\*\*”, me sipërfaqe totale 138.55 m2 dhe çmim blerjeje 56,571 euro (408.30 euro/m2).

18“Me shtetasin A. A. kam lidhje shoqërore dhe familjare, si dhe kam blerë në objektin e ndërtuar prej tij apartamentin ku banon aktualisht. Këtë shtetas e kam njohur nga afër nga lidhje shoqërore të përbashkëta, kolegët e mi të vjetër, në vitin 2005, ndërsa si person e kam njohur vite më parë, pasi ka pasur në pronësi një bar-restorant përballë godinës së Prokurorisë së Përgjithshme, ku e frekuentonte ndonjëherë me kolegët. Në biseda me to u kam thënë se interesohem të blej një apartament. Ata e kanë rekomanduar të shikonte tek dy objektet që po ndërtonte ky shtetas së bashku me shoqërinë sipërmarrëse “\*\*\*” sh.p.k. Në objektin e parë që ndodhet në rrugën “\*\*\*”, z. A.A. ishte investitor i objektit, ndërsa firma ndërtuese ishte shoqëria “\*\*\*”. Në objektin e dytë ngjitur në “\*\*\*” z. A.A. ishte në cilësinë e investitorit dhe të ndërtuesit. Me bashkëshorten vendosëm të blinin apartament tek pallati që po ndërtonte z. A. që ishte në fazën e karabinasë dhe do të kryheshin punimet e brendshme.

Ky shtetas në vitin 2010 ka kallëzuar punonjësit e OSSH-së për veprën penale ‘shpërdorim detyre’, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Kjo çështje më është dhënë për veprim sipas rregullave të kohës kur është bërë kallëzimi penal. Me marrjen e këtij kallëzimi penal është kontaktuar me drejtuesin e sektorit, të cilin e kam vënë në dijeni të marrëdhënies që kam pasur dhe kam me shtetasin A. A.. Drejtuesi ka çmuar se unë duhej të kryeja veprimet hetimore dhe nëse nga këto veprime do të konkludohej në përgjegjësinë penale të punonjësve të OSSH-së do të procedohej me dorëheqje. Sipas tij nuk kishin pse të ngarkoheshin prokurorët e tjerë në këtë fazë hetimi. Mbas kryerjes së veprimeve verifikuese kam regjistruar procedim penal dhe çështja i është deleguar një oficeri të policisë gjyqësore të Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Tiranë. Veprimet nga oficeri janë kryer në mënyrë të pavarur nga unë dhe në përfundim të hetimeve ka sugjeruar pushimin e procedimit penal, pasi nuk konstatohen elementë të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Në këto rrethana unë kam vendosur pushimin e procedimit penal dhe vendimi është miratuar nga Drejtuesi i Prokurorisë.

Gjithashtu, vendimi i është komunikuar kallëzuesit A. A. Ky i fundit nuk ka qenë dakord me vendimin e pushimit dhe e ka ankimuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjatë zhvillimit të gjykimit kemi zhvilluar debate me këtë shtetas, i cili, siç dukej, ka pasur pritshmëri tjetër për mënyrën e zgjidhjes së çështjes nga ana ime. Gjykata, me vendimin e saj nr. \*\*\* regj. themel, datë 11.7.2011, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuarit A. A., me objekt ‘kundërshtimin e vendimit për pushimin e çështjes penale nr. \*\*\*’, të vitit 2010, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si të pa bazuar në prova e në ligj.

Pra, pavarësisht se në dukje duket se ndodhemi para konfliktit të interesit, unë si prokuror nuk e kam favorizuar këtë shtetas, përkundrazi kam zgjidhur çështjen me drejtësi pavarësisht marrëdhënieve që kam pasur e kam me të. Mbas njohjes me vendimin e pushimit ky shtetas ka mbajtur qëndrim ndaj meje për disa kohë, por më vonë është bindur në zgjidhjen e drejtë të çështjes dhe marrëdhëniet janë normalizuar. Nëse unë do të kisha pasur detyrime nga ky shtetas

Në seancë dëgjimore subjekti deklaroi se u qëndron shpjegimeve të dhëna në prapësime pas kalimit të barrës së provës dërguar nga Komisioni.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

2.10.8 Komisioni vlerëson se subjekti ka pasur detyrimin për deklarimin e burimit të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën *Vetting*. Subjekti me të vërtetë nuk ka deklaruar burimin e kësaj pasurie në deklaratën *Vetting* kur ka deklaruar apartamentin me sip. 129 m<sup>2</sup>, por ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie në kohën e krijimit të saj në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006. Në

---

në lidhje me apartamentin e blerë tek objekti që ka qenë investitor dhe ndërtues do të kisha bërë përpjekje për favorizimin e tij. Formalisht kallëzuesi kishte të drejtë sepse ishte faturuar padrejtësisht në një shumë të konsiderueshme, por nga hetimi ka rezultuar se faturimi pa të drejtë ka ndodhur për shkak të defektit të matësit dhe jo si rezultat i veprimeve të punonjësve të OSSH-së. Konflikti është konsideruar i karakterit juridiko-civil dhe i tillë është klasifikuar dhe nga gjykata.

Megjithëse shtetasi A. A. ka kallëzuar penalisht punonjësit e OSSH-së, veprime hetimore janë kryer edhe në drejtim të tij. Nga veprimet hetimore ka rezultuar e provuar se nga ana e kallëzuesit A. A. nuk ka patur ndërhyrje në rrjetin elektrik apo në matësin e energjisë elektrike. Ky fakt është argumentuar edhe në vendimin e pushimit të këtij procedimi penal.

Bashkëlidhur ju dërgojmë një kopje të vendimit të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranësi dhe kopje të vendimit të pushimit të procedimit penal.

Gjithashtu, sqaroj se në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, 'Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike', i ndryshuar, janë përcaktuar rastet e konfliktit të interesit dhe në asnjë nga rastet e përcaktuara në ligj, unë subjekti i rivlerësimit nuk ndodhem në situatën e konfliktit të interesit kur kam hetuar çështjen penale me kallëzues A. A. administrator i shoqërisë "\*\*\*\*" sh.p.k. Konkretisht, në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, 'Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike', i ndryshuar, në pikat 1, 2 e 3 të neni 3 'Përkufizime', citohet: 'Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të thërrortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike.

2. 'Kryerje në mënyrë të drejtë e detyrave dhe përgjegjësi' është mënyra e kryerjes së detyrave dhe përgjegjësi, të materializuara në një vendimmarrje, në të cilën zyrtari vepron në përputhje me ligjin, me ndershmëri, paanshmëri, përgjegjësi, përkushtim, në afat, në mbrojtje, në ccdo rast, të interesit publik dhe të të drejtave të ligjshme të personave privatë, si dhe për ruajtjen dhe forcimin e besueshmërisë të dinjitetit të institucionit ku punon, të shtetit në përgjithësi dhe të figurës së zyrtarit.

3. 'Kryerje në mënyrë të padrejtë e detyrave dhe e përgjegjësi' është rasti kur nuk plotësohet të paktën njëra prej kërkesave të pikës 2 të këtij neni për shkak dhe vetëm të ndikimit të mundshëm të interesave privatë të zyrtarit, sipas pikës 1 të këtij neni.

Përgjatë gjithë periudhës kam konfirmuar se kam pasur vetëm marrëdhënie shoqërore në vazhdimësi dhe jo marrëdhënie interesi të ndërsjellë që të kenë cenuar apo te cenojnë/ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe të përgjegjësi të mija publike, kjo e vërtetuar me vendimin e pushimit të kallëzimit të cituar më sipër, në përputhje me ligjin, me ndershmëri, paanshmëri, përgjegjësi, e përkushtim, në mbrojtje, të interesit publik dhe të drejtave të ligjshme".

nenin 32 të ligjit nr. 84/2016 përcaktohet se deklaratat periodike të pasurisë konsiderohen si provë në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve.

Vlen të theksojmë se burimi kryesor i krijimit të pasurisë së llojit “apartament” (shuma prej 30,000 euro nga të ardhurat e bashkëshortes) është deklaruar në mënyrë të saktë si burim krijimi në DIPP-në e vitit 2006, çka përforcohet me faktin se po në këtë deklaratë subjekti ka deklaruar: “*Të ardhura nga bashkëshortja A. L. (shtetase italiane) nga viti 1980 deri në vitin 1999. Kursime nga puna shumëvjeçare në Itali dhe për periudhën 8-vjeçare në Shqipëri (Shkodër) si përfaqësuese e firmës italiane, shuma e deklaruar 35,000 euro*”.

Gjithashtu, në deklaratën *Vetting*, pavarësisht se nuk është specifikuar si burim krijimi për blerjen e apartamentit, të ardhurat nga punësimi i bashkëshortes, por që si burim krijimi subjekti në mënyrë jo të saktë ka pasqyruar dhe deklaruar përgjatë hetimit certifikatën për vërtetim pronësie të këtij apartamenti, bashkëshortja e subjektit A. L. ka deklaruar, veç të tjerash, edhe të ardhura nga paga për periudhën 1.2.1978 – 24.2.2001, shumën prej 358,800,000 liretash, të ardhura këto që në DIPP-në e vitit 2006 janë deklaruar si burim krijimi për blerjen e apartamentit dhe përveç kësaj ka deklaruar edhe pagën nga pensioni shëndetësor prej rreth 54,800 euro, nga viti 2001 e në vazhdim.

Fakti që subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur për qëllim fshehjen e të ardhurave të siguruara nga punësimi i bashkëshortes ndër vite, si në shtetin italian, ashtu edhe në shtetin shqiptar, dhe për më tepër fshehjen e tyre si burim krijimi për blerjen e apartamentit, duke u vlerësuar kështu mosdeklarimi i burimit të krijimit të apartamentit si një pasaktësi në plotësimin e deklaratës *Vetting*, bëhet akoma edhe më bindës po të kemi parasysh se në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 13.5.2010, shumë kohë përpara miratimit të ligjit nr. 84/2016, si dhe plotësimit dhe depozitimit të deklaratës *Vetting*, ashtu edhe në proces verbalin e mbajtur po në ILDKPKI në datën 9.3.2016, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime në lidhje me të ardhurat e bashkëshortes, nënshtetase italiane, ku është specifikuar se ato janë përdorur për blerjen e apartamentit të banimit, të deklaruar në deklaratën përkatëse të pasurisë.

2.10.9 Për mënyrën e pagesës së vlerës së apartamentit, pavarësisht se në draft kontratën e sipërmarrjes ka mbetur çmimi total 50,952 euro, mandatpagesat e depozituara nga subjekti, së bashku me prapësimet, korrespondojnë me pagesat për blerjen e apartamentit të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore të pasurisë. Vlen të theksojmë përsëri se edhe në këtë rast gjen vend fakti se deklaratat periodike vjetore të pasurisë kanë vlerën e provës, në respektim të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.

2.10.10 Për mosdeklarimin e pagesës së kryer nga subjekti i rivlerësimit për apartamentin me sip. 129 m<sup>2</sup> për punime dhe pajisje sipas aktmarrëveshjes datë 22.2.2017, në shumën 4,850 euro, Komisioni vëren se subjekti nuk ka kryer deklarim të saktë sepse, pavarësisht detyrimeve të ndërsjella midis palëve, kishte detyrimin për deklarimin e pagesës. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* detyrimin ndaj shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. për sip. 11 m<sup>2</sup>, përfituar më tepër si rezultat i rimatjes së apartamentit, por pa përcaktuar vlerë dhe është shprehur se detyrimi do të përcaktohej në të ardhmen me aktmarrëveshje. Subjekti ka depozituar më pas (pas plotësimit të deklaratës *Vetting* në datën 20.1.2017) aktmarrëveshjen e datës 22.2.2017, në të cilën përcaktohen punimet e kryera dhe pajisjet e blera, si dhe shumat e paguara për to.

2.10.11 Për përfitimin e apartamentit me sip. 115.8 m<sup>2</sup>, me çmim 2,916,502 lekë më të ulët se çmimi referues i EKB-së për vitin 2006, Komisioni vëren se subjekti ka dhënë shpjegime të detajuara në lidhje me bazueshmërinë ligjore që duhet marrë në konsideratë për të bërë krahasimin ndërmjet çmimit të blerjes dhe atij të tregut, por pavarësisht kësaj, Komisioni vlerëson se paraqitja

e disa kontratave të ngjashme nga subjekti i rivlerësimit, një praktikë tashmë e konsoliduar në procesin e rivlerësimit, të cilat vërtetojnë se subjekti i rivlerësimit e ka blerë apartamentin me çmim thuajse të njëjtë apo edhe me të lartë se ato të pasqyruara në kontratat e ngjashme, krijojnë bindjen e plotë se çmimi i blerjes së këtij apartamenti nga subjekti i rivlerësimit nuk është një çmim preferencial, por çmimi real i tij i paguar nga subjekti dhe, për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se nuk kemi të bëjmë me trajtim preferencial të subjektit të rivlerësimit nga shitësit e apartamentit.

2.10.12 Në lidhje me situatën e konfliktit të interesit, Komisioni vëren se prej vitit 2006 deri në vitin 2017 ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., me administratorin dhe ortakun e vetëm A. A., ka ekzistuar marrëdhënie me karakter pasuror, e cila ka nisur në vitin 2006 me porositjen e një apartamenti dhe është finalizuar me kontratën e shitblerjes në vitin 2016 dhe aktmarrëveshjen në vitin 2017.

Komisioni konstaton se marrëdhënia e mirëfilltë e interesit e subjektit me administratorin dhe ortakun e vetëm të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., shtetasin A. A., ka përfunduar në vitin 2008 me pagesën e çmimit të plotë të blerjes së apartamentit prej 50,952 euro, i cili është edhe çmimi i përcaktuar në kontratën e shitblerjes përfundimtare të apartamentit në vitin 2017. Kompensimi i vlerës së sipërfaqes prej 11 m<sup>2</sup> me vlerën e punimeve të kryera në apartament nga subjekti është një element që ka lindur papritur në vitin 2017, para lidhjes së kontratës përfundimtare të shitjes, por që është zgjidhur njëkohësisht me firmosjen e kësaj kontrate në vitin 2017.

Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ka treguar kujdesin e duhur duke njoftuar drejtuesin e tij lidhur me marrëdhënien e miqësisë me kallëzuesin, mbetet në kuadër deklarativ dhe i paprovuar.

Komisioni konstaton se pavarësisht se subjekti nuk gjendet në situata e parashikuara nga neni 26 i Kodit të Procedurës Penale, i cili referon tek neni 17 “Heqja dorë”, nga germa “a” deri në germën “e” të tij, mbetet për t’u vlerësuar zbatimi i germës “ë” të kësaj dispozite të rivlerësimit, e cila përcakton se gjyqtari ka për detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes (në rastin konkret prokurori): *“...ë) kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie”*.

Duke qenë se kjo situatë në vetvete nuk rezulton të jetë një nga rastet e parashikuara shprehimisht nga ligji, Komisioni vlerëson se analiza e saj duhet të bëhet mbi vlerësime të testit objektiv dhe atij subjektiv.

Në konsideratë të vlerësimit të testit objektiv, Komisioni vlerëson se natyra e marrëdhënies juridiko-civile të subjektit me administratorin e shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., e konkretizuar me shitblerjen e një apartamenti, në pamje të parë duket se e vë në diskutim nga syri i një vëzhguesi të jashtëm të zakonshëm, paanësinë e subjektit të rivlerësimit në trajtimin e një çështjeje në të cilën shoqëria ishte palë. Por nga ana tjetër, Komisioni mban në konsideratë faktin se kjo marrëdhënie interesi, përveçse kishte përfunduar që në vitin 2008 (ndërkohë që çështja penale i përket periudhës 2010 – 2011) me pagesën e plotë të çmimit të blerjes nga subjekti i rivlerësimit, nuk u provua se ishte në vetvete një trajtim preferencial, që mund të konsistonte në aplikimin e një çmimi të ulët të favorshëm nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k. në favor të subjektit. Përkundrazi, subjekti, me kontratat e ngjashme të vëna në dispozicion të Komisionit, provoi bindshëm se çmimi i paguar prej tij ishte real, shumë i përafërt me ato të pasqyruara në kontratat e ngjashme dhe jo favorizues për subjektin.

Në konsideratë të vlerësimit të testit subjektiv, subjekti i rivlerësimit ka insistuar në drejtim të paanësisë së tij në trajtimin e çështjes penale me kallëzues A. A. Paanësia e subjektit në këtë marrëdhënie juridiko-penale, për shkak të detyrës, me shtetasin A. A., përforcohet në mënyrë të besueshme dhe bindëse edhe me vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit kundër interesave të

këtij shtetasi, duke vendosur pushimin e çështjes penale përkatëse në dëm të interesave të kallëzuesit A. A. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\* regj. themel, datë 11.7.2011, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kallëzuesit A. A., i cili kishte ankimuar në gjykatë vendimin e pushimit të subjektit të rivlerësimit, duke i dhënë të drejtë veprimeve hetimore dhe vendimmarrjes së subjektit të rivlerësimit, i cili, me vendimmarrjen e tij, përveçse ka garantuar parimin e paanësisë, ka zbatuar bindshëm edhe parimin se drejtësia jo vetëm duhet të jepet, por edhe të duket se jepet.

Gjithashtu, vlen të mbahet në konsideratë fakti se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer transaksione të tjera me këtë pasuri që nga koha e blerjes së saj, gjithashtu, subjekti nuk ka kryer më transaksione të tjera në vazhdimësi me shtetasin A. A.

### **Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë në lidhje me burimin e krijimit të apartamentit.**

Komisioni vlerëson se pavarësisht se subjekti ka trajtuar një çështje ku palë ka qenë një person me të cilin ka pasur një marrëdhënie juridiko-civile, e cila, në sytë e një vëzhguesi të jashtëm të zakonshëm, mund të vë në diskutim paanësinë e subjektit në vendimmarrje, situatë për të cilën subjekti duhet të kishte treguar fillimisht kujdes të shtuar, ai ka kaluar me sukses testin objektiv dhe atë subjektiv, duke qenë i besueshëm dhe bindës në garantimin e parimit të paanësisë dhe të parimit se drejtësia jo vetëm duhet të jepet, por edhe të duket se jepet.

**Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se indikatorët e integritetit dhe të paanësisë arrijnë një nivel të konsiderueshëm në favor të subjektit të rivlerësimit, deri në atë masë sa ai nuk mund të penalizohet me masën disiplinore të shkarkimit nga detyra për cenim të besimit të publikut, në zbatim të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.**

#### **2.11 Analizë e burimi të krijimit të shumës 50,952 euro, paguar për blerjen e apartamentit**

Subjekti i rivlerësimit, në DIPP-në e vitit 2006, ka deklaruar se shuma prej 35,952 euro e paguar për apartamentin në vitin 2006 ka si burim krijimi: (a) kursime të deklaruara më parë në vitet 2005 - 2006; si dhe (b) shumën 30,000 euro nga të ardhurat e bashkëshortes.

#### **a) Analizë e kursimeve të deklaruara më parë në vitet 2005 - 2006**

2.11.1 Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar: *“Shuma 480,000 lekë kursime në llogarinë rrjedhëse”*.

2.11.2 *“Raiffeisen Bank”*<sup>19</sup> konfirmon llogarinë e pagës në emër të subjektit, me gjendje në vlerën 369,793.62<sup>20</sup> lekë në datën 31.12.2005. Nga veprimet bankare në këtë llogari konstatohet se në datën 18.12.2006 subjekti ka tërhequr shumën 1,000,000 lekë, të akumuluar deri në atë moment në llogarinë e tij të pagës. Nga kjo shumë subjekti ka përdorur për pagesën e apartamentit vlerën

<sup>19</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.2.2020, e *“Raiffeisen Bank”*.

<sup>20</sup>Gjendja e llogarisë e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore në vlerën 480,000 lekë duket se i referohet gjendjes së llogarisë rrjedhëse në datën e plotësimit të deklaratës periodike të vitit 2005 (datë 10.3.2006) në shumën 489,806.62 lekë.

prej 733,346 lekësh, kundërvlehtë për 5,952 euro me kursin e këmbimit të euros në datën 18.12.2006<sup>21</sup>.

#### **b) Analizë e shumës 30,000 euro nga të ardhurat e bashkëshortes**

2.11.3 Në DIPP-në e vitit 2006, subjekti ka deklaruar: *“Të ardhura nga bashkëshortja A. L. nga viti 1980 - 1999, kursime nga puna shumëvjeçare në Itali dhe për periudhën 8-vjeçare në Shqipëri si përfaqësuese e firmës italiane, në shumën 35,000 euro”*.

2.11.4 Nga leximi i deklaratave periodike vjetore, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-të e viteve 2003 - 2005 të ardhura dhe kursime nga të ardhurat e bashkëshortes.

2.11.5 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e dhëna për ILDKPKI-në në datën 13.5.2010, rreth deklaramit të vitit 2008, ka deklaruar se: *“Në deklaramin e bërë për llogari të vitit 2008 kam deklaruar shumën 10,000 euro, me përshkrimin ‘të ardhura nga bashkëshortja A. L. nga paga dhe qiradhënia e shtëpisë në U.’. Ju shpjegoj se bashkëshortja ime ka punuar për një periudhë të gjatë kohe si në Itali edhe në Shqipëri. Në Shqipëri ka punuar nga viti 1992 deri në vitin 1999. Pjesa e të ardhurave dhe kursimeve të kësaj periudhe nuk është pasqyruar nga ana ime, pasi nuk është krijuar me kontributin e përbashkët si bashkëshort. Në vitet në vazhdim pas martesës bashkëshortja ime ka përfutuar të ardhura mujore ndër vite (2002 e në vazhdim) nga sigurimet shëndetësore (për shkak të sëmundjes) në shumën që ka variuar nga 600 - 400 - 300 euro/muaj. Për vitet 2008 e në vazhdim shuma e përfutuar ka qenë 300 euro. Gjithashtu, bashkëshortja ime është bashkëtrashëgimtare në shtëpinë e banimit të prindërve në adresën: rr. ‘\*\*\*’. Shtëpia i jepet me qira simbolike kumatit, i cili banon në katin e dytë, për nevojat e aktivitetit të tij të biznesit dhe muajt e verës, një deri në dy muaj, sipas rastit me qira personave të njohur pa kontratë [...]. Duke qenë se bashkëshortja ime është shtetase e huaj nuk ka detyrimin ligjor të deklarojë pasuritë e saj në Shqipëri, vend në të cilin nuk ka lidhje biznesi apo punësimi. Pasuria e saj e krijuar në Itali është brenda limiteve të deklaramit të pasurisë në atë shtet. Në lidhje me pasurinë e saj nuk kam qenë në dijeni dhe as i interesuar për shkak se ajo ndodhet jashtë Shqipërisë dhe unë nuk kam kontribuar në fitimin e saj [...]. Në deklaramimet e mëparshme janë specifikuar burimet e pasurisë së saj, pa i konkretizuar me shifra. Në këtë rast bëhet fjalë për vlerën e eurove të sjella prej saj në Shqipëri, të siguruara nga kursimet ndër vite dhe të ardhurat vjetore dhe që janë përdorur për blerjen e banesës në Shqipëri të deklaruar më parë”*.

2.11.6 Komisioni vëren se, referuar ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, në nenin 21 të këtij ligji citohet: *“Deklarami përfshin pasurinë e subjektit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve në moshë madhore), burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjektit”*. Më tej, në nenin 22/II, përcaktohet: *“Anëtari i familjes dhe personi në lidhje me subjektin deklarues mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave të deklaruara”*.

2.11.7 Sipas certifikatës së martesës<sup>22</sup> të depozituar nga subjekti, konfirmohet se ai ka lidhur martesë me shtetasen italiane A. L. në U., Itali, në datën 28.8.1999. Por, në certifikatën familjare të lëshuar nga autoritetet shqiptare nuk rezulton që të jetë shënuar edhe emri i shtetasës A. L. në përbërjen e trungut familjar të subjektit të rivlerësimit Gjon Kodra, por vetëm emri i të birit Q.L.

<sup>21</sup>Kursi zyrtar i këmbimit në datën 18.12.2006, sipas Bankës së Shqipërisë është 123.21.

<sup>22</sup>Certifikatë martesë, datë 4.3.2021, U.



2.11.8 Komisioni i ka kërkuar subjektit të provojë me dokumentacion ligjor, në formën e kërkuar nga ligji, burimin e krijimit të shumës 35,000 euro të të ardhurave të realizuara nga bashkëshortja A. L.

Subjekti ka shpjeguar<sup>23</sup> se: “Në deklarin në DIPP-në e vitit 2006 është deklaruar kursime të bashkëshortes nga puna ndër vite shuma prej 35,000 euro. Në vitin 2006 nga kjo shumë prej 35,000 euro është bërë pagesa për blerjen e apartamentit [...]. Shuma e mbetur prej 5,000 euro është paguar dhe deklaruar në DIPP-në e vitit 2007 [...]. Në lidhje me dokumentacionin ligjor të të ardhurave në formën e kursimeve në shumën prej 35,000 euro të bashkëshortes sime A. L. nga viti 1978 - 1999 dhe për periudhën 8-vjeçare në Shqipëri si përfaqësuese e firmës italiane, janë depozituar pranë Komisionit si vijon: të gjitha llogaritë rrjedhëse të bashkëshortes ndër vite; vërtetimi i pagës në formën e kërkuar nga ligji, lëshuar nga titullari i firmës për periudhën e punësimit 1992 - 1999.

Vërtetimi nga titullari i firmës është kërkuar nga ne si dokument pasi për të gjitha pagesat për periudhën e punësimit 1992 - 1999 nuk bëheshin nëpërmjet llogarive bankare. Detyrimi ligjor për kalimin e pagave nëpërmjet llogarive bankare nga punëdhënësit është në vitin 2007. [...] Në lidhje me shumën prej 120 euro në muaj, e ardhur nga dhënia me qira e banesës së bashkëshortes motrës së saj, është depozituar deklarata në formën e kërkuar nga ligji nga shtetasja G. L. Siç e kam deklaruar dhe më parë, bashkëshortja është deklaruar në shtetin italian si invalide civile dhe trajtohet si e tillë, referuar ligjit italian për shërbimin kombëtar të asistencës sociale ‘I redditi esenti ai fini Iprej’ (të ardhurat e liruara për qëllime të tatimit mbi të ardhurat), për të ardhura vjetore deri në shumën prej 7,000 euro hyn në kategorinë e atyre personave që përjashtohen nga tatimin mbi fitimin”.

2.11.9 Subjekti ka depozituar: (i) “Estratto Conto Previdenziale” për periudhën 1978 – 2003; (ii) nxjerrje të llogarisë rrjedhëse me nr. \*\*\*, në emër të shtetasës A. L.; si dhe (iii) vërtetim datë 17.9.2018, të administratorit të shoqërisë “\*\*\*” srl.

2.11.10 Në pyetësin nr. 5, Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime në lidhje mënyrën e mbajtjes së kursimeve prej 35,000 euro (cash, në bankë, në Itali apo në Shqipëri) dhe si janë transferuar në Shqipëri.

Subjekti, ndër të tjera<sup>24</sup>, ka shpjeguar se nuk mund të vërtetojë me dokument ligjor se ku është mbajtur shuma 35,000 euro nga bashkëshortja e tij, pasi edhe legjislacioni nuk përcakton ndonjë dokument për mënyrën e ruajtjes së gjendjes cash. Bashkëshortja e subjektit ka pohuar se transferimi i parave të tërhequra në llogaritë e bankave në Itali janë bërë në përputhje me ligjet italiane dhe shqiptare dhe në çdo rast nuk është tejkalluar shuma për t’u deklaruar në pikat e kalimit kufitar të përcaktuar në ligjet shqiptare.

### **Tabela nr. 1**

2.11.11 Referuar dokumentacionit të disponuar, si dhe deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2006 dhe në pyetësorë, Komisioni vlerësoi të kryejë analizë për të evidentuar mundësinë financiare të bashkëshortes së subjektit për krijimin e kursimeve cash në periudhën 1980 – 1999 në shumën 35,000 euro, të cilat janë përdorur si burim për blerjen e apartamentit me sip. 129 m<sup>2</sup>.

<sup>23</sup>Shihni pyetësin nr. 3.

<sup>24</sup>Shihni pyetësin nr. 5.

Sipas treguesve financiarë të analizuar për të ardhurat dhe shpenzimet, duket se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka pasur mundësi të kursejë me të ardhura të ligjshme shumë 42,186 euro për periudhën 1980 – 1999, shumë kjo e mjaftueshme për të siguruar kursimet *cash* në shumë 35,000 euro, të deklaruar në DIPP-në e vitit 2006 si burim krijimi për blerjen e apartamentit me sip. 129 m<sup>2</sup>.

Viti	Të ardhurat në lireta	Të ardhurat në euro <sup>25</sup>	Shpenzimet jetike në Itali në lireta <sup>26</sup>	Shpenzimet jetike në Itali në euro <sup>27</sup>	Mundësia për kursim në lireta	Mundësia për kursim në euro	Shpenzimet jetike në Shqipëri në euro <sup>28</sup>	Mundësia për kursim në euro
1978	52,000	27	2,166,554	1,119	-2,114,554	-1,092		
1979	1,928,000	996	2,487,173	1,285	-559,173	-289		
1980	3,092,000	1,597	3,011,077	1,555	80,923	42		
1981	4,476,000	2,312	3,552,146	1,835	923,854	477		
1982	5,668,000	2,927	4,137,554	2,137	1,530,446	790		
1983	7,384,000	3,814	4,743,565	2,450	2,640,435	1,364		
1984	2,070,000	1,069	5,255,609	2,714	-3,185,609	-1,645		
1985	10,558,223	5,453	5,739,440	2,964	4,818,783	2,489		
1986			6,073,676	3,137	-6,073,676	-3,137		
1987			6,362,012	3,286	-6,362,012	-3,286		
1988	10,697,000	5,525	6,683,815	3,452	4,013,185	2,073		
1989	15,775,000	8,147	7,102,209	3,668	8,672,791	4,479		
1990	17,523,000	9,050	7,560,770	3,905	9,962,230	5,145		
1991			8,033,318	4,149	-8,033,318	-4,149		
<b>Total IT</b>	<b>77,243,223</b>	<b>39,893</b>	<b>68,255,191</b>	<b>35,251</b>	<b>8,988,032</b>	<b>4,642</b>		
1992	16,412,434	8,476					513	7,963
1993	623,000	322					513	-192
1994							513	-513
1995	8,199,000	4,234					511	3,723
1996	16,484,000	8,513					468	8,045
1997	15,882,000	8,202					364	7,838
1998	16,033,000	8,280					365	7,915
1999	6,210,000	3,207					442	2,765
<b>Total AL</b>	<b>79,843,434</b>	<b>41,236</b>					<b>3,691</b>	<b>37,544</b>
<b>Total (IT+AL)</b>								<b>42,186</b>

Nëse Komisioni merr në konsideratë në vlerësimin e mundësisë për kursim të bashkëshortes së subjektit edhe pasuritë vetjake të krijuara prej saj pas vitit 1999, në periudhën 2000 – 2005 deri në përdorimin e shumës 35,000 euro për blerje apartamenti, duket se ato nuk janë të mjaftueshme në shumë 4,196 euro (35,000 euro – 30,804 euro).

**Tabela nr. 2**

Nr.	Përshkrim	Vlera në euro
1	Të ardhura, vitet 1980 - 1991	39,893
2	Të ardhura, vitet 1992 - 1999	41,236

<sup>25</sup>Sipas INPS-së.

<sup>26</sup>Shpenzimet jetike në lireta për periudhën 1978 – 1996 janë përllogaritur bazuar në shpenzimin jetik të vitit 1997 sipas INSTAT Italia ([La povertà in Italia \(istat.it\)](http://La%20poverta%20in%20Italia%20(istat.it))) dhe indeksuar në vite sipas inflacionit.

<sup>27</sup>Shpenzimet jetike në euro për periudhën 1978 – 1991 janë llogaritur sipas raportit të këmbimit nxjerrë nga INPS-ja në llogaritjen e të ardhurave nga lireta në euro.

<sup>28</sup>Shpenzimet jetike për periudhën 1992 – 1999 janë marrë 5,000 lekë/muaj; shpenzimet jetike në lekë janë konvertuar në euro sipas kursit të këmbimit në Bankës Shqiptare për periudhën 1994 – 1999, për periudhën 1992 – 1993 është përdorur kursi i vitit 1994.

3	Të ardhura, vitet 2000 - 2005	19,001
4	Kredi për blerje automjeti 4,000,000 lireta <sup>29</sup>	2,066
5	Mundësia për kursime, viti 2001, subjekti <sup>30</sup>	2,800
<b>A</b>	<b>Totali i të ardhurave</b>	<b>104,996</b>
1	Shpenzime jetike, vitet 1980 - 1991	35,251
2	Shpenzime jetike, vitet 1992 - 1999 <sup>31</sup>	5,393
3	Shpenzime jetike, vitet 2000 - 2005 <sup>32</sup>	13,170
4	Shpenzime interesi 4,800,000 lireta <sup>33</sup>	2,479
5	Shpenzime udhëtimi, vitet 2004 - 2005 <sup>34</sup>	4,200
<b>B</b>	<b>Totali i shpenzimeve<sup>35</sup></b>	<b>60,493</b>
1	Blerja e automjetit, viti 1986 <sup>36</sup>	3,099
2	Blerja e automjetit, viti 2004	3,600
3	Ndryshim likuiditeti	7,000
<b>C</b>	<b>Totali i pasurive</b>	<b>13,699</b>
	<b>Mundësia për kursim (A-B-C)</b>	<b>30,804</b>

Komisioni, edhe pse analizo mundësinë hipotetike të bashkëshortes për krijimin e kursimeve *cash* në shumën 35,000 euro, vëren se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja në deklaratat periodike të viteve 2003 - 2005 nuk kanë deklaruar të ardhura, pasuri dhe likuiditete të bashkëshortes dhe deri në këto momente shuma 35,000 euro nuk i është marrë në konsideratë në analizën financiare.

**c) Analizë e burimit të krijimit të shumave 5,000 euro dhe 10,000 euro, pjesë e çmimit prej 50,952 euro të paguara përkatësisht në vitet 2007 dhe 2008**

2.11.12 Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me pagesat e kryera për apartamentin në vitin 2007 në shumën 5,000 euro dhe në vitin 2008 në shumën 10,000 euro, nuk ka deklaruar burim krijimi në deklaratat periodike të viteve 2007 - 2008.

2.11.12.1 Në shpjegimet e dhëna në pyetësorë, subjekti ka deklaruar se shumën e mbetur prej 5,000 euro nga kursimet *cash* të bashkëshortes pas pagesës së kryer prej 30,000 euro për apartamentin në vitin 2006, e ka përdorur në vitin 2007.

2.11.12.2 Duke qenë se deri në këtë fazë të hetimit Komisioni nuk ka marrë në konsideratë shumën 35,000 euro në analizën financiare, nuk ka konsideruar as shumën 5,000 euro (si pjesë përbërëse e shumës 35,000 euro) si pagesë për apartamentin.

<sup>29</sup>Deklaruar kredi e marrë me afat 5-vjeçar në shumën 4,000,000 lireta për blerje automjeti me këst 80,000 lireta/muaj.

<sup>30</sup>Referuar deklaratimit në pyetësorin nr.5 se djali i subjektit ka jetuar së bashku me nënën e tij në Itali për 1 vit dhe se shpenzimet janë mbuluar nga të ardhurat familjare, është llogaritur mundësia për kursim e subjektit për vitin 2001, duke përfshirë edhe të ardhurat/shpenzimet e prindërve.

<sup>31</sup>Shpenzimet jetike për vitin 1999, referuar deklaratimit të subjektit në pyetësorin nr. 5, janë llogaritur sipas INSTAT-it në Shqipëri për 8 muaj dhe INSTAT-it në Itali për 4 muaj.

<sup>32</sup>Shpenzime jetike për periudhën 2000 – 2005 janë llogaritur për 1 person, sipas INSTAT-it në Shqipëri, me përjashtim të vitit 2001, ku sipas deklaratimit të subjektit bashkëshortja e tij ka jetuar në Itali bashkë me djalin. Për këtë vit shpenzimet jetike janë llogaritur për 2 persona sipas INSTAT-it në Itali.

<sup>33</sup>Shuma totale e shlyer 4,800,000 lireta (80,000 lireta/muaj x 12 muaj x 5 vjet).

<sup>34</sup>Shpenzimet e udhëtimit janë llogaritur sipas deklaratimit të subjektit në pyetësorin nr. 5.

<sup>35</sup>Në lidhje me shpjegimet e subjektit të rivlerësimit për shpenzimet e qëndrimit në Itali për rreth një muaj në vitin 1999 (koha e ndërhyrjes kirurgjikale) deklaroi shpenzime 1,000,000 lireta, me burim të ardhurat e përbashkëta, ndërsa për shpenzimet e udhëtimit para sistemit *TIMS* deklaroi se janë bërë një deri dy herë në vit. Këto shpenzime nuk janë marrë në analizë në mundësinë e kursimit të bashkëshortes pasi subjekti deklaroi se janë mbuluar me të ardhura të përbashkëta. Komisioni i ka llogaritur këto shpenzime në periudhën 1993 – 2002.

<sup>36</sup>Deklaruar në pyetësorin nr. 5 se automjeti është blerë në vitin 1986 në shumën 6,000,000 lireta.

2.11.13 Komisioni<sup>37</sup> i ka kërkuar subjektit të specifikojë datën e pagesave prej 5,000 euro dhe 10,000 euro të deklaruara prej tij si pagesa për apartamentin në deklaratë periodike të viteve 2007 dhe 2008, si dhe cili ka qenë burimi i krijimit të këtyre dy shumave.

Subjekti ka shpjeguar se: *“Nuk më kujtohen datat e pagesave të mësipërme të cilat janë kryer në vitet respektive 2007 e 2008 [...]. Siç kam deklaruar më parë, shuma prej 5,000 euro e paguar në vitin 2007 është e ardhur nga kursimet e bashkëshortes sime gjatë viteve dhe konkretisht në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006 është deklaruar si e ardhur e bashkëshortes nga viti 1980 deri në vitin 1999, kursime nga puna shumëvjeçare në Itali dhe për periudhën 8-vjeçare në Shqipëri (Shkodër) në shumën prej 35,000 euro. Edhe në vitin 2008 është paguar shuma prej 10,000 euro, burimi i secilës është sqaruar dhe në deklaratimet e bëra në vite sipas deklaratave periodike, si dhe në përgjigjet e pyetësorëve të mëparshëm si burime të ligjshme financiare dhe dokumentacionit të depozituar pranë Komisionit”.*

2.12 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se:

- nga llogaritja e mundësisë financiare për kursim (të ardhura-shpenzime), në mungesë të deklaratimeve periodike të bashkëshortes për vitet 2003 - 2005, këto kursime mbeten të pa provuara dhe deri në këto momente Komisioni nuk i ka marrë në konsideratë. Subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të shpjegojë qëndrimin në raport me legjislacionin në fuqi;
- subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme për pagesën e kryer për apartamentin në vitin 2007 në shumën 5,000 euro;
- subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2008 burimin e pagesës së kryer për apartamentin në shumën 10,000 euro, por nga analiza financiare për këtë vit duket se ka mungesë burimesh të ligjshme.

Për konstatimet e mësipërme, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit dhe ju kërkuan shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Aneksit të Kushtetutës.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

2.13 Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me konstatimet e Komisionit në prapësimet e tij, ka shpjeguar, si vijon:

2.13.1 Për qëndrimin e tij në raport me ligjin nr. 9049/2003, subjekti ka shpjeguar se ka pasur paqartësi në lidhje me plotësimin e formularëve të deklaratimit për vitet 2003 - 2005 sepse fillimisht është kuptuar që subjekt deklarimi është vetëm zyrtari.

Në deklaratën e vitit 2003, si deklaratë për herë të parë, nuk rezulton ndonjë formular për deklarimin e personave të lidhur dhe në veçanti për persona që mbartin statusin shtetas të huaj. Gjithashtu, subjekti shpjegon se ka qenë i paqartë edhe në kuptimin e formularit A-5 “likuiditete” sepse përshkrimi në kolonën “vlehtë në milion/lekë ose valutë” është kuptuar prej tij si deklarim për gjendje likuiditeti në miliona valutë dhe se shuma e kursyer prej bashkëshortes së tij prej 35,000 euro ishte shumë herë më e vogël. Në asnjë rast subjekti nuk është instruktuar nga ILDKPKI-ja gjatë kontrolleve të kryera prej tyre se gjendja e likuiditeteve mund të deklarohet edhe në mijë, pavarësisht përshkrimit në milionë. Në deklaratimet pasardhëse për vitet 2004 - 2005, subjekti, nisur nga kërkesat e formularit se në të duheshin paraqitur vetëm ndryshimet, përsëri nuk ka deklaruar kursimet *cash* të bashkëshortes.

---

<sup>37</sup>Shihni pyetësorët nr. 4 dhe 5.

Subjekti i rivlerësimit deklaroi se paqartësia për deklarin ka ardhur edhe si pasojë e faktit që bashkëshortja e tij, si shtetase italiane, zotëronte pasuri të përbashkët me prindërit (të trashëguar), pasuri të luajtshme dhe likuiditete, të ardhura nga punësimi nga viti 1980 e në vijim, për të cilat ka bërë deklarinimet e detyrueshme pranë organeve italiane.

Për më tepër, shtetasja A. L. nuk është në përbërjen familjare të subjektit të rivlerësimit sepse martesë rezultoi e lidhur vetëm në Itali dhe jo në Shqipëri dhe, për rrjedhojë, nuk ka pasur detyrim për deklarinim.

Në deklarinimin e vitit 2006 dhe në momentin kur ka vendosur blerjen e apartamentit në Tiranë, subjekti shpjegoi se ka deklaruar kontributin e bashkëshortes dhe burimin e shumës 35,000 euro, për atë sa lejonte formati i deklarinimit. Duke nisur nga viti 2008 e në vijim, subjekti ka deklaruar saktë të ardhurat e bashkëshortes së tij.

Në analizimin e mundësisë financiare për kursim të bashkëshortes subjekti ka kërkuar që Komisioni duhet t'i referohet periudhës 1978 – 1999 sipas deklarinimit të subjektit në DIPP-në e vitit 2006 dhe jo periudhës deri në vitin 2005, si ka vepruar Komisioni.

2.13.2 Në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme në vitin 2007, subjekti pretendon se analiza financiare duhet të mbajë parasysh standardet dhe parimet e kontabilitetit, ku, ndër të tjera, analiza duhet të paraqesë në mënyrë kronologjike dhe sistematike efektet e veprimeve ekonomike dhe, për këtë arsye, të dhënat për pasqyrimin e treguesve financiarë nuk mund të analizohen të veçuara, të shkëputura pa vijimësinë, pa mbartur gjendjet e mëparshme.

Subjekti ka paraqitur një analizë financiare për periudhën 2002 – 2007, në të cilën ka mbartur në vitin pasardhës tepricat e rezultatit financiar. Sipas kësaj analize subjekti i rivlerësimit në vitin 2007 rezultoi me balancë pozitive. Subjekti ka kundërshtuar shpenzimet jetike të llogaritura nga Komisioni për periudhën 2000 – 2005 në shumën 13,170 euro, pasi bashkëshortja ka qëndruar tek prindërit dhe shuma që i duhet ngarkuar është 30 % e shpenzimeve të llogaritura nga Komisioni. Gjithashtu, si shpenzime jetike për periudhën 1980 – 1991 janë llogaritur shpenzime që nuk janë korrekte, pasi bashkëshortja ka qenë pjesëtare e familjes së saj prindërore. Familja e saj për periudhën 1980 – 1981 ka qenë me 5 anëtarë; për periudhën 1982 – 1996 ka qenë me 4 anëtarë; dhe për periudhën 1997 – 1999 ka qenë prej 3 anëtarë. Subjekti ka depozituar deklarinatën notoriale të kumatit L. D.I., i cili deklaroi se bashkëshortja e subjektit ka jetuar në banesën e prindërve, bashkë me nënën e saj dhe shpenzimet për ushqim e akomodim janë përballuar nga nëna. Pas vdekjes së nënës bashkëshortja e subjektit ka qëndruar në shtëpinë e kumatit të saj, i cili e ka akomoduar, duke përballuar shpenzimet për ushqim dhe fjetje, pasi shtetasja A. L. i kishte lënë në përdorim apartamentin e trashëguar nga e ëma, si dhe një garazh me një qira simbolike.

Subjekti ka paraqitur një analizë për mundësinë financiare të bashkëshortes për kursimin e shumës 35,000 euro duke përfshirë në të shpenzimet jetike sipas shpjegimeve të dhëna nga ku ka rezultuar me burime të mjaftueshme financiare për krijimin e shumës 35,000 euro deri në vitin 1999 dhe madje edhe deri në vitin 2005.

2.13.3 Në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme në vitin 2008, subjekti pretendon se Komisioni nuk duhet të llogarisë shpenzimet jetike të kryera nga bashkëshortja sepse këto shpenzime janë përballuar nga familja e prindërve të saj. Subjekti ka paraqitur një analizë financiare në të cilën ka mbartur balancën pozitive të vitit të mëparshëm, si dhe ka reflektuar ndryshime në të ardhurat e bashkëshortes, duke rezultuar me balancë pozitive për vitin 2008.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

2.14 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin për deklarimin e pasurive të bashkëshortes në përputhje me ligjin nr. 9049/2003 sepse rezulton që të ketë lidhur martesë me shtetasen A.L. në Itali, si dhe e ka deklaruar rregullisht si bashkëshorten e tij në përbërjen familjare në deklaratat periodike ndër vite.

Ndër shpjegime të tjera, në seancën dëgjimore, subjekti, i pyetur nga Komisioni, ka shpjeguar se deklarimi i shumës është bërë në vitin 2006 në kohën e prenotimit të apartamentit dhe jo më parë në vitet 2004 ose 2005, sepse në atë kohë ai kishte filluar të interesohej për kredi për blerjen e banesës dhe pikërisht në atë kohë bashkëshortja e tij ka ofruar përdorimin e shumës 35.000 euro, që ishin kursimet e saj të krijuara nga puna para martesë. Për këto kursime subjekti i rivlerësimit shpjegon se nuk e kishte konsideruar të drejtë për t'i kërkuar bashkëshortes informacione, për arsye se ishin pasuri të krijuara para martesë dhe ai nuk kishte asnjë kontribut në këtë shumë.

2.15 Në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme në vitin 2007, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse. Analiza financiare e kryer nga Komisioni nuk bie në kundërshtim me standardet dhe parimet e kontabilitetit sepse ajo i paraqet në mënyrë kronologjike dhe me vërtetësi efektet e veprimeve ekonomike. Balancat pozitive të rezultatit financiar të viteve paraardhëse nuk mund të mbarten në vitin tjetër sepse në këtë mënyrë do të cenohej parimi i paraqitjes me vërtetësi i informacionit. Komisioni kryen analizën financiare bazuar në informacionin e deklaruar në deklaratat periodike të subjektit të rivlerësimit, duke i paraqitura ato me vërtetësi.

Në këto deklaratat subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar balancat pozitive të pretenduara në prapësime si kursime për t'u përdoruar në vitin pasardhës. Likuiditetet e deklaruara në DIPP nga subjekti i rivlerësimit janë marrë në konsideratë në analizën financiare të kryer nga Komisioni, duke respektuar parimin e pasqyrimin me vërtetësi të informacionit.

Në lidhje me pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit për shpenzimet jetike të bashkëshortes për periudhën 1980 – 1999, Komisioni i vlerësoi ato bindëse dhe se shpenzimet jetike për bashkëshorten duhen llogaritur në bazë të përbërjes familjare të saj si në Shqipëri ashtu edhe në Itali.

Komisioni ka ripërlllogaritur shpenzimet jetike në Itali për periudhën 1980 – 1991 sipas përbërjes familjare të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe i ka ngarkuar bashkëshortes së subjektit pjesën e saj të shpenzimeve, pra: (a) për periudhën 1980 – 1981 i ka ngarkuar 1/5 e shpenzimeve jetike të një familjeje me 5 anëtarë; (b) për periudhën 1982 – 1991 i ka ngarkuar 1/4 e shpenzimeve jetike të një familjeje me 4 anëtarë; ndërsa (c) për periudhën 1992 – 1999 marrë në konsideratë faktin se bashkëshortja e subjektit ka punuar dhe jetuar në Shqipëri, shpenzimet jetike janë llogaritur sipas shpenzimeve jetike shqiptare, pasi bashkëshortja e subjektit ka jetuar dhe punuar në Shqipëri.

Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se shpenzimet jetike për periudhën 2000 – 2005 duhen llogaritur sa 30 % e vlerës, Komisioni vëren se nuk qëndron sepse shpenzimet jetike të bashkëshortes së subjektit për vitet 2000 dhe 2002 - 2005 janë llogaritur sipas shpenzimeve jetike në Shqipëri dhe vetëm për vitin 2001 janë llogaritur sipas shpenzimeve jetike në shtetin italian, ku bashkëshortes së subjektit i janë ngarkuar 2/3 e shpenzimeve jetike (bashkëshortja dhe djali) të një familjeje me 3 anëtarë.

Komisioni, pasi verifikoi shumën, e saktësoi atë në vlerën 12,392 euro nga 13,170 euro që ishte pasqyruar fillimisht në analizën financiare të mundësisë për kursim të bashkëshortes së subjektit.

2.16 Në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme në vitin 2008, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse sepse, referuar analizës financiare të kryer prej tij, janë marrë në konsideratë jo vetëm balancat pozitive të mbartura nga vitet paraardhëse, por edhe të ardhura të bashkëshortes për të cilat nuk është provuar se është paguar tatim. Në analizën e subjektit nuk janë kundërshtuar shpenzimet e llogaritura nga Komisioni për vitin 2008.

**Në përfundim, Komisioni, pasi mori në konsideratë pretendimet e subjektit, në lidhje me shpenzimet jetike të bashkëshortes në përlogaritjen e mundësisë financiare për kursimin e shumës 35,000 euro, kreu rilogaritjet deri në vitin 2005, nga ku rezultoi se bashkëshortja e subjektit ka pasur mundësi që me të ardhura të ligjshme të kursejë shumën 35,000 euro.**

Komisioni, duke vlerësuar faktin që subjekti ka deklaruar kursimet e bashkëshortes nga të ardhurat nga punësimi, si burim krijimi për blerje e apartamentit që në DIPP-në e vitit 2006 dhe jo në atë *Vetting*, por nga ana tjetër i ka deklaruar të ardhurat nga punësimi si në DIPP-në e vitit 2006, nga viti 2008 e në vazhdim, në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në vitin 2010, ashtu edhe në deklaratën *Vetting*, si dhe duke pasur në konsideratë faktin se bashkëshortja ka pasur të ardhura të ligjshme për të kursyer këtë shumë, arrin në konkluzionin se shuma 35,000 euro duhet përfshirë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, pavarësisht konfuzionit të subjektit për deklarimin e kësaj shume ndër vite.

Mosdeklarimi i të ardhurave të bashkëshortes dhe i kursimeve të saj në deklaratat e pasurisë në vitet 2004 - 2005, që në fakt janë deklaruar në DIPP në e vitit 2006 e në vazhdim prej vitit 2008, përfshirë edhe në deklaratën *Vetting*, dokumente që në kuptim të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 kanë vlerën e provës, por që nga ana tjetër provohet bindshëm mundësia e bashkëshortes për kursimin e shumës 35,000 euro, konsiderohet nga Komisioni si pasaktësi në deklarim e cila nuk vlerësohet deri në atë masë sa të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

**3. Automjet tip “Volkswagen Passat”, i vitit 1998, me targa \*\*\*, blerë me kontratë shitblerjeje, datë 29.3.2008<sup>38</sup>, me vlerë 230,000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.**

3.1 Në deklaratën *Vetting* subjekti nuk ka deklaruar burim krijimi. Po kështu, në DIPP-në e vitit 2008 subjekti ka deklaruar blerjen e automjetit, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit.

3.2 DPSHTRR-ja<sup>39</sup> ka depozituar dosjen e automjetit tip “Volkswagen Passat”, me targa \*\*\*, të regjistruar në emër të z. Gjon Kodra. Nga dokumentacioni rezulton se ky automjet është blerë nga subjekti me kontratën e datës 29.3.2008<sup>40</sup> nga shitësi H. T., për çmimin 230,000 lekë. Rezulton se shitësi H. T. kishte paguar për këtë automjet [vlerën 304,650 lekë (2500 euro) + doganën 247,270 lekë], në total 551,920 lekë dhe pas 4 muajsh, pasi e kishte blerë, ia shet me humbje subjektit në vlerën 230,000 lekë.

3.3 Në lidhje me mosdeklarimin e burimit të krijimit të kësaj pasurie, subjekti ka shpjeguar se: “[...] në seksionin ‘Ndryshimet e interesave private, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme’ kam deklaruar emërtesën e pasurisë (mjetit), pasi të ardhurat e subjektit të rivlerësimit janë deklaruar në seksionin tjetër të formularit të deklaratës dhe konkretisht në seksionin ‘Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private’, të cilat janë të mjaftueshme për të mbuluar krijimin (blerjen) e këtij mjeti. I njëjti shpjegim vlen edhe për mosdeklarimin në deklaratën *Vetting*

<sup>38</sup>Kontratë shitblerjeje automjeti nr. \*\*\*, datë 29.3.2008.

<sup>39</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.2.2020, e DPSHTRR-së.

<sup>40</sup>Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 29.3.2008.

të burimit të krijimit të mjetit, pra të ardhurat e realizuara në veçanti për vitin 2008 mbulojnë krijimin (blerjen) e këtij mjetei [...]”.

3.3.1 Në lidhje me diferencën e çmimit të shitjes nga shitësi tek subjekti, ky i fundit, ndër të tjera, ka shpjeguar se diferenca në çmim ka qenë për shkak se automjeti kishte një të metë teknike. Në DIPP-në e vitit 2008 subjekti ka deklaruar vlerën 260,000 lekë, e cila ishte çmimi i kontratës dhe vlera e riparimit të defektit 30,000 lekë. Shitësin H. T. subjekti deklaroi se nuk e njihte, e ka takuar vetëm kur ka blerë automjetin, gjithashtu shpjegon se nuk ka pasur dijeni sa e kishte blerë vetë shitësi këtë automjet, por ai është interesuar vetëm për çmimin që duhej të paguante (çmimin e kontratës + servisit).

3.4 Komisioni ka hetuar për ndonjë situatë konflikti interesi të subjektit me shtetasin H. T. dhe nga hetimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë<sup>41</sup>.

### 3.5 Analizë e burimit të krijimit të automjetit tip “Volkswagen Passat”

Komisioni vlerësoi të kryejë analizën financiare për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit për blerjen e këtij automjeti, duke iu referuar burimit të të ardhurave të deklaruar në pyetësor dhe bazuar në dokumentacionin ligjor të disponuar, konkretisht:

**Tabela nr. 3**

<b>Përshkrimi</b>	<b>Periudha 1.1.2008 – 29.3.2008</b>
<b>Të ardhurat</b>	<b>337,599</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	175,580
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	95,758
Të ardhura nga pensioni i nënës	25,950
Të ardhura nga pensioni i babait	40,311
<b>Detyrime</b>	<b>0</b>
<b>Shpenzime</b>	<b>262,875</b>
Shpenzime jetike	170,775
Shpenzime udhëtimi	62,100
Shpenzime dok. për automjetin, ***	30,000
<b>Pasuri</b>	<b>165,765</b>
Kursime (shtesa/pakësime likuiditeti)	-64,235
Automjet tip “Volkswagen Passat” ***	<b>230,000</b>
<b>Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri</b>	<b>-91,041</b>

3.6 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit:

- nuk ka deklaruar burimin e krijimit të automjetit tip “Volkswagen Passat” në DIPP-në e vitit 2008 dhe në atë *Vetting*;
- nuk ka pasur burime të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve dhe blerjen e automjetit në datën 29.3.2008, pasi nga analiza financiare për periudhën 1.1.2008 – 29.3.2008 ka rezultuar me balancë negative në shumën 91,041 lekë.

<sup>41</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.6.2021, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.



Për konstatimet e mësipërme, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit dhe ju kërkuan shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Aneksit të Kushtetutës.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

3.7 Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me konstatimet e Komisionit në prapësimet e tij, ka shpjeguar se mosdeklarimi i burimit ka qenë më shumë lapsus/gabim njerëzor/harresë.

Ndërsa, në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit, subjekti shpjegon se Komisioni, edhe pse e ka konfirmuar tepriçën e gjendjes së kursimeve *cash* prej 400,000 lekësh të deklaruar prej subjektit deri në fund të vitit 2007, nuk e ka marrë parasysh në analizën e kryer për blerjen e tij. Kjo shumë mund të përdorej nga subjekti në mars të vitit 2008 dhe deri në fund të vitit të zëvendësohej me të ardhura të tjera të vitit, duke mos sjellë ndryshim të kursimeve në fund të vitit 2008 prej 400,000 lekësh.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

3.8 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin për deklarimin e burimit të këtij automjeti në deklaratën periodike dhe atë *Vetting*, por kjo mbetet pasaktësi.

Në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit, Komisioni vëren se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit qëndrojnë dhe se kursimet *cash* në shumën 400,000 lekë rezultojnë të jenë krijuar me burime të ligjshme dhe mund të jenë përdorur nga subjekti për blerjen e automjetit në shumën 230,000 lekë.

Në seancë dëgjimore subjekti deklaroi se u qëndron shpjegimeve të dhëna në prapësime pas kalimit të barrës së provës dërguar nga Komisioni.

**Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pasaktë, në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, në kundërshtim me pikën 5/a, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, por subjekti ka pasur burime të ligjshme për blerjen e automjetit dhe kjo pasaktësi nuk është në masën që t'i aplikohet masa disiplinore e shkarkimit.**

### **4. Gjendja e likuiditeteve *cash***

4.1 Subjekti, duke zbritur shpenzimet familjare vjetore, udhëtimet jashtë shtetit në Itali dhe Gjermani, pagesën e hipotekës së apartamentit të blerë, pagesën e shkollës së djalit Q. L. për vitin 2016, sipas deklarimeve të çdo viti, ka gjendje *cash* në shumat 8,850 euro dhe 660,000 lekë, nga këto 430,512.39 lekë ndodhen në llogarinë rrjedhëse dhe ka deklaruar të njëjtën situatë të gjendjes *cash* edhe në DIPP-në e vitit 2016.

4.2 Deklarimi, ndër vite, i subjektit në lidhje me kursimet pasqyrohet në tabelën vijuese:

**Tabela nr. 4**

Viti	Deklarimi periodik	Gjendja e kursimeve <i>cash</i> në lekë/euro
2005	480,000 lekë kursime në llogarinë rrjedhëse	-
2006	400,000 lekë gjendje <i>cash</i> nga kursimet në vitin 2006/të ardhura nga bashkëshortja A. L. për vitet 1980 - 1999, kursime nga puna shumëvjeçare në Itali dhe për periudhën 8-vjeçare në Shqipëri si përfaqësuese e firmës italiane. 35,000 euro	400,000 lekë
2007	-	400,000 lekë
2008	-	400,000 lekë

2009	-	400,000 lekë
2010	Shtesë e kursimeve në <i>cash</i> nga të ardhurat vjetore dhe qiraja e shtëpisë së bashkëshortes në Itali dhe dhurata, 6,000 euro <sup>42</sup>	400,000 lekë + 6,000 euro
2011	Shtesë e kursimeve në <i>cash</i> nga të ardhurat vjetore dhe qiraja e shtëpisë së bashkëshortes në Itali dhe dhurata, 6,000 euro <sup>43</sup>	400,000 lekë + 12,000 euro
2012	Shtesë kursimesh gjatë vitit 2012 nga të ardhurat vjetore familjare, 400,000 lekë. Në f. 7 deklaron “shuma e likuiditeteve në <i>cash</i> e akumuluar deri në vitin 2012 nga të ardhurat familjare ndër vite (2006 - 2012) sipas deklarimeve të çdo viti = 12,000 euro dhe 800,000 lekë” <sup>44</sup> .	800,000 lekë + 12,000 euro
2013	Shtesë kursimesh në <i>cash</i> gjatë vitit 2013 nga të ardhurat vjetore familjare 500,000 lekë. Në f. 7 deklaron “shuma e likuiditeteve në <i>cash</i> e akumuluar deri në vitin 2013 nga të ardhurat familjare ndër vite (2006 - 2013) sipas deklarimeve të çdo viti = 12,000 euro dhe 1,300,000 lekë”.	1,300,000 lekë + 12,000 euro
2014	Shtesë e kursimeve në <i>cash</i> nga të ardhurat familjare në vitin 2014 për 3,000 euro. Shuma e likuiditeteve në <i>cash</i> e akumuluar deri në vitin 2014 nga të ardhurat familjare (2006 - 2014) sipas deklarimeve të çdo viti = 15,000 euro dhe 1,300,000 lekë.	1,300,000 lekë + 15,000 euro
2015	Shtesë e kursimeve <i>cash</i> nga të ardhurat familjare, 1,000 euro. Në f. 7 deklaron “shuma e likuiditeteve në <i>cash</i> e akumuluar deri në vitin 2015 nga të ardhurat familjare sipas deklarimeve të çdo viti = 16,000 euro dhe 1,219,287 lekë”.	800,000 lekë <sup>45</sup> + 16,000 euro
2016	Shuma e likuiditeteve <i>cash</i> e akumuluar, duke zbritur shpenzimet familjare të pushimeve vjetore, udhëtimet jashtë shtetit në Itali e Gjermani, pagesën e hipotekës së apartamentit të blerë, pagesa e shkollës së djalit Q.L. për vitin 2016, sipas deklarimeve të çdo viti 8,850 euro dhe 660,000 lekë, nga kjo shumë 430,512,39 lekë ndodhen në llogarinë rrjedhëse.	328,130 <sup>46</sup> lekë + 8,850 euro

<sup>42</sup>Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, subjekti ka deklaruar shtesë të kursimeve *cash* në shumën 6,000 euro, me burim: (i) të ardhurat vjetore të bashkëshortes; (ii) të ardhurat nga qiraja; (iii) dhuratat. Në të njëjtën deklaratë subjekti ka deklaruar të ardhura nga paga dhe dhënia me qira e shtëpisë së bashkëshortes në shumën 5,000 euro dhe dhuratat për shtëpinë e re nga dy motrat që jetojnë e punojnë në USA 2,000 USD. Rezulton se nga lëvizja e llogarisë bankare në Itali, depozituar nga subjekti si dokumentacion provues për përfitimin e të ardhurave nga bashkëshortja e tij, të ardhurat e përfituara në formën e pensionit janë në shumën 3,468 euro për vitin 2010. Në lidhje me të ardhurat nga qiraja, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në ILDKPKI se: “Shtëpia jepet me qira simbolike kumatit, i cili banon në katin e dytë, për nevojat e aktivitetit të tij të biznesit dhe muajt e verës, një deri në dy muajt, sipas rastit me qira personave të njohur pa kontratë...”.

<sup>43</sup>Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar sërish shtesë të kursimeve *cash* në shumën 6,000 euro, me burim: (i) të ardhurat vjetore të bashkëshortes; (ii) të ardhurat nga qiraja; (iii) dhuratat. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga paga dhe dhënia me qira e shtëpisë së bashkëshortes në shumën 5,000 euro. Nga dokumentacioni provues rezulton se të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja si pension janë në shumën 3,517 euro. Për të ardhurat nga qiraja nuk ka dokumentacion provues. Në këtë deklaratë subjekti nuk ka deklaruar dhurata.

<sup>44</sup>Në DIPP-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar në rubrikën e ndryshimeve të pasurisë shtesën e kursimeve *cash* gjatë vitit 2012 në shumën 400,000 lekë, me burim të ardhurat vjetore. Në të njëjtën deklaratë, në rubrikën e të dhënave konfidenciale, ka deklaruar se shuma e likuiditeteve *cash* të akumuluar deri në vitin 2012 nga të ardhurat familjare ndër vite (2006 - 2012) është 12,000 euro dhe 800,000 lekë. Subjekti ka deklaruar në mënyrë të saktë kursimet *cash*, duke deklaruar shtesën e tyre për secilin vit, si dhe duke u treguar i kujdesshëm të saktësojë gjendjen e tyre në fund të vitit.

<sup>45</sup>Subjekti, pavarësisht se në deklarinë në DIPP-në e vitit 2015 i referohet shumës prej 1,219,287 lekësh si “shuma e likuiditeteve *cash* të akumuluar”, nga deklarimi i tij i llogarisë bankare prej 419,287 lekësh duket se pjesa e kursyer *cash* është diferenca e kursimeve të akumuluar të deklaruar prej tij me gjendjen e llogarisë bankare (1,219,287 lekë - prej 419,287 lekësh) = 800,000 lekë.

<sup>46</sup>Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti deklaron likuiditete *cash* në shumën 660,000 lekë, nga të cilat 430,512.39 lekë janë në llogarinë bankare, duke nënkuptuar se subjekti me “likuiditete *cash*” i referohet kursime *cash* edhe në bankë.

4.3 Subjekti deklaron për herë të parë kursime në DIPP e 2005 dhe i referohet gjendjes së llogarisë bankare, e cila sipas konfirmimit bankar të llogarive rezulton në shumën 369,794 lekë.

Në DIPP-në e 2006 subjekti deklaron për herë të parë *kursime cash* në shumën 400,000 lekë. Gjithashtu, në këtë deklaratë, subjekti deklaron edhe kursime të bashkëshortes nga puna shumëvjeçare në Itali dhe në Shqipëri, në shumën 35,000 euro, nga të cilat 30,000 euro janë përdorur si burim për pagesën e apartamentit në vitin 2006.

Në DIPP-në e viteve 2007 - 2009 subjekti nuk deklaron ndryshim të kursimeve *cash*.

Në DIPP-të e viteve 2010 - 2011 subjekti deklaron shtesë kursimesh çdo vit nga 6,000 euro me burim të ardhurat nga paga e bashkëshortes, qiraja, dhuratat. Nga administrimi i dokumentacionit rezulton se subjekti nuk ka provuar me dokument të ardhurat nga qiraja të përfituara nga bashkëshortja dhe pagesën e tatimeve për to dhe të ardhurat nga pagat e bashkëshortes të nxjerra nga llogaria e saj bankare janë në vlerë më të vogël se shtesat e kursimeve.

4.3.1 Në lidhje me mundësinë e bashkëshortes së subjektit për të kursyer me të ardhura të ligjshme shumën 35,000 euro për periudhën 1980 – 1999, Komisioni kreu analizë, e cila është trajtuar gjerësisht në pikën 2.11.2 (b) të raportit.

4.3.2 Në lidhje me mundësinë e subjektit për të krijuar kursimet *cash* me të ardhura të ligjshme gjatë periudhës së deklaramit, Komisioni i është referuar analizës financiare për periudhën 2003 – 2016<sup>47</sup>.

**Nuk konstatohen problematika në lidhje me deklaramet e gjendjes *cash* nga subjekti.**

**5. Gjendje në llogarinë bankare, në shumën 610,512.39 lekë, në “Credins Bank”, në datën 7.1.2017. Nga kjo shumë zbritet *overdrafti* prej 180,000 lekësh. Gjendja e mbetur: 430,512.39 lekë.**

5.1 “Credins Bank”<sup>48</sup> ka konfirmuar llogarinë e pagës në emër të subjektit të rivlerësimit. e cila figuron e hapur në vitin 2010.

5.2 Nga pasqyrat e lëvizjes së llogarisë bankare rezulton se gjendja në datën 7.1.2017 është në shumën 420,512.39 lekë. Diferenca ndërmjet gjendjes së disponueshme prej 610,513.39 lekësh dhe gjendjes së llogarisë prej 420,512.39 lekësh është shuma e *overdraft*-it që subjekti ka aktiv me bankën.

**Nuk konstatohen problematika në lidhje me llogarinë bankare në “Credins Bank”.**

**PERSONI I LIDHUR ME SUBJEKTIN/ BASHKËSHORTJA A. L.**

**6. Banesë dykatëshe, k. \*\*\*, me adresë: \*\*\*, Itali. Pjesa takuese: 50 %. Burimi i krijimit: trashëgimi.**

6.1 Së bashku me pyetësin nr. 1, subjekti ka depozituar dokumentin e trashëgimisë (në gjuhën italiane e përkthyer në shqip<sup>49</sup>), të datës 26.11.2004<sup>50</sup>. Sipas këtij dokumenti, trashëgimtarë me 1/3 pjesë secili janë shtetasit G., L. dhe A. L., fëmijë të trashëgimlënësve Q. L. dhe bashkëshortes së tij Cosima Calignano (të dy kanë ndërruar jetë). Të tre fëmijët janë bashkëpronarë të: (a)

<sup>47</sup>Shihni analizën financiare për periudhën 2003 – 2016.

<sup>48</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.4.2020, e “Credins Bank”.

<sup>49</sup>E sjellë nga subjekti me pyetësin nr. 1.

<sup>50</sup>Dokumenti i ndarjes së trashëgimisë me nr. \*\*\*, datë 26.11.2004, në gjuhën italiane, i përkthyer dhe noterizuar.

godinës në U., në \*\*\*, Itali, që përbëhet nga një banesë, garazh dhe banesë në katin e parë; dhe (b) të një pasurie të ndashme me vlerë totale 170,820 euro.

Me këtë dokument bëhet ndarja, ku ndër të tjera, shtetasve L. dhe A. L., të cilët, së bashku/individualisht dhe në pjesë të barabarta, u caktohet si e ndarë pronësia e plotë mbi pasuritë e mëposhtme: (a) banesa në \*\*\* në katin përdhes me 5 ambiente kryesore ndihmëse, pa zonat më lart, pasi janë të banesës së caktuar motrës G.; (b) si pjesë përkatëse e saj ambienti ngjitur garazhit rreth 25 m<sup>2</sup>, edhe ai pa zonat lart. Vlera e kuotës është e barabartë me 113,880 euro.

6.2 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e dhëna për ILDKPKI-në në datën 13.5.2010, rreth deklarimit të vitit 2008, ka deklaruar se: “[...] *Bashkëshortja ime është bashkëtrashëgimtare në shtëpinë e banimit të prindërve në adresën: rr. ‘\*\*\*’. Shtëpia jepet me qira simbolike kunatit, i cili banon në katin e \*\*\*, për nevojat e aktivitetit të tij të biznesit dhe muajt e verës, një deri në dy muaj, sipas rastit me qira personave të njohur pa kontratë [...]. Duke qenë se bashkëshortja ime është shtetase e huaj, nuk ka detyrimin ligjor të deklarojë pasuritë e saj në Shqipëri, vend në të cilin nuk ka lidhje biznesi apo punësimi. Pasuria e saj e krijuar në Itali është brenda limiteve të deklarimit të pasurisë në atë shtet. Në lidhje me pasurinë e saj nuk kam qenë në dijeni dhe as i interesuar, për shkak se ajo ndodhet jashtë Shqipërisë dhe unë nuk kam kontribuar në fitimin e saj”.*

6.3 Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 2, i ka kërkuar subjektit të shpjegojë mosdeklarimin e kësaj pasurie në deklaratat e pasurisë për vitet 2004 - 2007. Subjekti ka shpjeguar se: “*Kjo banesë ka qenë në pronësi të prindërve të bashkëshortes. Unë kam deklaruar banesën dhe adresën e saj, si vendqëndrimi gjatë kohës që kam qëndruar në Itali”.*

6.4 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar mosdeklarimin e kësaj pasurie në DIPP-të e viteve 2004 - 2007, pasuri kjo e kaluar në pronësi të bashkëshortes për pjesën e saj takuese në vitin 2004.

Për këtë konstatim, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Kushtetutës.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

6.5 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, ndër të tjera, ka shpjeguar se ka qenë korrekt me kërkesat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë, lidhur me deklarimin e pasurisë që ndodhet jashtë territorit shqiptar, dhe konkretisht, në pikën 3 të nenit 32, “Deklarimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, citohet: “3. *Nëse subjekti i rivlerësimit ose personat e lidhur kanë pasuri jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ai paraqet deklaratimet bankare të viteve të fundit, të dhënat e fundit mbi regjistrimin e pasurisë ose dokumente të tjera që tregojnë vlerën e pasurive që ndodhen jashtë shtetit.*

*Pavarësisht konstatimit të Komisionit që kjo pasuri nuk është deklaruar në DIPP-të e viteve 2004 - 2007, theksoj edhe një herë se për këtë mosdeklarim në DIPP-të e viteve 2004 - 2007, sipas procesverbalit dhe nga institucioni nuk më është referuar ndonjë ligj që kërkon ndryshe nga ajo që subjekti ka deklaruar. Në rast se do të ishte ndryshe, pra, që subjekti të ketë deklaruar dhe dhënë shpjegime jo në përputhje me kërkesat ligjore, atëherë duhej të ishte vlerësuar si fakt/deklarim jo i rregullt për të cilën do të aplikoheshin sanksionet e përcaktuara në ligjin nr. 9049/2003.*

*Sa kohë që nuk është ndërmarrë një masë e tillë ndaj subjektit të rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, tregon që parregullsitë e konstatuara nuk kanë përbërë arsye për zbatimin e sanksioneve, sipas*

*kërkesave të ligjit nr. 9049/2003, pasi janë vlerësuar si të tilla (parregullsi/lapsuse/gabime njerëzore)”.*

Subjekti ka deklaruar në seancën dëgjimore se u qëndron shpjegimeve të dhëna në prapësime pas kalimit të barrës së provës dërguar nga Komisioni.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

6.5.1 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklaram që ka të bëjë me mosdeklarimin e saj në DIPP-të e viteve 2004 - 2007, sipas përcaktimeve në neni 21 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, ku citohet se: *“Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve në moshë madhore), burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjektit”.* Por, Komisioni mban në konsideratë faktin se subjekti i rivlerësimit këtë pasaktësi e ka rregulluar me deklarimin në deklaratën *Vetting*.

**Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklaram, që ka të bëjë me mosdeklarimin e kësaj pasurie të bashkëshortes në DIPP-të e viteve 2004 - 2007, por duke marrë në konsideratë faktin se kjo pasuri është deklaruar në deklaratën *Vetting*, e cila është deklarata bazë e pasurisë mbi të cilën bazohet në thelb procesi i rivlerësimit, e miratuar me ligjin nr. 84/2016, kjo pasaktësi nuk ndikon deri në atë masë sa të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.**

### **7. Automjet tip “Fiat Bravo”, prodhim i vitit 1997. Pjesa takuese: 100 %. Nuk është deklaruar burim krijimi.**

7.1 Komisioni<sup>51</sup> i ka kërkuar subjektit të shpjegojë mosdeklarimin e burimit të krijimit në deklaratën *Vetting*, si dhe mosdeklarimin e këtij automjeti në deklaratat periodike vjetore.

7.1.1 Subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se ligji nuk ka parashikuar qartë ndonjë procedurë për këto marrëdhënie juridike që krijohen nga martesat e subjekteve me shtetas të huaj lidhur me deklaramet periodike. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se për sa kohë është kontrolluar nga ILDKPKI-ja dhe nuk është njoftuar prej tyre për ndonjë parregullsi në plotësimin e deklaratave periodike, ka menduar se pavarësisht lapsuseve, interpretimeve të ndryshme, të ardhurat e tij si subjekt janë të ardhura të ligjshme dhe mbulojnë të gjitha pasuritë, shpenzimet e kryera nga subjekti rivlerësues.

7.2 Komisioni<sup>52</sup> i ka kërkuar subjektit të shpjegojë se kur është blerë automjeti tip “Fiat Bravo”, dokumentacionin, çmimin e blerjes dhe statusin e tij aktual.

7.2.1 Subjekti ka shpjeguar se ky automjet i vitit 1997, me targa \*\*\*, është blerë nga bashkëshortja A. L. në vitin 2004 në Itali, me çmim total 3,600 euro, me burim nga të ardhurat e familjes së subjektit. Ky automjet është dërguar në korrik të vitit 2017 në një pikë skrapit, në L., Itali, duke dalë nga qarkullimi për shkak amortizimi.

7.2.2 Subjekti ka depozituar certifikatën e pronësisë së këtij automjeti në emër të shtetasës A. L. në gjuhën italiane, të pa përkthyer/noterizuar, më shënimin “nxjerrje nga qarkullimi në datën 10.7.2017”.

---

<sup>51</sup>Shihni pyetësin nr. 2.

<sup>52</sup>Shihni pyetësin nr. 4.

7.2.3 Subjektit<sup>53</sup> i është kërkuar të specifikojë datën e blerjes së këtij automjeti për efekt të analizës financiare, për të cilën nuk ka dhënë shpjegime për datën, por vetëm ka deklaruar vitin e blerjes, 2004.

7.3 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-të e viteve 2004 - 2016 automjetin tip “Fiat Bravo” të bashkëshortes.

Për këtë konstatim subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Kushtetutës.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

7.4 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, ka shpjeguar se për mosdeklarimin në DIPP-të e viteve 2004 - 2016 të automjetit tip “Fiat Bravo” të bashkëshortes ka dhënë shpjegime dhe më parë (nëpër pyetësorë, pika 7.2.1), duke vënë në dispozicion të Komisionit dokumentacionin përkatës të pronësisë së bashkëshortes dhe të heqjes nga qarkullimi për shkak amortizimi.

Në procesverbalin e mbajtur midis subjektit të rivlerësimit dhe institucionit të ILDKPKI-së nuk është evidentuar ndonjë fakt që të shërbejë si objekt penalizimi, ku tregon se janë trajtuar si parregullsi/gabim njerëzor pa efekte në gjendjen faktike të pasurisë së subjektit të rivlerësimit të krijuara me burime të ligjshme. Edhe referuar analizës financiare, vlerës së blerjes së automjetit prej 3,600 euro, subjekti ka rezultuar me tepriçë pozitive prej 2,50 euro. Shpjegimet e dhëna për mosdeklarimin e mjetit në vitet 2004 - 2016 janë të qarta, duke përmbushur kërkesat e nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në lidhje me pasurinë e bashkëshortes, subjekti sqaron se nuk ka qenë në dijeni dhe as i interesuar për shkak se ajo ndodhej jashtë Shqipërisë dhe nuk ka kontribuar në kursimet e saj. Po kështu, që nga viti 2009 e në vazhdim nuk i janë kërkuar nga ILDKPKI-ja të dhëna të hollësishme rreth kësaj pasurie apo të ardhurave.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

7.4.1 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklaram që kanë të bëjnë me mosdeklarimin në DIPP-të e viteve 2004 - 2016, sipas përcaktimeve të nenit 21 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, ku citohet: *“Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve në moshë madhore), burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjektit”*. Por, Komisioni mban në konsideratë faktin se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën *Vetting*, duke sjellë si pasojë edhe rregullimin e kësaj pasaktësie.

**Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklaram që ka të bëjë me mosdeklarimin e kësaj pasurie të bashkëshortes në DIPP-të e viteve 2004 - 2016, por duke marrë në konsideratë faktin se kjo pasuri është deklaruar në deklaratën *Vetting*, e cila është deklarata bazë e pasurisë mbi të cilën bazohet thelbësisht procesi i rivlerësimit, e miratuar me ligjin nr. 84/2016, kjo pasaktësi nuk ndikon deri në atë masë sa të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.**

## **KONSTATIME TË TJERA**

---

<sup>53</sup>Shihni pyetësorin nr. 5

## **8. Automjet, tip “Mercedes-Benz 200 D”, vit prodhimi 1987, me targa \*\*\*, i shitur në datën 24.10.2007, në vlerën 450,000 lekë**

8.1 Në DIPP-në e vitit 2004, subjekti ka deklaruar blerjen e këtij automjeti në vlerën 800 euro + 160,000 lekë (në total rreth 250,000 lekë), pa përcaktuar burimin e krijimit, ndërsa në DIPP-në e vitit 2007, ka deklaruar shitjen e këtij automjeti në vlerën 450,000 lekë sipas kontratës së shitjes nr. \*\*\*, datë 24.10.2007.

8.2 DPSHTRr-ja<sup>54</sup> konfirmon automjetin tip “Mercedes-Benz” të blerë nga subjekti Gjon Kodra, në vlerën 800 euro, në Gjermani, por në kontratë nuk është përcaktuar data. Subjekti ka paguar taksën doganore në datën 16.5.2004, në shumën 155,512 lekë (kursi 127.54 lekë = 1 euro). Në total automjeti ka kushtuar  $155,512 + (800 \text{ euro} \times 127.54 \text{ lekë}) = 257,544$  lekë.

Me kontratën e datës 24.10.2007<sup>55</sup>, subjekti Gjon Kodra ia shet këtë automjet në shumën 450,000 lekë, blerësit A. B., likuiduar jashtë zyrës noteriale.

8.2.1 Konstatohet se subjekti i rivlerësimit e ka shitur automjetin tip “Mercedes-Benz”, pasi e ka përdorur për 3 vjet, me çmimin 450,000 lekë ose gati dy herë më shtrenjtë se çmimi i blerjes, çmim i cili nuk përkon me logjikën ekonomike të shitblerjes së makinave, duke pasur parasysh edhe normën e amortizimit për çdo vit përdorimi. Lidhur me çmimin e shitjes nga subjekti i rivlerësimit, nuk provohen me dokumentacion ligjor përmirësimet që i janë bërë këtij automjeti të cilat mund të kenë ndikuar në rritjen e vlerës së tij.

8.3 Në lidhje me pagesën e tatimit mbi të ardhurat për diferencën e çmimit të blerjes me atë të shitjes, subjekti në pyetësor<sup>56</sup> ka shpjeguar se ka paguar detyrimin për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e luajtshme (automjetet) dhe DPSHTRr-ja ngarkohet si agjent i mbledhjes së kësaj takse, e cila është mbajtur dhe derdhur në buxhetin e shtetit dhe është e bazuar në ligjin nr. 8977, datë 12.12.2002, “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Subjekti ka shpjeguar se nuk disponon pagesën dhe ka pretenduar se detyrimi për këtë taksë, sipas kërkesës ligjore, rezulton të jetë në shumën 9,000 lekë (vlera e shitjes x taksën prej 2%)<sup>57</sup>.

8.4 Komisioni ka hetuar për ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi të subjektit me shtetasin A. B. dhe nga hetimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë<sup>58</sup>.

### **8.5 Analizë burimit të krijimit të shumës 250,000 lekë me të cilën është blerë automjeti tip “Mercedes-Benz” i vitit 1987**

8.5.1 Në pyetësorin nr. 2, subjekti ka deklaruar: “*Burimi i krijimit të kësaj pasurie janë të ardhurat nga paga dhe nga shitja e automjetit tip ‘Ford’*”.

#### **a) Të ardhurat nga paga**

Komisioni ka administruar dokumentacionin për të ardhurat nga paga të përfituara nga subjekti i rivlerësimit dhe i ka marrë në konsideratë ato në analizën e kryer në momentin e krijimit të kësaj pasurie.

<sup>54</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.5.2021, e DPSHTRr-së.

<sup>55</sup>Kontratë shitblerje nr. \*\*\*, datë 24.10.2007.

<sup>56</sup>Shihni pyetësorin nr. 2.

<sup>57</sup>Referoju pyetësorit nr. 2, te pika 7, për shpjegimet e detajuara të subjektit.

<sup>58</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.6.2021, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## **b) Të ardhura nga shitja e automjetit tip “Ford Sierra”**

8.5.2 Në DIPP-në e vitit 2003, subjekti ka deklaruar këtë automjet të blerë në vlerën 200,000 lekë dhe burimin e krijimit “*të ardhurat personale*”, ndërsa në vitin 2004 ka deklaruar shitjen e tij.

8.5.3 DPSHTRr-ja<sup>59</sup> konfirmon se automjeti tip “Ford Sierra”, i vitit 1990, është blerë nga shtetasi L. K. në datën 10.2.2002, me çmimin 500 euro dhe më 17.3.2002 ka paguar taksën doganore në shumën 155,768 lekë (kursi 121.76). Në total automjeti ka kushtuar në vlerën 155,768 lekë + (500 euro x 121.76 lekë = 60,880 lekë) = 216,648 lekë.

Në datën 26.3.2002 (pas 9 ditësh nga pagesa e doganës) me kontratë dhurimi (me vërtetim nënshkrimi tek noteri) shtetasi L. K. i dhuron këtë automjet subjektit Gjon Kodra<sup>60</sup>.

Me kontratën e datës 7.7.2004<sup>61</sup>, subjekti Gjon Kodra ia shet këtë automjet shtetasit Sh. S. me çmimin 250,000 lekë i paguar para noterit.

8.5.4 Komisioni vëren se automjeti tip “Mercedes-Benz” (referuar datës së pagimit të taksës doganore) është blerë në datën 16.5.2004, ndërkohë që automjeti “Ford Sierra” është shitur më 7.7.2004. Pra, shuma e përfituar nga shitja e automjetit tip “Ford-Sierra”, në shumën 250,000 lekë, nuk mund të kenë shërbyer si burim për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, pasi kjo shumë është përfituar më vonë.

8.5.5 Me pyetësin nr. 2 i është kërkuar subjektit të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave për shumën 200,000 lekë, të depozitojë kontratën e blerjes së këtij automjeti, si dhe të provojë me dokument ligjor pagimin e tatimit për fitimin e realizuar nga shitja.

8.5.5.1 Subjekti ka shpjeguar, ndër të tjera, se në deklaratën e vitit 2003 ka deklaruar vlerën 200,000 lekë, pra, vlerën e tregut sa mund të vlerësohej automjet në vitin 2002. Plotësimi i deklaratës së vitit 2003 është bërë ashtu siç është kuptuar pa pasur ndonjë qëllim fshehje. Për sa i përket deklaratimit si dhuratë, subjekti deklaroi se nuk e ka deklaruar në deklaratën periodike të 2003, pasi kontrata është bërë në 2002 dhe në deklaratën e vitit 2003 kjo pasuri ka qenë e trashëguar nga para periudhës së detyrueshme për të deklaruar.

Për pagesën e tatimit për diferencën e çmimit të blerjes me atë të shitjes, subjekti ka dhënë të njëjtat shpjegime si edhe për automjetin tip “Mercedes-Benz”, në pikën 8. 3 të vendimit.

8.5.6 Subjektit<sup>62</sup> i është kërkuar të shpjegojë marrëdhënien e tij me shtetasin L. K., qëllimin e dhurimit, kur automjeti sapo ishte blerë prej shtetasit L. K., në vlerën 216,648 lekë (çmim blerje + doganë).

8.5.6.1 Subjekti ka shpjeguar se me shtetasin L. K. ka lidhje të ngushtë familjare kunati i tij H.L. dhe se e njeh nga kunati. Ky shtetas banon në Austri dhe në një bisedë të tij me kunatin, nga ky i fundit i është kërkuar nëse mund të sillte një automjet për kunatin e tij, Gjon Kodra. Ai ka pranuar të sjellë automjetin dhe më pas kanë shkruar tek noterja, ajo ka pranuar të bëjë kalimin e pronësisë së automjetit vetëm me kontratë dhurimi dhe jo shitjeje, pasi dokumentacioni shoqëruar i automjetit nuk ishte i plotë dhe për sigurimin e tij duhej një muaj i plotë për ta marrë. Meqë L. K. kishte sjellë mjetin dhe meqë mjeti i duhej subjektit, pranuan të bënin kontratën e dhurimit dhe jo

<sup>59</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.5.2021, e DPSHTRr-së.

<sup>60</sup>Në kontratën e dhurimit dhuruesi L. K. deklaroi se: “Automjetin tip ‘Ford Sierra’ ia dhuron z. Gjon Kodra, i cili deklaroi se është plotësisht dakord me dhurimin e bërë duke treguar respekt dhe mirënjohje me dhuruesin L. K.”.

<sup>61</sup> Kontratë nr. \*\*\*, datë 7.7.2004.

<sup>62</sup>Shihni pyetësin nr. 4.



të shitjes. Meqë kontrata e dhurimit nuk përmbante çmim, subjekti ka deklaruar çmimin e përafërt të tregut për atë tip automjeti dhe vit prodhimi. Pra, qëllimi i kontratës së dhurimit ka qenë vetëm pamundësia e përpilimit të kontratës së shitjes për një kohë të shkurtër.

8.5.7 Komisioni ka hetuar dhe për ndonjë situatë konflikti interesi të subjektit me shtetasit L. K. dhe Sh. S. dhe nga hetimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë<sup>63</sup>.

#### 8.5.8 Analiza financiare në momentin e krijimit të pasurisë datë 16.5.2004 (paguar përfundimisht vlera e plotë e mjetit = çmim blerje + shpenzime doganore)

Komisioni vlerësoi të kryejë analizën financiare, deri në datën e krijimi të kësaj pasurie, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit për blerjen e këtij automjeti, pasqyruar në tabelën vijuese.

**Tabela nr. 5**

<b>Përshkrimi</b>	<b>1.1.2004 - 16.5.2004</b>
<b><i>Të ardhurat</i></b>	<b><i>1,614,259</i></b>
Të ardhura nga paga e subjektit	297,368
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	1,231,770
Të ardhura nga pensioni i nënës	30,276
Të ardhura nga pensioni i babait	54,846
<b><i>Detyrime</i></b>	<b><i>0</i></b>
<b><i>Shpenzime</i></b>	<b><i>175,995</i></b>
Shpenzime jetike	175,995
Shpenzime udhëtimi	0
<b><i>Pasuri</i></b>	<b><i>1,147,713</i></b>
Kursime (shtesa/pakësime likuiditeti)	897,713
Automjet tip “Mercedes-Benz”, viti 1987	250,000
<b><i>Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri</i></b>	<b><i>290,551</i></b>

Sa më sipër, nga analiza financiare deri në datën 16.5.2004, duket se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur burime të mjaftueshme financiare për të përballuar jetesën dhe blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, vit prodhimi 1987.

8.6 Komisioni, gjatë hetimit administrativ për automjetin tip “Mercedes-Benz”, ka konstatuar se:

- subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të automjetit “Mercedes-Benz”, në DIPP-në e vitit 2004;
- subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar përmirësimet që i janë bërë automjetit tip “Mercedes – Benz”, të cilat mund të kenë ndikuar në rritjen e vlerës së shitjes nga subjekti me çmimin 450,000 lekë. Shitja e këtij automjeti me çmimi 2 herë më shtrenjtë se çmimi i blerjes ( 216,648

<sup>63</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.10.2021, e Prokurorisë së Rrethit Tiranë.

lekë) dhe pas 3 vjet përdorimi, nuk përkon me logjikën financiare të shitblerjes së automjeteve në tregun e lirë;

- automjeti tip “Mercedes-Benz” nuk është blerë (16.5.2004<sup>64</sup>) me të ardhura të ligjshme, pasi shuma 250,000 lekë e përfituar nga shitja e automjetit tip “Ford Sierra” (7.7.2004) që ka shërbyer si burim i tij është përfituar 2 muaj më pas.

Ndërsa për automjetin tip “Ford Sierra”, gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se:

- ka mospërputhje deklarimi në lidhje me burimin e krijimit të automjetit tip “Ford Sierra”, pasi në deklaratën e vitit 2003, subjekti ka deklaruar si burim krijimi “të ardhurat personale”, ndërsa nga dokumentacioni i DPSHTRr-së dhe deklarimi i subjektit në pyetësin nr. 1, rezulton që automjeti tip “Ford Sierra” është dhuruar nga shtetasi L. K.;
- ka mospërputhje deklarimi, në lidhje me çmimin e blerjes së automjetit tip “Ford Sierra”, pasi në deklaratën e pasurisë së 2003, subjekti deklaroi vlerën 200,000 lekë, ndërsa nga dokumenti i DPSHTRr-së rezulton se ky automjet i është dhuruar subjektit;
- subjekti i rivlerësimit nuk ka paguar tatimin mbi të ardhurat për çmimin e shitjes në vlerën 250,000 lekë të automjetit të përfituar me dhurim, për këtë arsye, në analizë financiare, Komisioni do të llogarisë vlerën (0) zero si e ardhur;
- ka deklarime kontradiktore të subjektit të rivlerësimit në lidhje me dhurimin, pasi subjekti e deklaroi si dhurim për shkak të mos bërjes së kontratës së shitjes, ndërkohë që nëse konsiderohet si kontratë shitje që nuk ka deklaruar çmimin e blerjes së këtij automjeti.

Për konstatimet e mësipërme, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Aneksit të Kushtetutës.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

8.7 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij për automjetin tip “Mercedes-Benz”, ka shpjeguar se për mosdeklarimin e burimit të tij në DIPP-në e vitit 2004 ka qenë pakujdesi duke u mjaftuar vetëm me deklarimin e tij si pasuri.

Për shitjen e këtij automjeti me vlerë më të madhe se blerja pas 3 vjetësh, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se arsyeja e vetme e kësaj shitje me vlerë më të madhe ka qenë se automjeti është blerë nga subjekti në Gjermani, ku dihet botërisht se çmimi është më i ulët se sa çmimi që ofron tregu vendas në Shqipëri. Po kështu, edhe amortizimi i automjetit nuk ka qenë i dukshëm pasi ky mjet është përdorur shumë pak nga subjekti.

Referuar logjikës financiare, në analizën e çmimit nga Komisioni, do ishte më korrekte nëse krahasimi i çmimit të shitjes në treg të bëhej për këto lloj mjetesh në atë vit dhe jo duke u bazuar në çmimin e pasqyruar në kontratë dhe të krahasuar vetëm me çmimin e blerjes.

Për pagesën e tatimit mbi të ardhurat për diferencën e çmimit të blerjes me atë të shitjes, subjekti ka dhënë të njëjtat shpjegime të dhëna dhe në pyetësin nr. 2, referuar pikës 8. 3 të vendimit.

Në lidhje me referencën e Komisionit, në praktikën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit me vendimin 11/2019, që ka konsoliduar praktikën se nëse nuk provohet pagimi i detyrimit tatimor për diferencën e vlerës së blerjes me shitjen, kjo e ardhur nuk do të konsiderohet e ligjshme, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Ky pretendim i Komisionit, duke iu referuar vetëm një praktike të mëparshme, nuk është korrekte, pasi kjo praktikë nuk është e ngjashme me atë të

---

<sup>64</sup>Marrë si datë blerje, data e pagimit të taksës doganore pasi kontrata e blerjes së mjetit në Gjermani nuk ka datë.

subjektit Gjon Kodra dhe në përputhje me kërkesat ligjore, sa kohë që subjekti disponon dokumente justifikuese ligjore që vërtetojnë kryerjen e transaksioneve të blerje/shitjes, sipas kërkesave ligjore në fuqi.

Për shumën 250,000 lekë përfituar nga shitja e automjetit tip “Ford Sierra”, datë 7.7.2004, të cilat nuk mund të përdoren si burim për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, datë 16.5.2004, pasi janë përfituar më vonë, ndër të tjera, subjekti shpjegon se nuk mund të merret si fakt mungesë të ardhurash për sa kohë që dhe nga analiza financiare e kryer nga Komisioni është konfirmuar se subjekti ka të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme për të përballuar blerjen e këtij automjeti. Komisioni edhe pse nuk ka përfshirë si burim të ardhurash tepicën pozitive të datës 31.12.2003, përsëri nga analiza financiare, për periudhën 1.1.2004 – 16.5.2004, ka bilanc pozitiv të ardhurash të ligjshme.

Mos përfshirja në të ardhura të ligjshme e vlerës të arkëtuar nga shitja e automjetit tip “Ford Sierra”, me argumentin që datat e kontratave kanë një diferencë kohore prej 2 muajsh, në një kohë që deklarimi në DIPP bëhet brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, ndërsa deklarimi për të ardhurat e ligjshme dhe për shpenzimet për krijimin e pasurive bëhet për ndryshimet që ka pasur subjekti i rivlerësimit gjithmonë sipas dokumenteve justifikuese të ligjshme për gjithë vitin dhe nuk ka asnjë kërkesë që deklarimet për një periudhë periodike/vit të bëhen për periudha të ndara brenda një viti. Në DIPP-në e vitit 2004 është shënuar si burim i krijimit të automjetit të ardhurat nga shitja e mjetit, ka qenë koncepti i totalit të ardhurave dhe jo përshtkrimi i transaksioneve *cash*.

Për automjetin tip “Ford Sierra”, në lidhje me mospërputhjen se në deklaratën e vitit 2003 është deklaruar vlera 200,000 lekë, ndërsa nga dokumentacioni i DPSHTRr-së rezulton se ky mjet është dhuruar, subjekti ka shpjeguar se vlera e shënuar në atë vit është vlera se sa mund të vlerësohej ky mjet në treg në vitin 2002 dhe meqenëse kjo pasuri ishte krijuar para një periudhe që nuk ishte objekt deklarimi, nuk janë shënuar as të dhënat e dokumentit.

Për pagimin e tatimit mbi të ardhurat si rezultat i shitjes me atë të blerjes subjekti deklaron se është bërë në bazë të ligjit nr. 8977, datë 12.12.2002, ”Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duke paguar taksën e kalimit të pronësisë në masën 2% të vlerës së shitjes.

Për deklarimet kontradiktore, në lidhje me mënyrën e përfitimit të automjetit “Ford Sierra”, ku deklaron dhurim dhe më pas deklaron kontratë shitje, subjekti ka shpjeguar dhe më parë në pyetësorë që kjo mospërputhje ka ardhur si pasojë e mungesës së dokumentacionit ligjor për të bërë kontratë shitje dhe u bë kontratë dhurimi, por që në të vërtetë mjeti është përfituar nga shitja.

I pyetur në seancë nga vëzhguesi ndërkombëtar se mungesa e dokumentacionit pretenduar prej tij do e bënte të pamundur përpilimin e kontratës si për dhurimin dhe të shitjes, subjekti ka shpjeguar se kjo ishte e vetmja zgjidhje e sugjeruar nga noteri.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

8.8 Komisioni vëren se mosdeklarimi i burimit të krijimit për automjetin tip “Mercedes-Benz”, në DIPP-në e vitit 2004 është pranuar nga subjekti si “harresë”, por Komisioni mban në konsideratë faktin se burimi është deklaruar në deklaratën *Vetting* duke qartësuar këtë pasaktësi.

Për shitjen e mjetit me vlerë 2 herë më shtrenjtë se çmimi i blerjes pas 3 vjet përdorimi, subjekti nuk ka dhënë shpjegime bindëse për të vërtetuar të kundërtën e barrës së provës, si dhe referuar faktit se për diferencën midis çmimit të blerjes me atë të shitjes nuk ka paguar tatimin mbi të

ardhurat<sup>65</sup>, Komisioni i ka përfshirë në analizë financiare vetëm të ardhurat në shumën 250,000 lekë.

Në lidhje me njërin nga burimet për blerjen e mjetit “Mercedes-Benz”, që janë të ardhurat nga shitja e mjetit “Ford Sierra”, subjekti nuk ka dhënë shpjegime për faktin se të ardhurat nga shitja e tij janë përfituar 2 muaj më pas se mjeti “Mercedes-Benz” ishte blerë dhe nuk mund të kenë shërbyer si burim i këtij të fundit. Pavarësisht mungesës së këtij burimi, Komisioni ashtu siç ka konkluduar dhe në rezultate hetimi, subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga pagat (burimi tjetër i deklaruar në deklaratën *Vetting*), për të blerë mjetin “Mercedes-Benz”, në shumën 250,000 lekë.

Për automjetin tip “Ford Sierra”, Komisioni vëren se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë të mënyrës së përfitimit të këtij mjeti, deklarim i cili nuk ka pasur në vetvete qëllim për fshehje pasurie, pasi vetë subjekti në deklaratën periodike ka deklaruar vlerën prej 200,000 lekësh të mjetit që është e përafërt me vlerën që korrespondon nëpër dokumentet ligjore (vlera + dogana = 216,648 lekë).

Subjekti nuk ka dhënë shpjegime bindëse për arsyen e mopërpilimit të kontratës së shitjes ashtu siç ka ndodhur në fakt, por që ka proceduar me kontratë dhurimi, kur për të dy veprimet juridike vlen i njëjti dokumentacion për përpilimin e tyre përpara noterit.

Gjithashtu, Komisioni në analizë financiare mori në konsideratë të ardhurat nga shitja në vlerën 216,000 lekë dhe jo 250,000 lekë, pasi nuk rezultoi që subjekti të ketë paguar tatimin mbi të ardhurat.

**Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pasaktë për të dy mjetet (“Ford Sirra” dhe “Mercedes-Benz”), në kundërshtim me nenin në kundërshtim me nenin 33, pika 5/a, e ligjit nr. 84/2016, por ka pasur burime të ligjshme dhe të mjaftueshme financiare për blerjen e tyre.**

## **9. Hua në shumën 10,000 euro marrë shtetasit Gj. R., në qershor të vitit 2009**

9.1 Në deklaramet periodike, subjekti ka deklaruar në lidhje me huan, si në tabelën vijuese:

**Tabela nr. 6**

<b>DPV</b>	<b>Deklarimi</b>	<b>Shuma e likuiduar</b>	<b>Detyrim i mbetur në euro</b>
2009	<i>Marrë hua pa afat shuma prej 10,000 euro nga shtetasi H. L., bashkëshorti i motrës M. L. Qëllimi i detyrimit është blerje pajisjesh të ndryshme për banesën e blerë, të cilat më</i>		

<sup>65</sup>Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, i ndryshuar në nenin 8 “e ardhura e tatueshme”, pika g, parashikon: “Të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë”.

Nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit me vendimin nr. 11/2019 (për subjekti E. I., pika 27.12.12) është konsoliduar praktika, që nëse nuk provohet pagimi i detyrimit tatimor për diferencën e vlerës së blerjes me shitjen, kjo e ardhur nuk do konsiderohet e ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3, e Aneksit të Kushtetutës, për vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e automjeteve (diferenca mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së automjetit), për sa kohë nuk u provua pagimi i detyrimit tatimor mbi këtë fitim. Për rrjedhojë, vlera e fitimit të realizuar vlerësohet si e ardhur e paligjshme në kuptim të nenit D, pika 3, e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe kjo vlerë iu zbrit të ardhurës të arkëtuar nga shitja e këtyre automjeteve, duke u pasqyruar në rezultatin financiar të vitit përkatës.

	<i>pas me marrjen e aktit të pronësisë do të skontohej nga llogaria e përgjithshme e paguar</i>		
2010	<i>Në vitin 2010 shlyer shumën 3,000 euro nga detyrimi i deklaruar në vitin 2009 prej 10,000 euro të afërmit tim. Shlyer shuma 3,000 euro. Gjendja e detyrimit të mbetur 7,000 euro</i>	3,000	7,000
2011	<i>Në vitin 2011 shlyer shumën 4,000 euro nga detyrimi i deklaruar në vitin 2010 prej 10,000 euro të afërmit tim. Shlyer shuma 4,000 euro. Gjendja e detyrimit të mbetur 3,000 euro</i>	4,000	3,000
2012	<i>Në vitin 2012 shlyer tërësisht detyrimi i mbetur ndaj të afërmit tim Gj. R. 3,000 euro. Shuma e shlyer 3,000 euro. Gjendja e detyrimit të mbetur 0 (zero) euro</i>	3,000	0

9.2 Subjekti bashkë me deklaratën *Vetting* ka depozituar deklaratën noteriale të datës 29.1.2010<sup>66</sup>, ku vetë subjekti ka deklaruar se: “Në muajin qershor 2009 i ka marrë hua z. Gj. R. vlerën 10,000 euro. Vlera 10,000 euro është pasqyruar me tërheqjen bankare që ka bërë z. Gj. R. në datën 27.1.2010, në ‘Credins Bank’, për një afat prej 5 vjetësh, deri në fund të vitit 2015, pa interes”.

9.3 Në pyetësin standard, subjekti ka deklaruar: “I kam marrë hua shtetasit Gj.R. (lidhje fisnore dhe shoqërore e imja që në fëmijëri) në vitin 2010 shumën prej 10,000 euro pa interes. Shlyerja është bërë pjesë deri në vitin 2012. Shtetasi i mësipërm ka kryer aktivitetin e sigurisë së objekteve. Shuma është tërhequr në ‘Credins Bank’, dega Tirana \*\*\*, datë 27.1.2010”.

9.3.1 Subjekti bashkë me deklaratën *Vetting* ka depozituar një mandat tërheqje të lëshuar nga “Credins Bank”, datë 27.1.2010, ku rezulton se nga shtetasi Gj. R. është tërhequr shuma 10,000 euro nga depozita pa afat.

9.3.2 Subjekti ka depozituar edhe deklaratën noteriale të datës 18.1.2020<sup>67</sup> me deklarues shtetasit Gjon Kodra dhe Gj. R., të cilët deklarojnë: “...kemi qenë në një marrëdhënie huamarrës/huadhënës. Gj. R. deklaroi se i ka dhënë në formë huaje z. Gjon Kodra shumën 10,000 euro hua pa interes me afat kthimi 5-vjeçar Palët deklaruese deklarojnë se kjo shumë nga ana e z. Gjon Kodra është likuiduar me këste deri në fund të vitit 2012”.

9.4 Subjekti ka depozituar dhe ekstraktin e QKB-së ku shtetasi Gj. R. rezulton ortak dhe administrator i shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. me aktivitet sigurimi i objekteve publike apo private etj. me status “i pezulluar”, në datën 29.7.2015.

9.5 Në procesverbalin e mbajtur në datën 22.2.2013, në ILDKPKI, subjekti është pyetur në lidhje me deklaratimet e tij për huat e marra. Subjekti ka shpjeguar se: “Sqaroh se deri në vitin 2011 unë kam dy hua. Huan e deklaruar në vitin 2009 e kam me deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 29.1.2010 dhe ia kam marrë shtetasit Gj.R. Gabimisht nga ana ime është shkruar si huamarrës shtetasi H. L. Ky gabim ka ardhur për arsye se kunatit H. L. i kam marrë hua 5,000 euro në mars të vitit 2010, kohë në të cilën është plotësuar deklarata për vitin 2009. Këtë huamarrje të dytë e kam deklaruar në vitin 2010, por nuk e kam me dokument. Në deklaratat vijuese kam deklaruar pjesën e shlyer dhe detyrimin e mbetur për të dyja huat”.

<sup>66</sup>Deklaratë noteriale, nr. \*\*\*, datë 29.1.2010, me deklarues Gjon Kodra.

<sup>67</sup>Deklaratë noteriale, nr. \*\*\*, datë 18.1.2020, me deklarues Gj. R.

9.6 Subjektit, me pyetësin nr. 2, i është kërkuar të shpjegojë mospërputhjen në deklaram në lidhje me huan, pasi në deklaratën noteriale të datës 29.1.2010, deklaroi marrë huan në qershor të vitit 2009, por, gjithashtu, deklaroi se huadhënësi ka tërhequr shumën e dhënë hua nga banka në datën 27.1.2010, në “Credins Bank”, në pyetësin standard deklaroi se ka marrë hua në vitin 2010, ndërsa në DIPP-në e vitit 2010 deklaroi shlyerjen pjesore të huas në shumën 10,000 euro të marrë në vitin 2009.

9.6.1 Subjekti ka shpjeguar se: “[...] sqaroi se është e vërtetë se ka mospërputhje por ju deklaroj me përgjegjësi se ngatërresat kanë ardhur nga pakujdesia dhe jo me qëllim për të fshehur, pasi për vitin 2009 e 2010 të ardhurat e ligjshme financiare mbulojnë shpenzimet e kryera si për pasuritë e krijuara e shpenzimet e kryera për llogari të subjektit të rivlerësimit. [...] me të ardhurat e ligjshme kam mbuluar të gjitha shpenzimet dhe në fund të çdo viti rezultojnë teprica të ardhurash dhe nuk kam patur asnjë arsye, qëllimin për të fshehur, ose bërë deklarime të pasakta. Ajo që ka ndodhur në dokumentacionin e cituar ka lapsuse, pasi shuma që është marrë hua nuk është në kohën e tërheqjes nga huadhënësi të vlerës në llogarinë ‘Credins Bank’, deklarimi i bërë në deklaratën 2009 është ngatërruar pasi kjo deklaratë është plotësuar në një datë të mëvonshme se ajo e marrjes së huas, pra, deklarata periodike e vitit 2009 është plotësuar më datën 30.3.2010...”.

9.7 Ndër të tjera, në shpjegimet e dhëna në pyetësin nr. 5, subjekti ka deklaruar se: “[...] ju sqaroi se në deklaratën periodike të vitit 2009 kam pasqyruar shumën prej 10,000 euro si hua marrë kumatit tim H. L., ndërsa në DIPP-në e vitit 2010 kam deklaruar vijon detyrimi i marrë kumatit prej 5,000 euro.[...] Në muajin janar 2010 siç kam deklaruar i kam marrë hua Gj. R. shumën prej 10,000 euro. Nga kjo shumë 5,000 euro i janë kthyer kumatit në muajin janar 2010, pra në total shuma e marrë si hua (cash) nga këta dy shtetas ka qenë 20,000 euro, por nga kjo shumë i është kthyer kumatit H. L., shuma 5,000 euro, duke e lënë vlerën totale të huas ndaj këtyre dy personave 15,000 euro.[...]”.

9.8 Komisioni ka hetuar dhe për ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi të subjektit me shtetasin Gj. R. dhe nga hetimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë<sup>68</sup>.

#### 9.9 Analizë burimit të krijimit të shumës 10,000 euro dhënë hua nga shtetasi Gj. R.

9.9.1 Subjekti ka depozituar në pyetësin standard si dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të shumës 10,000 euro ekstraktin e shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., në të cilin z. Gj. R. rezultoi të jetë administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë, e cila është regjistruar më 1.10.2003 dhe është pezulluar më 28.7.2015.

9.9.2 Nga verifikimi në faqen zyrtare të QKB-së, [www.qkb.gov.al](http://www.qkb.gov.al), rezultoi se kjo shoqëri nuk ka të depozituara pasqyra financiare për periudhën e ushtrimit të aktivitetit.

9.9.3 Në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të shumës 10,000 euro dhe dokumentacionin ligjor përkatës, subjekti ka shpjeguar, ndër të tjera, se: “...këtë shumë ai e ka tërhequr në “Credins Bank”, në Tiranë, në datën 27.1.2010 dhe së bashku me shumën e eurove më ka dhënë dhe mandatin e bankës të cilin e kam depozituar edhe pranë jush. Nisur nga fakti që ky shtetas ushtronte një aktivitet privat dhe sasia e eurove është tërhequr në bankë nuk kam pasur dhe as nuk kam asnjë lloj dyshimi për burimin e ligjshëm të tyre. Fakti i tërheqjes nga banka dhe marrja hua janë të provuara me dokumentet e dorëzuara. Ky shtetas është administrator i subjektit ‘\*\*\*’

<sup>68</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.6.2021, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

*sh.p.k., me qendër në Shkodër, me datë themelimi 27. 7.2003, me objekt veprimtarie sigurimin e objekteve publike apo private [...] Nuk disponoj dokumente të tjera [...]*”.

9.9.4 Subjekti ka depozituar nxjerrjen e llogarisë të “Credins Bank”, ku konfirmohet tërheqja e shumës 10,000 euro, në datën 27.1.2010, nga z. Gj. R. Nga veprimet bankare në këtë llogari rezulton se ky shtetas ka likuiditete të mjaftueshme për dhënien e huas, por nuk provohet burimi i ligjshëm i këtyre shumave dhe, për këtë arsye, ato nuk janë marrë në konsideratë në analizën financiare paraprahe të kryer nga Komisioni.

9.10 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se:

- ka deklarime kontradiktore të subjektit të rivlerësimit në lidhje huan në shumën 10,000 euro marrë shtetasit Gj.R. (subjekti në ILDKPKI-në e vitit 2013 deklaroi se gabimisht në DIPP-në e vitit 2009 është shkruar H. L., por huaja i është marrë nga Gj.R., në deklaratën noteriale të datës 29.1.2010 deklarohet se huaja është marrë në qershor të vitit 2009 dhe në pyetësin standard dhe nr. 5, subjekti e deklaroi huan e marrë në vitin 2010);
- subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokument burimin e ligjshëm të të ardhurave të krijuara nga shtetasi Gj. R. për dhënien e huas në shumën 10,000 euro, në vitin 2010.

Për konstatimet e mësipërme, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Aneksit të Kushtetutës.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

9.11 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij ka shpjeguar se në DIPP-në e viti 2009 ka pasqyruar shumën 10,000 euro, si hua marrë kumatit H. L., ndërsa në DIPP-në e vitit 2010 është deklaruar, vijon detyrimi i marrë kumatit prej 5,000 euro. Gjysmën e kësaj shume prej 5,000 euro duhet t’ia kthente kumatit brenda një kohe të shkurtër. Në janar të vitit 2010 subjekti i ka marrë hua z. Gj. R. shumën 10,000 euro, nga të cilat shuma 5,000 euro i është kthyer kumatit po në janar të vitit 2010, pra, në total shuma e marrë hua këtyre dy shtetasve ka qenë 20,000 euro, por nga kjo shumë ishte kthyer 5,000 euro H. L., duke e lënë vlerën e borxhit për të dy personat në shumën 15,000 euro. Deklarimet e kumatit H. L. përkojnë me deklaratimet në DIPP-të për vitet 2009 dhe 2010. Për shumën e mësipërme subjekti është paraqitur para noterit M. Ll., e cila ka hartuar një draft-deklaratë noteriale të datës 27.1.2010, ku është përshkruar gjithë mënyra e krijimit të detyrimeve për huat për secilin huadhënës. Shuma e huas marrë kumatit H. L. në këtë draft-deklaratë është përshkruar në shumën 10,000 euro marrë në qershor të vitit 2009, si dhe shuma e huas 10,000 euro marrë Gj. R., nga e cila është shlyer 5,000 euro për H.L. Huadhënësi Gj. R. kërkoi që në deklaratë të mos përfshihej marrëdhënia e subjektit me kumatit H.L. dhe nga ana e noterit duke hedhur ndryshimet mbi të njëjtin draft janë mbartur lapsuse që nuk kanë një rrjedhë logjike. Subjekti sqaron se është treguar i pakujdesshëm duke nënshkruar deklaratën pa e lexuar.

Dy ditë pasi është marrë huaja në shumën 10,000 euro nga z. Gj. R., që korrespondon dhe me tërheqjen bankare prej tij, po në datën 27.1.2021, në “Credins Bank”, është firmosur dhe deklarata noteriale, datë 29.1.2021.

Subjekti shpjegon se pavarësisht lapsuseve apo pakujdesisë së tij, ajo që është thelbësore është se këto lapsuse që mbart deklarata noteriale, nuk krijojnë premisa/elemente për ngritjen e pretendimeve për ligjshmërinë e burimeve të krijimit të pasurive që subjekti ka në pronësi ose në përdorim.

9.11.1 Në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave, që kanë shërbyer për krijimin e shumë 10,000 euro të shtetasit Gj.R., subjekti ka depozituar dokumentacionin; (i) ekstrakt historik i QKB për shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.<sup>69</sup>; (ii) ekstrakt historik QKB-së i personit fizik<sup>70</sup>; (iii) vërtetim shlyerje taksash dhe tarifa vendore nga Bashkia Shkodër për shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.<sup>71</sup>; (iv) nxjerrje llogarie “Banka Popullore”, në emër G. R.<sup>72</sup>; (v) nxjerrje llogarie “Credins Bank”, në emër Gj. R.<sup>73</sup>; (vi) 14 kontrata shërbimi të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., të lidhura me subjekte të ndryshëm për periudhën 2004 – 2013<sup>74</sup>; (vii) deklaratë parashikuese e qarkullimit vjetor për vitin 2010 tatimpaguesi “\*\*\*\*” sh.p.k.<sup>75</sup>; (viii) njoftim vlerësimi tatimor nga Bashkia Shkodër<sup>76</sup>; si dhe (ix) kontratë qiraje e datës 2.3.2013<sup>77</sup>.

9.11.2 Mbështetur në dokumentet e sipërlistuar rezultojnë:

- a) Nga ekstrakti i QKB-se Ekstrakt historik i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit”, i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., datë 10.12.2021, rezultojnë se z. Gj. R. është ortak i vetëm në shoqërinë që nga krijimi i saj, me vendimin nr. \*\*\*, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të dhënat e regjistrimit fillestar: emri i subjektit “\*\*\*\*”; forma juridike sh.p.k.; data e regjistrimit më 5.9.2003; data e themelimit më 27.3.2003; kapitali në shumën 10,120,000 lekë; ortakët: Gj. R.; selia me adresë: lagjja “\*\*\*\*”, Shkodër; kohëzgjatja: pa afat; administratori: Gj. R.; objekti: sigurimi e objekteve publike e private në pronësi ose në përdorim të personave fizik apo juridik që ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sigurimin e mbrojtjen e jetës e të shëndetit të personave fizik shtetas shqiptar e të huaj, me NIPT \*\*\*; kapitali i shoqërisë është në shumën 10,200,000 lekë, i pa ndryshuar (pronari i shoqërisë që në datën e krijimit të saj ka pasur një kapital në vlerë të konsiderueshme prej 10,200,000 lekësh).

<sup>69</sup>Ekstrakti i QKB-së, Ekstrakt Historik i Regjistrimit Tregtar për të Dhënat e Subjektit, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.

<sup>70</sup>Ekstrakti i QKB-së, Ekstrakt Historik i Regjistrimit Tregtar për të dhënat e Subjektit, Person Fizik.

<sup>71</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., numri i praktikës: \*\*\*, datë 9.12.2021, lënda: vërtetim shlyerje taksa dhe tarifa vendore, drejtuar; shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., nga Bashkia Shkodër, Drejtoria e të Ardhurave.

<sup>72</sup>Nxjerrje llogari bankare në Banka Popullore: Nr.: \*\*\*, klienti Gj.R., për periudhën 9.1.2009 –18.12.2009.

<sup>73</sup>Nxjerrje llogari bankare në “Credins Bank”, IBAN \*\*\*.

<sup>74</sup>Kontratë shërbimi, datë 4.11.2004, ndërmjet KESH, Distriktit Burrel dhe Sh.r.s.f R. me fond prej 1.913.725 lekë; kontratë shërbimi, datë 1.5.2007, ndërmjet tregut të fruta-perimeve Shkodër me fond 664.600 lekë; kontratë shërbimi, datë 28.1.2008, ndërmjet tregut të fruta-perimeve Shkodër me fond 1.329.000 lekë; kontratë shërbimi, datë 1.1.2009, ndërmjet tregut të fruta-perimeve Shkodër me fond; kontratë shërbimi, datë 15.3.2009, ndërmjet tregut të fruta-perimeve Shkodër me fond 1.328.640 lekë; kontratë shërbimi, “Për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objektit”, datë 25.5.2009, ndërmjet shoqërisë private “\*\*\*\*”, me fond 55.000 lekë/muaj; kontratë shërbimi, datë 4.1.2010, ndërmjet tregut të fruta-perimeve Shkodër me fond 110.767 lekë/muaj; kontratë shërbimi, datë 3.2.2010, ndërmjet tregut të fruta-perimeve Shkodër, me fond 767.700 lekë; kontratë shërbimi, datë 31.1.2011, ndërmjet tregut të fruta-perimeve Shkodër; kontratë shërbimi, datë 3.4.2011, ndërmjet tregut të fruta-perimeve Shkodër, me fond 181.000 lekë; kontratë shërbimi, datë 2.8.2011, ndërmjet tregut të fruta-perimeve Shkodër, me fond 226.000 lekë; kontratë shërbimi, datë 3.1.2012, ndërmjet tregut të fruta-perimeve Shkodër, me fond 226.000 lekë; kontratë shërbimi, datë 1.7.2013, ndërmjet tregut të fruta-perimeve Shkodër, me fond 289.998 lekë; kontratë shërbimi “Për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objektit”, datë 6.11.2012, ndërmjet shoqërisë SHRSF “\*\*\*\*” sh.p.k., me “\*\*\*\*” sh.p.k., me kod fiskal \*\*\* dhe “\*\*\*\*” sh.p.k., me kod fiskal \*\*\*.

<sup>75</sup>Deklaratë parashikuese e qarkullimit vjetor për vitin fiskal 2010.

<sup>76</sup>Njoftim vlerësimi tatimor (për vitin fiskal 2010), me nr. serie: \*\*\*, datë 25.0=3.2010, nga Bashkia Shkodër.

<sup>77</sup>Kontratë qiraje, e nënshkruar, datë 2.3.2013, ndërmjet palëve: Ndërmarrja ujësjellës Fshat Shkodër sh.a dhe Personi Fizik “Gj. R.”.



- b) Pas vitit 2015, shtetasi Gj. R. është regjistruar në QKB, në datën 4.9.2015, me status juridik "Person fizik", me NIPT \*\*\*, me adresë: lagjja "\*\*\*\*", rruga "\*\*\*\*", nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, Shkodër, me objekt "bar kafe", punime PVC, duralumini, druri, furnizim dhe vendosje dyer, dritare, mobilje etj. Statusi i tatimpaguesit është aktiv.
- c) Shoqëria "\*\*\*\*" sh.p.k., me NIPT \*\*\* dhe Personi Fizik me NIPT \*\*\*, rezulton që nuk kanë depozituar pasqyra financiare (bilance) në QKB, pasi kanë qenë tatimpagues të biznesit të vogël dhe duke qenë me këtë përgjegjësi tatimore nuk kanë pasur detyrimin ligjor për të depozituar pasqyra financiare në QKB (baza ligjore për mos detyrimin për depozitim të pasqyrave financiare jepet në vazhdim të shpjegimeve për pikën 9.10.2).
- d) Në ligjin nr. 9632/2006, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 10 "Subjektet e tatimit mbi biznesin e vogël", pika 3 përcakton: *"Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet, gjatë vitit fiskal, një e ardhur bruto vjetore (qarkullim) më e vogël ose e barabartë me 8.000.000 lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së taksës vendore mbi biznesin e vogël"*.
- e) Me shkresën nr. \*\*\* prot., numri i praktikës: \*\*\*, datë 9.12.2021, lënda: vërtetim shlyerje taksa dhe tarifa vendore, drejtuar: shoqërisë "\*\*\*\*" sh.p.k., nga Bashkia Shkodër, Drejtoria e të Ardhurave, vërtetohet se ka qenë subjekt i biznesit të vogël "\*\*\*\*" sh.p.k., me NIPT \*\*\*, ku është shprehur: *"Bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, 'Për sistemin e taksave vendore', i ndryshuar dhe në VKB-në nr. 1, datë 22.1.2016, i ndryshuar në përgjigje të kërkesës me numër praktike \*\*\*, datë 9.12.2021, vërtetojmë se subjekti '\*\*\*\*' sh.p.k., 'Person fizik', me NIPT \*\*\*, me adresë në Shkodër dhe administrator z. Gj. R. ka shlyer taksat dhe tarifat vendore kundrejt Bashkisë Shkodër për vitin deri në vitin 2015, ku në datën 29.7.2015 ka pezulluar biznesin"*.
- f) Subjekti shoqëria "\*\*\*\*" sh.p.k., nuk ka pasur detyrim për pagesë dividendi, pasi ka qenë subjekt i tatimit mbi biznesin e vogël, sipas përcaktimit të nenit 3/10, të ligjit nr. 9632/2006. Ky përcaktim ligjorë është në udhëzim nr. 5, datë 30.1.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, pjesa 2, "Tatimi mbi të ardhurat personale", pika 2.3, "Të ardhurat e tatueshme", nënpika 2.3.3, ku thuhet: *"Në zbatim të nenit 8, të ardhura të tatueshme për qëllim të tatimit mbi të ardhurat personale, janë kategoritë e të ardhurave të mëposhtme:*
- 2.3.3 Të ardhurat që rrjedhin nga fitimi i ortakut apo i aksionerit në shoqërinë tregtare (pika b) e paragrafit 1. Në kuptim të kësaj pike, bëhet fjalë për të ardhurat që përfitojnë individët, në formën e ndarjes së fitimit nga ortakëritë, apo të dividendit nga shoqëritë tregtare. Në të ardhurat e tatueshme sipas kësaj pike nuk përfshihet fitimi neto (pas pagimit të tatimit mbi fitimin apo tatimit të thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël) i personave fizikë tregtarë, pavarësisht nëse këta të fundit janë subjekt i tatimit mbi fitimin apo tatimit të thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël"*.
- g) Z. Gj. R., meqenëse vazhdon të jetë i regjistruar, tregon se ushtron aktivitet privat, paguan detyrimet ndaj shtetit sipas kërkesave ligjore fiskale në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe nëse nuk do të paguante detyrimet tatimore atëherë do të kishte bllokime të aktivitetit po sipas kërkesave të ligjit nr. 9920/2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Të dhënat e të dy ekstrakteve të QKB-së, për NIPT \*\*\* dhe NIPT \*\*\*, tregojnë qartë se nuk ka asnjë urdhër bllokimi, urdhër sekuestro parashikime të ligjit nr. 9920/2008, që aplikohen kur tatimpaguesit ushtrojnë aktivitet dhe nuk paguajnë në mënyrë korrekte detyrimet.

- h) Nga përmbajtja e njoftim vlerësimit tatimor (për vitin fiskal 2010), me numër serie: \*\*\*, datë 25.3.2010, nga Bashkia Shkodër, Departamenti i të Ardhurave, ku janë përcaktuar këstet e detyrimit, duke shprehur se: *“Të mbështetura në të dhënat tuaja të deklaratës parashikuese të qarkullimit vjetor për vitin 2009, si dhe në bazë të vlerësimit të bërë nga ky departament në lidhje me këto të dhëna, detyrimi juaj tatimor për vitin 2010 do të jetë në shumën 47,300 lekë”*, argumentohet se subjekti ka qenë tatimpagues i regjistruar pranë Bashkisë Shkodër, si biznes i vogël edhe gjatë vitit 2009.
- i) Të dhënat e dokumenteve të mësipërme, vetëm për shërbimin e ruajtjes së sigurimit fizik të objekteve për periudhën 2004 – 31.12.2009, justifikojnë bindshëm që z. Gj. R. ka pasur burime të mjaftueshme për të mbuluar shumën e dhënë hua z. Gjon Kodra, në vitin 2010 në shumën prej 10,000 euro, nëpërmjet shumës që përmbajnë kontratat të lidhura e të vëna në dispozicion sipas kërkesës sime.
- j) Z. Gj. R., përveç të ardhurave që ka realizuar nga ushtrimi i aktivitetit, ka siguruar të ardhura edhe nëpërmjet dhënieve me qira të ambienteve sipas kontratave të qirasë.

Duke iu referuar të dhënave që përmbajnë kontratat e shërbimit të cituara më sipër, për periudhën 2007 – 31.12.2009, rezultojnë të dhënat të pasqyruara në tabelën vijuese:

**Tabela nr. 7**

Viti	Klienti KESH Distrikti Burrel	Klienti tregu fruta- perime, Shkodër	Shoqëria “****”, Shkodër	Totali i kontratave
2004-2005	1,913,725	-	-	1,913,725
2007	-	664,600	-	664,600
2008	-	1,329,000	-	1,329,000
2009	-	1,439,407	385,000	1,824,407
<b>Totali</b>	<b>1,913,275</b>	<b>3,433,007</b>	<b>385,000</b>	<b>5,731,732</b>

Siç shihet nga të dhënat e tabelës së mësipërme, vetëm për shërbimin e ruajtjes së sigurimit fizik të objekteve, për periudhën 2004 – 31.12.2009, sipas dokumenteve të vëna në dispozicion, z. Gj. R. ka pasur mundësi për të siguruar të ardhura në shumën 5,731,732 lekë. Sigurimi i të ardhurave sipas të dhënave të pasqyruara në tabelën e mësipërme argumentohet dhe me arsyetimin se për të dy klientët e mësipërm z. Gj. R., pronar i vetëm i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., kanë vazhduar marrëdhëniet e biznesit në vazhdimësi duke lidhur kontrata shërbimi deri në vitin 2015. Pas vitit 2015, z. Gj. R., e ka ushtruar aktivitetin privat duke u regjistruar në QKB, më 4.9.2015 dhe deri më sot rezulton me status “aktiv”.

Nga veprimet që përmbajnë nxjerrjet e llogarive bankare rezulton se shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., ka qenë tatimpagues pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër (referohu pagesave të kryera në vitin 2009 për detyrimin e TAP, si dhe për detyrimin për sigurimet shoqërore). Gjithashtu, për vitin 2010, ka vënë në dispozicion dhe një dokument që e dispononte vetë tatimpaguesi për parashikimin të qarkullimit vjetor për vitin fiskal 2010, deklarata parashikuese e qarkullimit vjetor për vitin fiskal 2010.

Subjekti i rivlerësimit, pas zhvillimit të seancës dëgjimore në datën 17.12.2021, ka sjellë disa shpjegime shtesë me anë të postës elektronike në datën 18.12.2021, lidhur me të ardhurat e ligjshme të shtetasit Gj. R. për dhënien e huas në shumën 10,000 euro subjektit të rivlerësimit.

Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar marrjen në konsideratë edhe të të dhënave për pagën si i punësuar në pozicionin e administratorit, për periudhën 2004 – 2009, pranë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

9.12 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë të deklarimit të huas së marrë shtetasit Gj.R., por subjekti ka shpjeguar se këto ngatërresa kanë ardhur pa pasur qëllim fshehje të ndonjë pasurie apo burimi të saj.

9.13 Marrë për bazë deklaratat e pasurisë, deklaramet e subjektit përgjatë hetimit, si dhe dokumente të tjera mbështetëse të vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, pavarësisht deklarimeve kontradiktore, del më se e qartë se fillimisht në vitin 2009 subjekti i ka marrë hua kunatit të tij H.L. shumën 10,000 euro dhe në dhjetor të vitit 2010 i ka marrë hua shumën 10,000 euro shtetasit Gj. R., nga të cilat 5,000 euro ia ka kthyer kunatit H. L.

9.13.1 Për burimin e ligjshëm të të ardhurave të z. Gj. R., për dhënien hua të shumës 10,000 euro, Komisioni vëren se nga verifikimi në QKB i ekstraktit të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. nuk rezulton të jetë depozituar vendim i asamblesë së ortakut të shoqërisë për të shpërndarë dividend.

9.13.2 Nga verifikimi i dokumentacionit ekonomiko-ligjor për shtetasin huadhënës Gj. R., është më se e qartë se kemi të bëjmë me një subjekt me një situatë të shëndoshë ekonomike, ku vetëm për të garantuar veprimtarinë tij ekonomike, në datën e krijimit të shoqërisë ka pasur një kapital në vlerë të konsiderueshme prej 10,200,000 lekësh. Veç kësaj, burimi i krijimit të të ardhurave të kësaj shoqërie, përveçse në vlera të konsiderueshme, ato kanë qenë edhe të ligjshme për arsye se burojnë nga përmbushja e marrëdhënieve kontraktuale të ligjshme me palë kontraktore ente shtetërore publike, si dhe ente private.

Gjithashtu, rezulton se bazuar në disa nga kontratat e depozituara në cilësinë e dokumentit provues referuar kontratave për periudhën 2004 – 2010, të cilat kanë gjeneruar një vlerë totale prej 5,731,732 lekësh (pasi kontratat e pas 2010 janë jashtë periudhës, kur është dhënë huaja), rezulton se në llogarinë personale të z. Gj. R. ka kreditim të shumave të ndryshme në monedhën lekë prej subjekteve që shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., ka lidhur kontratat e sipërcituara. Këto shuma janë derdhur në llogarinë personale të z. Gj.R.

Shuma 10,000 euro e tërhequr në datën 27.1.2010 është tërhequr nga z. Gj. R. nga llogaria personale e tij, por që ka si burim veprimtari të ligjshme ekonomiko-financiare të këtij huadhënësi. Është konstatuar që në këto llogari ka debitime, por dhe kreditime në vlera të konsiderueshme që e kalojnë ndjeshëm vlerën prej 10,000 euro dhënë hua subjektit të rivlerësimit<sup>78</sup>. Nga verifikimi i llogarive bankare të shtetasit Gj. R., pas dhënies së huas, konstatohen se ky shtetas ka kreditime në shuma të konsiderueshme, mbi 10,000 euro, në vazhdimësi çka tregon se kemi të bëjmë me një person me një situatë të konsoliduar dhe të shëndoshë financiare.

9.13.3 Komisioni bëri një vlerësim të pagave të shtetasit Gj. R. si administrator i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., për periudhën 2004 – 2009, referuar legjislacionit tatimor, nga ku rezultoi se për periudhën

---

<sup>78</sup>Depozitime në shumat: 21,800 euro, 4,500 euro dhe 8,800 euro, si dhe tërheqje në shumat: 14,000 euro, 7,000 euro dhe 10,000 euro.

2004 – qeshur 2007 është trajtuar me pagën minimale, sipas VKM-së në fuqi<sup>79</sup> në shumën *neto* të përlogaritur nga Komisioni në vlerën 450,515 lekë dhe nga periudha korrik 2007– dhjetor 2009, në shumën 1,221,400 lekë, me një total të ardhurash deri në momentin e dhënies së huas në vlerën 1,671,915 lekë. Vlen të theksojmë se trajtimi me pagë i administratorit të një shoqërie sipas niveleve në varësi të llojit të aktivitetit që ushtron shoqëria, ka qenë dhe është zbatim i një detyrimi ligjor dhe, si i tillë, në këto kushte është kërkuar që të merret në konsideratë nga subjekti në lidhje me aftësinë paguese të huas nga huadhënësi.

9.13.4 Komisioni, duke iu referuar veprimtarisë së ligjshme ekonomiko-financiare të huadhënësit Gj. R., situatës së shëndoshë financiare të pasqyruara në llogaritë e tij bankare me burime nga ekzekutimi i kontratave të ligjshme të shërbimit, nivelit të pagës, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi, datës 27.1.2010, të tërheqjes së shumës 10,000 euro nga llogaria e tij bankare, datës 29.1.2010, e hartimit të deklaratës noteriale që konfirmon dhënien e huas, pavarësisht faktit nëse është shpërndarë ose jo dividend, vëren se ky huadhënës ka pasur të ardhura të konsiderueshme financiare të ligjshme për përballimin e shpenzimeve jetike, minimalisht vetëm nga pagat, për të përballuar dhënien e huas në shumën 10,000 euro subjektit të rivlerësimit.

**Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka provuar me dokumentacion ligjor, si dhe ka dhënë shpjegime bindëse se personi tjetër i lidhur/Gj. R. ka pasur burime të ligjshme financiare të mjaftueshme për dhënien hua të shumës 10,000 euro. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratime të pasakta për kohën e dhënies së huas 10,000 euro marrë z. Gj.R., por këto pasaktësi janë të karakterit minimal, për të cilat nuk mund të aplikohet masa disiplinore për shkarkimin nga detyra.**

**10. Hua pa afat në shumën 5,000 euro marrë nga shtetasi H. L., me qëllim blerjen e pajisjeve për apartamentin e ri ndodhur në “\*\*\*”**

10.1 Në deklaratimet periodike, në lidhje me huan, subjekti ka deklaruar si në tabelën vijuese:

**Tabela nr. 8**

DIPP	Deklarimi	Hua e marrë në euro	Shuma e likuiduar në euro	Detyrim i mbetur në euro
2010	<i>Vijon detyrimi i marrë kumatit (H. L.), prej 5,000 euro, i pashlyer</i>			
2011	<i>Vijon detyrimi i marrë kumatit (H. L.), prej 5,000 Euro, i pashlyer</i>			
2012	<i>Gjatë vitit 2012 shlyer detyrimi ndaj kumatit H.L. në shumën 2,000 euro. Mbetur për t`u shlyer shuma 3,000 euro</i>		2,000	3,000
2013	<i>Në vitin 2013 shlyer tërësisht detyrimi ndaj kumatit H. L., në shumën 3,000 euro. Shuma e shlyer 3,000 euro. Gjendja e detyrimit të mbetur 0 (zero) euro</i>		3,000	0

<sup>79</sup>VKM-ja nr. 405, datë 25.6.2004; VKM-ja nr. 460, datë 13.6.2005; VKM-ja nr. 245, datë 27.4.2006; VKM-ja nr. 285, datë 4.5.2007.

10.2 Në pyetësoin standard, subjekti ka deklaruar, ndër të tjera, se i ka marrë kunatit H. L. shumën 5,000 euro, i cili ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar këtë shumë, të cilën e ka shlyer pjesë-pjesë, ndër vite.

10.3 Subjekti, gjithashtu, ka depozituar edhe një deklaratë noteriale të datës 15.1.2020<sup>80</sup> me deklarues Gjon Kodra dhe I.L.(e mbesa), e cila deklaroi se prindërit e saj H. dhe M. L., në vitin 2009 i kanë dhënë hua dajës Gjon Kodra shumën 5,000 euro pa interes, për ta përdorur për nevojat e tij për apartamentin e blerë në “\*\*\*”. Kjo shumë i është kthyer familjes L. plotësisht në vitin 2013. Të njëjtin deklaram ka bërë edhe subjekti Gjon Kodra lidhur me shumën 5,000 euro.

10.4 Subjekti i rivlerësimit, në ILDKPKI në vitin 2013, ka deklaruar se: “[...] Huan e deklaruar në vitin 2009 e kam me deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 29.1.2010 dhe ia kam marrë shtetasit Gj. R. Gabimisht nga ana ime është shkruar si huamarrës shtetasi H. L. Ky gabim ka ardhur për arsye se kunatit H.L. i kam marrë hua 5,000 euro, në mars 2010, kohë në të cilën është plotësuar deklarata për vitin 2009. Këtë huamarrje të dytë e kam deklaruar në vitin 2010, por nuk e kam me dokument”.

Ndërsa në procesverbalin e datës 9.3.2016, subjekti ka shpjeguar se: “Sqaroj se në deklaramet e 2009 dhe 2010 kam bërë disa lapsuse. Siç sqarova më sipër huan prej 5,000 euro ia kam marrë kunatit H. L., ndërsa 10,000 euro i kam marrë hua nga i afërmi im Gj. R...”

10.5 Ndër të tjera, në shpjegimet e dhëna në pyetësoin nr. 5, subjekti ka deklaruar se: “[...] ju sqaroj se në deklaratën periodike të vitit 2009 kam pasqyruar shumën prej 10,000 euro si hua marrë kunatit tim H. L., ndërsa në DIPP 2010 kam deklaruar vijon detyrimi i marrë kunatit prej 5,000 euro.[...] Në muajin janar 2010 si kam deklaruar i kam marrë hua Gj. R. shumën prej 10,000 euro. Nga kjo shumë 5,000 euro i janë kthyer kunatit në muajin janar 2010, pra, në total shuma e marrë si hua (cash) nga këta dy shtetas ka qenë 20,000 euro, por nga kjo shumë i është kthyer kunatit H. L. shuma 5,000 euro, duke e lënë vlerën totale të borxhit ndaj këtyre dy personave 15,000 euro. Deklaramet e kunatit H. L. përkojnë edhe me deklaramet e pasqyruara në DIPP-të për vitet 2009 dhe 2010, prandaj dhe në deklaratën e vitit 2010 është shënuar përshkrimi vijon hua marrë H. L. Nga ky deklaram del qartë se gjysma tjetër prej 5,000 euro i është kthyer z. H. L. dhe unë kam vazhduar me bindje që huaja e marrë prej kunatit tim është 5,000 euro”.

Lidhur me deklaratën noteriale të datës 29.1.2010, ku subjekti ka deklaruar se në qershor të vitit 2009 i ka marrë hua z. Gj. R. vlerën 10,000 euro dhe kjo vlerë është pasqyruar me tërheqjen bankare të datës 27.1.2010 në “Credins Bank”, nga ky i fundit, subjekti ka shpjeguar se: “[...]Kjo deklaratë është alogjike dhe tregohet qartë lapsusi i noteres dhe pakujdesi e imja që nuk e kam verifikuar në momentin e ndryshimeve të bëra prej saj”.<sup>81</sup>

10.6 Komisioni ka kërkuar nga subjekti të provojë me dokument ligjor burimin e ligjshëm të shumës 5,000 euro që ka shërbyer për dhënien e huas.

Subjekti i rivlerësimit ka depozituar si dokumentacion provues, në lidhje me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për dhënien e huas: (i) formularin e deklaramit dhe pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për vitet 2005-2006, për subjektin tregtar person fizik “\*\*\*”; (ii) formularët e deklaramit dhe pagesës së tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, për periudhën prill 2007- dhjetor

<sup>80</sup>Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 15.1.2020, me deklarues shtetasit I. L. dhe Gjon Kodra.

<sup>81</sup>Shihni pyetësoin nr. 5.

2007; (iii) ekstrakt historik<sup>82</sup> të punonjësit H. L.; (iv) kontrata qiraje<sup>83</sup>; (v) vërtetim për shtetasit H., M. dhe I. L.<sup>84</sup>; si dhe (iv) vërtetim i datës 26.10.2021 i Federatës Shqiptare të Futbollit<sup>85</sup>

10.7 Komisioni analizoi dokumentacionin e depozituar dhe konstatoi se për periudhën shtator 2003-gusht 2005, z. H. L. ka përfituar të ardhura *bruto* nga paga në shumën 2,386,650 lekë. Komisioni, sipas legjislacionit të kohës në fuqi<sup>86</sup>, përlllogaritit pagën *neto* nga ku rezultoi se të ardhurat *neto* nga paga janë në shumën 2,041,682 lekë.

Gjithashtu, Komisioni mori në konsideratë edhe të ardhurat e krijuara nga fitimi i personit fizik “\*\*\*”, në vitet 2005-2006, në shumën 1,900,000 lekë, sipas dokumentacionit provues depozituar nga subjekti i rivlerësimit.

Për efekt të vlerësimit të mundësisë së personit tjetër të lidhur/H. L. për të dhënë hua në vitin 2009, Komisioni llogaritit shpenzimet jetike për 4 persona, për periudhën shtator 2003– maj 2009. Nga analiza financiare rezultoi se personi tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit ka pasur të ardhura të ligjshme për dhënien e huas, të detajuar sipas tabelës vijuese:

**Tabela nr. 9**

Nr.	Përshkrimi	Vlera
	Të ardhura nga paga H. L., shtator 2003 – gusht 2005	2,041,682
	Të ardhura nga personi fizik “***”, 2005 – 2006	1,900,000
<b>A</b>	<b>Totali i të ardhurave</b>	3,941,682
<b>B</b>	<b>Shpenzime jetike, shtator 2003 – maj 2009</b>	2,697,724
<b>C</b>	<b>Hua e dhënë në qershor të vitit 2009, në shumën 10,000 euro</b>	1,231,825
	<b>Mundësia financiare (A-B-C)</b>	12,133

10.8 Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime kontradiktore, lidhur me deklarin e huas së marrë kumatit H. L., si vijon:

- në pyetësorin standard, subjekti deklaron hua në shumën 5,000 euro marrë kumatit H. L., pa specifikuar vitin;

<sup>82</sup>Ekstrakti historik i lëshuar nga DPT-ja për pagat *bruto* të përfituara në periudhën prill 2014 – mars 2019.

<sup>83</sup>Kontratë, datë 19.9.2014; kontratë, datë 9.3.2017; kontratë, datë 25.3.2019.

<sup>84</sup>Vërtetim, datë 22.9.2020, nga DRT-ja Shkodër për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për shtetasin H. L., për periudhën janar-mars 2019; vërtetim, datë 22.9.2020, nga DRT-ja Tiranë, për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për shtetasen M. L., për periudhën janar-mars 2019; vërtetim, datë 22.9.2020, nga DRT-ja Tiranë për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për shtetasen I. L., për periudhën janar 2019 – gusht 2020.

<sup>85</sup>Vërtetim, datës 26.10.2021, i Federatës Shqiptare të Futbollit për punësimin e shtetasit H. L. në periudhën shtator 2003 – gusht 2005.

<sup>86</sup>Ligji nr. 7703, datë 11. 5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; VKM-ja nr. 346, datë 13.6.2002, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”; ligji nr. 9326, datë 6.12.2004.

- në deklaratën noteriale, datë 15.1.2010, e mbesa I.L. deklaroi hua në shumën 5,000 euro dhënë nga prindërit e saj në vitin 2009;
- në ILDKPKI në vitin 2013, subjekti deklaroi hua në shumën 5,000 euro, H. L. në mars 2010;
- në pyetësin nr. 2, subjekti deklaroi hua 5,000 euro, në vitin 2010;
- në pyetësin nr. 5, subjekti deklaroi se në DIPP e 2009 është pasqyruar shuma 10,000 euro marrë hua kumatit H. L.

Për konstatimet e mësipërme, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Aneksit të Kushtetutës.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

10.9 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, ka shpjeguar se dhe për konstatimet e Komisionit, për pasaktësitë në deklaram për huan e marrë H. L., vlejné të njëjtat shpjegime të dhëna si më lart për huan marrë shtetasit Gj. R. trajtuar në pikën 9.12 dhe 9.13 të vendimit. Subjekti shpjegon se Komisioni, për huan e marrë kumatit H.L., ka konfirmuar burimin e ligjshëm të të ardhurave për justifikimin e shumës së marrë hua.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

10.10 Komisioni vëren se gjatë hetimit administrativ subjekti i rivlerësimit arriti të provojë mundësitë financiare të huadhënësit H.L. për dhënien e huas.

Për pasaktësitë në deklarime, ashtu siç subjekti ka shpjeguar më lart këto pasaktësi/lapsuse nuk kanë qenë të qëllimshme për fshehje pasurie apo burim i tyre.

**Komisioni vlerëson se pasaktësitë në deklaram për huan e marrë shtetasit H. L. qëndrojnë, por nuk janë në atë masë sa Komisioni të aplikojë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit.**

### **11. Dhurata për apartamentin e ri nga dy motrat në shumën 2,000 USD**

11.1 Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar: *“Dhuratë për shtëpinë e re nga dy motrat që jetojnë e punojnë në SHBA (shtetase amerikane), në shumën 2000 USD”*.

11.2 Në pyetësin standard, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale të datës 29.1.2020<sup>87</sup>, ku znj. Pranvera Kodra deklaroi se: *“Së bashku me motrën P. P. që jetojmë në SHBA që nga viti 1999 kanë kontribuar me të holla ndër vite duke ndihmuar dy prindërit të cilët kanë jetuar me vëllain dhe familjen e tij. Përveç kontributit që ka qenë 200 USD/muaj nga 100 USD/muaj secila, shuma të cilat administroheshin nga subjekti i rivlerësimit, në momentin që ai ka hyrë në banesën e re, ne dy motrat i kemi dhuruar nga 1,000 USD/secila”*.

11.3 Subjekti ka dhënë shpjegime përgjatë hetimit se shuma 2000 USD i është dhënë nga motrat me rastin e apartamentit të ri. Përveç kësaj shume, motrat kanë kontribuar si ndihmë për prindërit në formë *cash* kur kanë ardhur vetë. Në ndonjë rast janë dërguar dhe me ndonjë të afërm të njohur në pamundësi për të ardhur vetë.

11.3.1 Subjekti i rivlerësimit ka depozituar, si dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të shumës 2,000 USD të dhuruar nga motrat e tij në vitin 2010, si dhe të ndihmave monetare dhënë për prindërit për periudhën 2012 – 2015, pasqyrat për pagat dhe taksat<sup>88</sup>. Bazuar në këtë

<sup>87</sup>Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 29.1.2020, me deklarues P. K.

<sup>88</sup>Formulari E-2, për periudhën 2003– 2015.

dokumentacion, Komisioni llogariti mundësinë për kursim të znj. P. P. dhe znj. P. K. Nga analiza e kryer nga Komisioni, në lidhje me mundësinë për kursim të znj. P. P. rezultoi, se për periudhën 2010 – 2015, ka krijuar të ardhurat *bruto* dhe *neto* përkatësisht në shumat 570,948 USD dhe 478,092 USD. Mundësia për kursim, pas zbritjes së shpenzimeve jetike prej 144,954 USD dhe shumave të dhuruara, ndër vite, prej 4,400 USD rezulton, të jetë në vlerën 328,738 USD.

Nga analiza e kryer nga Komisioni, në lidhje me mundësinë për kursim të znj. P. K. rezultoi se, për periudhën 2010 – 2015, ka krijuar të ardhurat *bruto* dhe *neto* përkatësisht në shumat 232,094 USD dhe 208,450 USD. Mundësia për kursim, pas zbritjes së shpenzimeve jetike prej 144,954 USD dhe shumave të dhuruara, ndër vite, prej 4,400 USD, rezulton të jetë në vlerën 59,096 USD.

11.3.2 Nga analiza financiare rezultoi se motrat e subjektit kanë pasur të ardhura të ligjshme për të dhuruar shumën 2,000 USD në vitin 2010 dhe për të kontribuar për prindërit në vitet 2012 – 2015 dhe, për rrjedhojë, këto shuma janë marrë në konsideratë në analizën financiare të kryer nga Komisioni. Dokumentacioni i depozituar nga subjekti është në formën e kërkuar nga ligji (i përkthyer dhe noterizuar dhe me vulë apostile).

**Nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë deklaram.**

## **12. Analiza financiare për periudhën 2003 - 2016**

12.1 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se:

- Nga analiza e deklaratave të interesave pasurore private/vjetore dhe deklaratës *Vetting*, për periudhën e hetimit 2003 – 2016, të kryer nga Komisioni rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasurinë në shumën 6,512,308 lekë.

Për konstatimin e mësipërm, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit dhe iu kërkuar shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Aneksit të Kushtetutës.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

12.2 Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ka kryer vetë një analizë financiare ku ka paraqitur dhe shpjeguar mospërputhjet e analizës së kryer prej tij dhe analizës financiare të kryer nga Komisioni, duke argumentuar çdo të ardhur, hua, shpenzim apo ndryshime në gjendjen e likuiditeteve të marra në konsideratë në këtë analizë. Në analizën financiare, për periudhën 2003–2016, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni duhet të marrë në konsideratë:

12.2.1 Kursimet e bashkëshortes së subjektit në shumën 35,000 euro të krijuara në periudhën 1980 – 1999 sepse këto të ardhura janë me burime të ligjshme.

12.2.2 Balancën pozitive/tepricën e vitit si likuiditet/fonde hyrëse për vitin pasardhës sipas parimit të vijmësisë. Këto teprica duhen marrë në konsideratë, për periudhën 2003 – 2008, sepse deklaratat periodike të vëna në dispozicion nga ILDKPKI-ja nuk janë shoqëruar me formularë për të deklaruar nga personat e lidhur me subjektin deklarues.

12.2.3 Huan e marrë nga shtetasi Gj. R., në shumën 10,000 euro, për të cilën subjekti ka provuar burimin e ligjshëm të huas.

12.2.4 Të ardhurat nga qiraja të përfituara nga bashkëshortja e subjektit nga dhënia me qira e shtëpisë së trashëguar nga prindërit sepse personi i lidhur me subjektin, bashkëshortja është përjashtuar nga detyrimi për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës individuale vjetore të të



ardhurave sepse realizon të ardhura *bruto* vjetore më pak se 2,000,000 (dy milionë) lekë, sipas nenit 13 të ligjit nr. 8438/1998, i ndryshuar. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se bashkëshortja e tij ka qenë e përjashtuar nga tatimet, pasi ka përfituar të ardhura nga pensioni, qira objektësh që janë nën minimumin e përcaktuar në Dekretin e Presidentit të Republikës së Italisë nr. 917, datë 22.12.1986.

12.2.5 Në llogaritjen e shpenzimeve jetike duhet mbajtur parasysh përbërja e familjes së bashkëshortes në Itali, në vitet 1980 -1981 ka qenë me 5 anëtarë, për periudhën 1982-1996 familja e saj ka qenë me 4 anëtarë, për periudhën 1997-1999 familja e saj ka qenë me 3 anëtarë. Shpenzimet jetike, për periudhën 2000-2005, nuk duhen llogaritur në atë vlerë që i ka pasqyruar Komisioni, pasi bashkëshortja e subjektit ka qëndruar te prindërit e saj. I njëjti argument është edhe për shpenzimet jetike, për periudhën 1980 – 1991.

12.2.6 Të ardhurat nga diferencat e çmimeve të shitjes të mjeteve, të cilat duhet të përfshihen në të ardhura sepse janë të provuara me dokumentacion justifikues.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

12.2.7 Komisioni vëren se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, në lidhje me shpenzimet jetike të llogaritura për bashkëshorten e tij për periudhën 1980-1991, qëndron dhe, për këtë arsye, e mori në konsideratë atë. Nga rillogaritja rezultoi se shpenzimet jetike të bashkëshortes, për periudhën 1980– 1991, bëhen 23,858 euro nga 35,251 euro që ishin.

Në lidhje me rillogaritjen e shpenzimeve, për periudhën 2000 – 2005, Komisioni vëren se pretendimi i subjektit nuk qëndron sepse llogaritja e shpenzimeve për vitin 2001 është bërë sipas përbërjes familjare (familje me 3 anëtarë në Itali), nga të cilat bashkëshortes i janë ngarkuar shpenzimet për vete dhe për djalin për vitin 2001 (kohë e qëndrimit të saj në Itali), duke e saktësuar atë në vlerën 12,392 euro nga 13,170 euro që ishte fillimisht.

Me ndryshimin e shpenzimeve jetike, Komisioni saktësoi edhe mundësinë financiare të bashkëshortes së subjektit për të kursyer shumë 35,000 euro deri në vitin 2005. Nga rillogaritja rezultoi se mundësia për kursim bëhet 42,974 euro nga 30,804 euro që ishte. Komisioni përfshiu në analizën financiare të subjektit kursimet *cash* të bashkëshortes në shumë 35,000 euro. Nisur nga kjo Komisioni pasqyroi në analizën e përgjithshme të subjektit para vitit 2003, të ardhurat, shpenzimet dhe likuiditetet e bashkëshortes së subjektit për periudhën 1980 – 2002.

Në lidhje me tepricat pozitive, Komisioni vëren se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar dhe, për këtë arsye, nuk e mori në konsideratë atë. Metodologjia e aplikuar, për subjektin e rivlerësimit në fjalë, është e njëjta metodologji që Komisioni ka aplikuar në të gjitha subjektet e tjera të këtij procesi. Për më tepër mbartja e tepricave pozitive do të shkelte parimin e pasqyrit me saktësi të informacionit për aq kohë sa këto teprica nuk janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-të përkatëse.

Në lidhje me huan e marrë nga shtetasi Gj. R., Komisioni vëren se me dokumentacionin e vënë në dispozicion, subjekti i rivlerësimit arriti të provojë në tërësi burimin e ligjshëm të shumës 10,000 euro dhënë hua nga shtetasi Gj.R.

Komisioni vëren se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, në lidhje me të ardhurat nga qiraja për bashkëshorten e subjektit, nuk qëndron sepse në bazë të parimit të rezidencës sanksionuar në ligjin nr. 8438/1998, bashkëshortja e subjektit duhet të tatohet në Shqipëri për të gjitha të ardhurat e përfituara brenda apo jashtë territorit të saj. Një tatim i tillë quhet tatim mbi baza botërore ose tatim i rezidentëve për të ardhurat e realizuara në shkallë botërore. Mungesa e detyrimit për të plotësuar

DIVA nuk do të thotë që individi është i përjashtuar nga pagesa e tatimit për të ardhurat e realizuara nga qiraja edhe pse këto të ardhura janë realizuar jashtë territorit shqiptar. Shpjegimet e dhëna nga subjekti, në lidhje me përjashtimin e bashkëshortes së tij për paraqitjen e deklaratës tatimore në Itali, nuk legjitimojnë pretendimin e tij se këto janë të ardhura të përjashtuara nga tatimi. Edhe nëse për këto të ardhura nuk do të paguhej tatim në Itali, bazuar në parimin e burimit, përsëri sipas ligjit nr. 8438/1998, do të duhej të paguhej tatim në Shqipëri sipas parimit të rezidencës.

Në lidhje me diferencat e çmimeve të shitjes së mjeteve, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse dhe, për këtë arsye, ato nuk janë marrë në konsideratë në analizën financiarë. Gjithashtu, tashmë ka një praktikë të konsoliduar edhe nga Kolegji lidhur me diferencat e çmimeve të shitjes së automjeteve për të cilat nuk është paguar tatimi mbi të ardhurat.

**Në përfundim, Komisioni, pasi mori në konsideratë kursimet e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit të krijuara në periudhën 1980 – 1999, në shumën 35,000 euro dhe huan e shtetasit Gj. R. dhënë në vitin 2010, në shumën 10,000 euro, i pasqyroi në analizën financiare të rishikuar, e cila rezultoi me një balancë negative në vlerën 908,163 lekë, përkatësisht me -563,752 lekë, në vitin 2008 dhe -344,411 lekë, në vitin 2011.**

**Mungesa e burimeve të ligjshme në shumën 908,163 lekë, për periudhën 2003 – 2016, marrë për bazë parimin e proporcionalitetit, nuk përbën shkak të mjaftueshëm për aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit të subjektit të rivlerësimit, sipas pikës 1, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.**

**Tabela nr. 10**

Përshkrimi	1993-2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>Të ardhurat</b>	<b>19 095 506</b>	<b>916 109</b>	<b>2 953 068</b>	<b>1 029 108</b>	<b>1 465 149</b>	<b>2 431 704</b>	<b>1 683 324</b>	<b>2 006 321</b>	<b>2 347 386</b>	<b>1 650 640</b>	<b>1 883 687</b>	<b>2 110 236</b>	<b>2 361 678</b>	<b>1 931 248</b>	<b>1 884 448</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	3 062 341	643 670	792 980	773 860	791 362	887 913	957 694	1 049 869	1 288 818	1 164 239	1 095 152	1 167 334	1 352 924	1 330 648	1 374 832
Të ardhura nga paga e b/shortes	11 847 850	61 212	1 713 905	28 674	411 436	736 221	411 676	473 785	481 393	486 401	505 786	522 142	527 234	518 577	509 616
Të ardhura nga qiraja b/sh		-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Të ardhura nga shënjë e mjetit			216 648			250 000									
Të ardhura nga dhuratat (motrat në USA)									209 900						
Të ardhura nga pensioni i nënës	502 090	84 111	91 223	89 849	104 192	114 613	136 190	146 889	162 609	-	112 236	175 048	176 929	31 367	-
Të ardhura nga pensioni i babait	683 225	127 116	138 313	136 724	158 159	165 242	177 764	194 003	204 667	-	-	-	-	-	-
Të ardhura nga kontributi i dy motrave (secila 100 USD/muaj)											170 512	245 712	272 736	50 656	-
Të ardhurat nga interesat e depozitës së b/sh në IT						277 715		141 775					31 855		
Të ardhura nga shënjë e banesës në pronësi të prindërve	3 000 000														
<b>Detyrime</b>	<b>241 453</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>1 855 545</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>1 371 700</b>	<b>1 388 100</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
Detyrime ndaj shoqërisë ***** shpk					1 855 545										
Hua marrë shtetasit Gj. R									1 388 100						
Hua marrë shtetasit H. L.								1 371 700							
Kredi 4,000,000 lireta oe 2,066 euro	241 453														
<b>Shpenzime</b>	<b>8 738 761</b>	<b>469 320</b>	<b>609 368</b>	<b>956 165</b>	<b>817 976</b>	<b>2 008 059</b>	<b>2 246 437</b>	<b>2 330 843</b>	<b>2 702 616</b>	<b>1 236 893</b>	<b>1 437 777</b>	<b>1 485 476</b>	<b>1 470 759</b>	<b>1 380 175</b>	<b>1 665 553</b>
Shpenzime jetike	7 943 491	469 320	469 320	547 785	547 785	1 179 840	683 100	683 100	683 100	409 860	517 088	564 096	879 992	691 518	705 276
Shpenzime mobilimi		-	-	-	-	-	-	1 371 700	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzime udhëtimi	505 549	-	140 048	363 380	220 191	168 669	244 512	216 043	151 986	208 833	155 089	200 000	200 000	296 355	459 918
Shpenzime shkolli		-	-	45 000	50 000	55 000	57 000	60 000	63 000	65 000	67 000	300 750	390 767	392 303	360 359
Pagesë për shlyerje huaje Gj. R									416 430	553 200	419 160	-	-	-	-
Pagesë për shlyerje huaje H.L.									694 050		279 440	420 630	-	-	-
Pagesë për shlyerje detyrimi për shtëpinë						604 550	1 231 825								
Pagesë e hipotekës së banesë në Rr. *****															140 000
Shpenzime dok. për mjetin *****							30 000								
Shpenzime për ap. 4,850 euro									694 050						
Shpenzime kredie 4,800,000 lireta ose 2,479 euro	289 721														
<b>Pasuri</b>	<b>8 318 498</b>	<b>287 329</b>	<b>1 004 349</b>	<b>-162 463</b>	<b>2 316 544</b>	<b>75 397</b>	<b>639</b>	<b>-255 237</b>	<b>956 765</b>	<b>758 158</b>	<b>399 785</b>	<b>544 870</b>	<b>399 470</b>	<b>-34 451</b>	<b>-1 518 496</b>
Kursime (shtesa/pakësime likuiditeti)	5 807 830	287 329	298 085	(162 463)	(3 986 371)	75 397	(229 361)	(255 237)	956 765	758 158	399 785	544 870	399 470	(34 451)	(1 518 496)
Apartament 87m2, Shkodër	31 840														
Apartament 100m2, rr.*****	1 900 000														
Automjet tip Ford Sierra, vp 1990	216 648	-													
Automjet tip Benz, vp 1987			250 000												
Apartament Rr.*****					6 302 915										
Automjet Volkswagen Pasat *****							230 000								
Banesë dy katëshe, kati i parë me adresë ***** , Itali															
Autoveturë tip Bravo, prodhim 1997			456 264												
Autoveturë tip Opel Corsa blerë 1986 , 6,000,000 lireta ose 3,099 euro	362 180														
<b>Të ardhura + detyrime - shpenzime - pasuri</b>	<b>2 279 701</b>	<b>159 460</b>	<b>1 339 352</b>	<b>235 406</b>	<b>186 173</b>	<b>348 248</b>	<b>-563 752</b>	<b>1 302 415</b>	<b>76 105</b>	<b>-344 411</b>	<b>46 124</b>	<b>79 889</b>	<b>491 450</b>	<b>585 524</b>	<b>1 737 391</b>

## B. KONTROLLI I FIGURËS

**13.** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), pas kërkesës së Komisionit, ka dërguar pranë Komisionit raportin mbi kontrollin e figurës nr. \*\*\* prot., datë 21.11.2017, për subjektin e rivlerësimit Gjon Kodra, i deklasifikuar plotësisht, me vendim nr. \*\*\*, datë 9.7.2021, të KDZh-së) dhe nga Grupi i Punës është konstatuar *përshtatshmëria për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Gjon Kodra.*

13.1 DSIK-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.10.2021, ka dërguar pranë Komisionit raportin nr. \*\*\* prot., datë 19.10.2021, të përditësuar dhe të deklasifikuar pjesërisht me vendim nr. \*\*\*, datë 20.10.2021, të KDZh-së, ku informon se: *“Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, është përcjellë pranë Komisionit raporti për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Gjon M. Kodra me konstatimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës”.*

i) Informacionet e ardhura nga institucionet e verifikimit në kohështrirje përpara periudhës së rivlerësimit na bëjnë me dije:

- Subjekti i rivlerësimit, në vitin 2008 ka pasur një kontakt të papërshtatshëm/jorastësor me një person të përfshirë në trafikun e lëndëve narkotike ku dyshohet se z. Gjon Kodra mund të jetë përfshirë edhe vetë në këtë aktivitet.
- Për kohën brenda periudhës së rivlerësimit nga viti 2017 dhe aktualisht, institucioni i verifikimit, në lidhje me subjektin e rivlerësimit, nuk disponon të dhëna/informacione për përfshirje në aktivitete të kundërligjshme.

ii) Në vlerësim të të dhënave që disponohen për subjektin e rivlerësimit rezulton se:

- Bazuar në parashikimet e bëra në aneksin “rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve”, neni DH “kontrolli i figurës”, pika 2, që përcakton si periudhë të vlerësimit për kontrollin e figurës, datën 1.1.2012, nisur nga të dhënat e sipërcituara veprimtaria e dyshuar si kontakt i papërshtatshëm i përket një periudhe përpara këtij afati.
- Ky fakt të konsiderohet rrethanë lehtësuese, sipas përcaktimeve dhe kritereve të përcaktuara në germën “d”, të pikës 5, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016 pasi veprimtaria e dyshuar e kundërligjshme e subjektit të rivlerësimit i përket një periudhe shumë të hershme kohore dhe nuk ka tregues apo të dhëna që të evidentojnë faktin që të vazhdojë.

Në konfirmim të konstatimit fillestar për përshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit Gjon M. Kodra, gjykojmë që për rastin në fjalë konkluzioni të mbetet në vlerësimin tuaj nën dritën e informacioneve të tjera që mund të dispononi si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ që po kryhen ndaj subjektit të rivlerësimit.

13.2 Nga informacioni i vënë në dispozicion nga organet ligjzbatuese, datë 19.1.2008, rezulton që shtetasi P. A., me numrin \*\*\*\*\* ka telefonuar numrin \*\*\*\*\* me përdorues shtetasin Gjon M. Kodra, ku është realizuar një bisedë telefonike ndërmjet tyre.

13.3 Komisioni ka administruar shkresën e shoqërisë \*\*\* sh.a.,<sup>89</sup> e cila konfirmon se numri i telefonit \*\*\*\*\* rezulton i regjistruar në emrin e shtetasit Gjon M. Kodra, i datëlindjes 1.5.1964, ndërsa numri i telefonit \*\*\*\*\* , për periudhën 26.6.2006 – 9.4.2009, ka qenë i regjistruar në emrin e shtetasit P. A., për periudhën 9.4.2009 – 15.12.2011, regjistruar në emër të “\*\*\*\*\*”, por me përdorues po shtetasin P. A.

<sup>89</sup>Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 12.10.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë 20.10.2021, të shoqërisë \*\*\* sh.a.

13.4 Komisioni ka administruar përgjigjen e Gjykatës e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar<sup>90</sup> (GJPSHPKK në vijim) që konfirmon se pas verifikimeve të kryera pranë saj nuk rezulton të ketë vendime penale për shtetasin P. A.

13.5 Komisioni ka administruar përgjigjen e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar<sup>91</sup> (PPKKO në vijim), e cila konfirmon se në datën 11.10.2007 është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, në ngarkim të shtetasit P. A., për veprat penale të parashikuara nga nenet 283/a “trafikimi i narkotikëve” dhe 333 “organizata kriminale”, të Kodit Penal dhe pas përfundimit të këtij procedimi është vendosur pushimi i këtij procedimi, datë 1.9.2009, për shtetasin P. A., pasi nuk është konstatuar asnjë element të veprës penale.

13.6 Komisioni, me pyetësin nr. 4, ka pyetur subjektin e rivlerësimit Gjon Kodra, nëse ka pasur njohje me shtetasin P. A, a ka udhëtuar ndonjëherë me këtë shtetas, a ka komunikuar në telefon me këtë shtetas, a ka pasur shoqëri të vazhdueshme personale apo familjare.

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: “Shtetasin P. A., e kam njohur si vëllanë e ish-deputetit S. A. Me këtë shtetas nuk kam pasur lidhje shoqërore apo familjare. Nuk kam udhëtuar kurrë me këtë person, si dhe nuk kam qëndruar asnjëherë me të në ndonjë ambient si bar-kafe apo vende të tjera. Nuk më kujtohet nëse kam komunikuar ndonjëherë në telefon me të. Nuk kam pasur kontakte apo biseda që lidhen me detyrën të cilën kryej”.

13.7 Gjatë procesit të hetimit, në lidhje me figurën e subjektit të rivlerësimit, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (në vijim ONM/vëzhguesi ndërkombëtar), i ka përcjellë Komisionit, materialin “gjetje”<sup>92</sup> mbi ekzistencën e standardeve ligjore, sipas të cilave neni Dh i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i referohet periudhës nga data 1 janar 2012 deri ditën e deklarimit vetëm për plotësimin e deklaratës për figurën nga subjekti i rivlerësimit.

Bazuar në nenin 38, pika 4 dhe 6, të ligjit nr. 84/2016, vlerësimi i figurës bazohet në dy aspekte komplementare të njëri-tjetrit dhe përkatësisht: (a) konstatimin e një kontakti të papërshtatshëm (aspekti përmbajtësor); dhe (b) aspektit formal që lidhet me plotësinë dhe besueshmërinë e deklarimit.

Mjaftueshmëria dhe vërtetësia e deklarimit kontrollohen për periudhën e deklaruar në Kushtetutë, ndërsa aspekti i përmbajtësor i kontrollit të figurës, afati i tij mund të shtrihet edhe përpara datës 1 janar 2012.

Ligji nr. 84/2016, neni 38, pika 5, germa “d”, parashikon një rrethanë lehtësuese: “...kur kontaktet e subjektit të rivlerësimit kanë qenë pesë vjet më parë dhe nuk ka ndonjë tregues që ato vazhdojnë ende. Kjo rrethanë mund të vlerësohet në raport me shkallën e seriozitetit të kontakteve dhe/ose me rrethanat e parashikuara në pikën 4 të këtij neni”.

**Ky përkufizim e shtyn afatin e aspektit përmbajtësor të kontrollit figurës për kontaktet e papërshtatshme edhe përpara datës 1 janar 2012, por kjo duhet të konsiderohet si rrethanë lehtësuese, e cila më pas do të vlerësohet [...]”** (vendimi i KPA 30/2019 për subjektin e rivlerësimit A.J, pika 55);

Vëzhguesi ndërkombëtar disponon dokumentacionin nga Italia<sup>93</sup>, sipas të cilit një shtetas P. A., i datëlindjes 25.10.1966, është dënuar me vendim të formës së prerë me 18 vjet burgim (në vitin

<sup>90</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.10.2021, e GJPSHPKK-së.

<sup>91</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.10.2021, e PPKKO-së.

<sup>92</sup>Referoju materialit “gjetje” në dosje i cili ka të bashkangjitur dhe materialet e dërguara nga Ministria e Drejtësisë Italiane për shtetasin P. A.

<sup>93</sup>Dokument nga sistemi informativ i dëshmimeve “Certifikatë penale e dëshmisë së penaltetit” të Ministrisë së Drejtësisë Italiane ku rezulton: (a) vendim i parevokueshëm i Gjykatës së Apelit të Milanos i datës 3.11.2011 – Lënie në fuqi i vendimit datë 22.6.2010 nga Gjykata e Milanos. Vepra penale e I-rë “trafik i paligjshëm i lëndëve narkotike në bashkëpunim” neni 110 i K.P, neni 73, pika 1 DPR 9.10.1990 nr. \*\*\* ( i kryer me 13.2.2006 në Milano, Torino). Vepra penale e II-të “trafik i paligjshëm i lëndëve narkotike në bashkëpunim” neni 110 i K.P,

2011), për veprat penale “trafik droge” dhe “krim i organizuar”. Personi përfitonte në shtetin Italian një masë amnistie “*indulto*” që mund të ulë dënimin, por që nuk eliminon përgjegjësinë penale. Për rrjedhojë, rezulton se dënimi i formës së prerë për këto vepra penale është ulur përfundimisht në 2 vjet e 6 muaj burgim dhe si masë sigurie personi është deportuar nga shteti italian.

Vëzhguesi Ndërkombëtar thekson jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, siç përcaktohet në vendimin nr. 30/2019, në çështjen e subjektit të rivlerësimit A. J.

Në këtë vendim theksohet, ndër të tjera, se neni Dh i Aneksit të Kushtetutës, i sipërcituar, periudhën “nga data 1 janar 2012 e deri në ditën e deklarimit” e lidh vetëm me plotësimin e deklaratës së figurës prej subjektit të rivlerësimit. Ligji nr. 84/2016, i cili detajon procedurën e kontrollit të figurës, të kryer nga DSIK-ja dhe Komisioni, në asnjë rast nuk e kufizon kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit vetëm për periudhën nga 1 janari 2012 dhe deri në ditën e deklarimit të subjektit.

Bazuar në nenin 38, pikat 4 dhe 6, të ligjit nr. 84/2016, kontrolli për figurën bazohet në dy komponentë komplementarë të njëri-tjetrit, në elementin përmbajtësor të këtij kontrolli, i cili është konstatimi i ekzistencës së kontaktit të papërshtatshëm, si dhe në elementin formal që është konstatimi i plotësisë dhe besueshmërisë së deklarimit. Mjaftueshmëria dhe vërtetësia e deklarimit kontrollohen për periudhën e deklaruar në Kushtetutë, ndërsa për sa i përket aspektit përmbajtësor të kontrollit të figurës, afati i tij mund të shtrihet edhe përpara datës 1 janar 2012.

Ligji nr. 84/2016, neni 38, pika 5, germa “d”, parashikon një rrethanë lehtësuese: “... *kur kontaktet e subjektit të rivlerësimit kanë qenë pesë vjet më parë dhe nuk ka ndonjë tregues që ato vazhdojnë ende. Kjo rrethanë mund të vlerësohet në raport me shkallën e seriozitetit të kontakteve dhe/ose me rrethanat e parashikuara në pikën 4 të këtij neni*”.

Ky përkufizim e shtyn afatin e aspektit përmbajtësor të kontrollit figurës për kontaktet e papërshtatshme edhe përpara datës 1.1.2012, por kjo duhet të konsiderohet si rrethanë lehtësuese, e cila më pas do të vlerësohet. Për këtë vëzhguesi ndërkombëtar i referohet dhe vendimit nr. 30/2019, për subjektin e rivlerësimit A. J., pika 55, të Kolegjit.

DSIK-ja, në mbështetje të nenit 38, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, e ka cilësuar distancën kohën si rrethanë lehtësuese në raportin e saj për subjektin e rivlerësimit, por në vlerësimin e rëndësisë

---

neni 73 pika 1 DPR 9.10.1990 nr. \*\*\* ( i kryer nga 23.3.2006 deri me 5.4.2006 në Lombardia). Rrethanat: Neni 73 pika 6 DPR 9.10.1990 nr. \*\*\*; neni 80, pika 2 DPR 9.10.1990 nr. \*\*\*; Vepra penale e III-të “trafik i paligjshëm i lëndëve narkotike në bashkëpunim neni 110 i Kodi Penal, neni 73 pika 1 DPR 9.10.1990 nr. \*\*\* (i kryer nga 26.7.2006 – 27.7.2006, në Shqipëri dhe në Itali në Milano) Rrethanat: neni 73, pika 6, DPR 9.10.1990 nr. \*\*\*; neni 80 pika 2, DPR 9.10.1990 nr. \*\*\*; vepra penale e IV-ërt “Themelim, drejtim ose financim i shoqatës së finalizuar në trafikimin e lëndëve narkotike” neni 74, pika 1 DPR, 9.10.1990 nr. \*\*\* (i kryer nga 1.2.2006 deri më 27.7.2006 në Shqipëri dhe në Itali”. Dispozitivi: rrethana lehtësuese të përgjithshme neni 62 bis Kodi Penal. Konsiderohet vazhdimësia midis veprave penale sipas pikave 1,2,3,4 “heqje lirie 18 vite”. Dënimet plotësuese: (a) përjashtim i përjetshëm nga detyrat publike; (b) përjashtim ligjor për të gjithë kohëzgjatjen e dënimit. Masat e sigurisë: përjashtim i të huajit nga shteti (neni 235 i Kodit Penal). Vendim i mëpasshëm lëshuar gjatë ekzekutimit të vendimit të datës 27.6.2012. Me vendim të gjykatës në përbërje monokratike të Milanos aplikohet “falja” sipas L. 31.7.2006, nr. \*\*\*. Dënimi kryesor i falur: heqje lirie 2 vite e 6 muaj. Për veprat penale sipas pikës 2.4. Totali i vendimeve të pranishme 1. *Marrë nga zyra e dëshmive të penaltetit qendrorë – Ministria e Drejtësisë Roma* 21.10.2021; (c) certifikatë penale e dëshmisë së penaltetit nr. \*\*\*; në emër të shtetasit P. A., i datëlindjes 25.10.1966. Vërtetohet se në bazë të të dhënave të dëshmisë së penaltetit rezulton “i padënuar”, Romë 21.10.2021; (ç) certifikatë penale e dëshmisë së penaltetit nr. \*\*\*; në emër të shtetasit P. A., i datëlindjes 25.10.1966. Vërtetohet se në bazë të të dhënave të dëshmisë së penaltetit rezulton “i pa dënuar”, Romë, më 21.10.2021; (d) certifikatë penale e dëshmisë së penaltetit nr. \*\*\*; në emër të shtetasit Gjon Kodra, i datëlindjes 5.1.1964. Vërtetohet se në bazë të të dhënave të dëshmisë së penaltetit rezulton “i padënuar”, Romë më 21.10.2021; (e) certifikatë penale e dëshmisë së penaltetit nr. \*\*\*; në emër të shtetasit Gjon Kodra, i datëlindjes 5.1.1964. Vërtetohet se në bazë të të dhënave të dëshmisë së penaltetit rezulton “i padënuar”, Romë më 21.10.2021.

së veprimit dhe cenimit të pastërtisë së figurës të subjektit, DSIK-ja e ka vlerësuar atë si një veprimtari të paligjshme, duke e gjetur subjektin si të papërshtatshëm për të vazhduar detyrën/funksionin e tij. Sa më sipër, Komisioni, me të drejtë ka vlerësuar të mos e marrë në konsideratë rrethanën lehtësuese, në vlerësimin e kontrollit të figurës për subjektin e rivlerësimit. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se vlerësimi për kontrollin e figurës nuk është brenda periudhës së vlerësimit, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, është i pabazuar.

Bazuar në sa më sipër: “Mjaftueshmëria dhe vërtetësia e deklaratës së pastërtisë së figurës kontrollohet për periudhën e përcaktuar në Kushtetutë, ndërsa në aspektin e përmbajtësor të kontrollit të figurës, afati i tij mund të shtrihet edhe para datës 1.1.2012.”

Kjo do të thotë se subjekti Gjon Kodra, ndaj të cilit duhet të zbatohen standardet ligjore, nuk mund të jetë përgjegjës - sipas “elementit formal” të vlerësimit të figurës - për një deklaram të pamjaftueshëm eventual, nëse ka pasur kontakte të papërshtatshme në kushtet e ligjit të *Vettingu-t*, para vitit 2012.

Megjithatë, duke marrë parasysh “elementin përmbajtësor” të vlerësimit të figurës, i cili mund të shtrihet edhe para janarit 2012, subjekti i rivlerësimit mund të vlerësohet përgjegjës për kontaktet e mundshme të papërshtatshme që mund të kenë ndodhur më herët, megjithëse afati kohor i mëparshëm i këtyre kontakteve duhet të konsiderohet si rrethanë lehtësuese, në përputhje me nenin 38, pika 5, germa “d” të ligjit nr. 84/2016.

#### **Vazhduesi ndërkombëtar në konkluzion është shprehur:**

Jurisprudenca e Kolegjit të Posaçëm të Apelit thekson qartë se “aspekti përmbajtësor” i vlerësimit të figurës mund të shtrihet përtej janarit të vitit 2012 dhe kontaktet e mëparshme të subjekteve me persona të përfshirë në krimin e organizuar duhet të merren parasysh. Megjithatë, ky “afat i shtrirë/i zgjatur” do të përbënte (së bashku me elementët e tjerë specifikë sipas rastit) një rrethanë lehtësuese.

Nisur nga sa më sipër, Komisionit i rekomandohet të zbatojë gjetjet e paraqitura më lart në këtë dokument në procesin e rivlerësimit të subjektit Gjon Kodra dhe të vlerësojë ndikimin që ato mund të kenë në rezultatin (edhe në aspektin e vlerësimit të përgjithshëm) të këtij subjekti rivlerësimi.

13.8 Duke marrë për bazë dhe gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar, Komisioni ka konstatuar se në deklaratën për kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit, në pjesën nr. 5, “të dhëna për sigurinë”, në pikën “c” ku shtrohet pyetja “*a keni pasur kontakte të papërshtatshme në formën e një takimi, komunikimi elektronik ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi të qëllimshëm me një ose shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës?* Subjekti është përgjigjur me “jo”.

Po kështu dhe në pikën “ç”, ku shtrohet pyetja: *A keni pasur kontakte të përshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ?* Subjekti është përgjigjur me “jo”.

13.9 Komisioni gjatë hetimit administrativ ka konstatuar se:

- subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kontaktin e papërshtatshëm në deklaratën për kontrollin e figurës;
- subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakt të papërshtatshëm në shkelje të nenit 38 ligjit nr. 84/2016;
- subjekti i rivlerësimit të vërtetojë me dokument ligjor që nuk ka hetuar, nuk ka marrë vendim mosfillimi/pushimi, nuk ka dërguar kërkesa për gjykim për procedime penale të regjistruara në ngarkim të shtetasit P. A.

Për konstatimet e mësipërme, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Aneksit të Kushtetutës.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

13.10 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij ka shpjeguar se informacioni i ardhur nga institucionet e rivlerësimit është absurd. Subjekti thekson se nuk është përfshirë kurrë në jetën e tij me aktivitete të kundërligjshme. Nëse institucioni i verifikimit ka pasur dyshime se ai si prokuror është përfshirë në aktivitet kriminal, i ka pasur të gjitha mundësitë nëpërmjet metodave speciale të hetimit (si përgjim, vëzhgim, fotografim, filmim, etj.) ta verifikonte apo t'ia dërgonte institucioneve të tjera për të kryer veprime procedurale. Institucionet e tjera nuk e kanë kryer detyrën e tyre ose nuk e kanë vlerësuar si të kundërligjshme.

Institucionet e kanë pasur detyrë të informonin menjëherë Prokurorin e Përgjithshëm dhe të sugjeronin regjistrimin e procedimit penal dhe fillimin e hetimeve ndaj meje. Prokurori në këtë aktivitet kriminal, nuk do të kalonte lehtë pa u verifikuar.

Në praktikat e përditshme në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në raste të tilla, fillon menjëherë procesi i verifikimit dhe në varësi të tij, procedohet me regjistrimin apo jo të procedimit penal.

Bazuar në nenin 35 “fillimi i procedurës për kontrollin e figurës”, të ligjit nr. 84/2016, në cilësinë e subjektit të rivlerësimit, është plotësuar deklarata për kontrollin e figurës, e cila i është dërguar zyrtarisht DSIK-së. Në zbatim të pikës 2 të këtij neni DSIK-ja fillon menjëherë procedurën e kontrollit të figurës, në përputhje me parashikimet e neneve 4, 37 dhe 38 të këtij ligji. Në bazë të nenit 36, 3 (tre) institucionet: DSIK, Shërbimi Informativ Shtetëror (në vijim SHISH) dhe Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave (në vijim SHKÇBA) krijojnë një grup pune për zbatimin e këtij ligji.

Në rastin konkret, nëse do të ishte dërguar një informacion zyrtar për dyshime apo përfshirjen e një prokurori në një veprimtari kriminale dhe, për më tepër, në atë të krimit të organizuar, Prokurori i Përgjithshëm kishte detyrimin ligjor, të ndërmerre apo urdhëronte fillimin e procedurave ligjore në lidhje me informacionin zyrtar dërguar nga institucioni i verifikimit.

Nuk rezulton të jetë kryer një veprim apo procedurë e tillë në rastin konkret, çka tregon se nuk është vlerësuar prej institucionit të verifikimit si një rast për t'u sugjeruar për ndjekje penale.

Referuar raportit të DSIK-së, se: *“Subjekti i rivlerësimit \*\*\*\*\*ka pasur një kontakt të papërshtatshëm \*\*\*\*\*me një person të përfshirë në trafikun e lëndëve narkotike, ku dyshohet se Gjon Kodra mund të jetë përfshirë edhe vetë në këtë aktivitet,* është krejtësisht i pabazuar në prova dhe fakte. Nëse subjekti do të ishte i përfshirë në trafik, do të kishte vazhduar komunikimi me të nëpërmjet telefonit apo me mënyra të tjera. Fakti që rezulton vetëm një telefonatë tregon që ka qenë thjesht rastësore, jo e dalë nga subjekti, pasi po të ishte ndryshe do të kishte vazhduar komunikimi. Nuk ka informacion se çfarë përmbajtje ka ajo bisedë, nëse bëhet fjalë për trafikim të lëndëve narkotike, korrupsion apo për ndonjë vepër tjetër penale. Referuar informacionit së përcjellë nga vëzhguesi ndërkombëtar se shtetasi me të cilin është komunikuar ka qenë i dënuar në shtetin italian për veprën penale të trafikimit të lëndëve narkotike, subjekti sqaron se nuk ka pasur kurrfarë dijenie për këtë rrethanë. Gjithashtu, nuk ka pasur dijeni se PPKKO-ja kishte filluar ndonjë procedim penal në ngarkim të këtij shtetasi.

Gjatë kohës së hetimeve paraprake në kuadër të procedimit penal, nga PPKKO-ja apo dhe nga Prokuroria Antimafia e Milanos, nuk është sjellë apo referuar ndonjë informacion apo provë në lidhje me faktin se komunikimi im në një rast të vetëm midis këtij shtetasi dhe subjektit përbën implikim apo përfshirje në aktivitetet e atij shtetasi. Edhe konkluzioni i DSIK-së mbetet në



vlerësimin e Komisionit nën dritën e informacioneve të tjera që disponohen si pjesë e gjetjeve apo konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ që po kryhen ndaj subjektit të rivlerësimit. Subjekti ka shpjeguar se edhe në përgjigje të pyetësorit, me shtetasin P. A., nuk ka pasur asnjë lidhje shoqërore apo familjare. Nuk ka udhëtuar kurrë me të dhe as nuk është ulur në ambiente publike apo private me këtë shtetas. Me këtë shtetas nuk e ka lidhur asgjë, qoftë niveli arsimor, qoftë prejardhja, nuk e ka pasur fqinj në lagje apo pallat, nuk kanë pasur shokë apo miq të përbashkët, si dhe nuk ka pasur problem të karakterit të punës. Për shkak se ka kaluar një kohë e gjatë 13-vjeçare, subjekti nuk është në gjendje dhe normalisht nuk i kujtohet biseda e zhvilluar me këtë shtetas dhe një herë të vetme dhe, për më tepër, kur është telefonuar prej tij. Siç ka shpjeguar, ky shtetas ka qenë vëllai i ish-deputetit S. A. dhe njohja ka qenë rastësore. Nëse do të ishte në dijeni se ky shtetas do kishte probleme të tilla dhe nëse subjekti do kishte ndonjë marrëdhënie me të, do ta deklaronte pa hezitim marrëdhënien me të. Subjekti ka deklaruar dhe nënshkruar se nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme, i ndërgjegjshëm dhe i sigurt se nuk kam pasur asnjë dijeni për këtë fakt. Nga dëshmia e penaltetit e administruar nga Komisioni rezulton se vendimi i Gjykatës së Apelit të Milanos mban datën 3.11.2011, i cili ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së Milanos, datë 22.6.2010. Përveç rrethanës lehtësuese të konstatuar nga Komisioni, në nenin 38, pika 4, germa d, të ligjit nr. 84/2016 ku thuhet: *“Rrethanat që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, janë kur: d) subjekti i rivlerësimit merr pjesë ose është i pranishëm në takime me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar. Anëtarësia e dyshuar e personit në krimin e organizuar duhet të jetë e njohur, e publikuar ose të jetë një çështje e dokumentuar në regjistrat përkatës”*.

Subjekti thekson se nuk ka pasur asnjë lloj dijenie për këtë shtetas në përfshirjen e tij në veprimtari kriminale. Nuk ka informacion që veprimtaria e tij të jetë e bërë e njohur apo publikuar dhe dokumentuar në regjistrat përkatës të shtetit shqiptar. Fakti që ky shtetas është dënuar në vitin 2010 në shtetin italian, ndërsa komunikimi me subjektin është në vitin 2008, tregon dhe vërteton plotësisht padijeninë e subjektit për përfshirjen e shtetasit P. A., në krimin e organizuar dhe dënimin e mëvonshëm të tij. Në këto kushte, Komisioni duhet t'i mbajë parasysh këto rrethana të sipërcituara. Edhe vëzhguesi ndërkombëtar në gjetjen e tij dërguar Komisionit, ndër të tjera, shprehet se: *“Afati i shtrirë/i zgjatur do të përbënte (së bashku me elementët e tjerë specifikë sipas rastit) një rrethanë lehtësuese”*.

13.10.1 Në seancën dëgjimore, subjekti dhe mbrojtësi i tij deklaruan se i qëndronin prapësimeve të depozituar prej tyre pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni. I pyetur në seancë nga vëzhguesi ndërkombëtar se ku e kishte gjetur numrin e telefonit të shtetasit P. A., që e kishte telefonuar subjektin, ky i fundit shpjegoi se nuk kishte informacion se ku mund ta ketë marrë shtetasin P. A., numrin e tij. Subjekti shpjegoi se numri i tij është publik dhe e zotëronte prej vitesh dhe për më tepër vite më përpara në godinën e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë kishte vetëm një hyrje ku hynin si publiku për probleme të ndryshme ashtu dhe prokurorët dhe në kontakt me njerëzit në përditshmërinë e punës numri i telefonit mund të gjendej mjaft lehtë.

13.10.2 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, ka depozituar shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.11.2021, të Prokurorisë së Rrethit Tiranë, e cila konfirmon se nga verifikimi i kryer në statistikat elektronike të procedimeve penale, për periudhën 1997 – 2021, nuk rezultoi se prokurori Gjon Kodra të ketë ndjekur material kallëzuese apo procedime penale në lidhje me shtetasin P. A.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

13.11 Komisioni vëren se të dhënat në raportin e DSIK-së, referojnë për kontakt të papërshtatshëm në vitin 2008 të subjektit të rivlerësimit me një person të përfshirë në trafikun

e lëndëve narkotike, ku dyshohet se subjekti i rivlerësimit mund të jetë përfshirë edhe vetë në këtë aktivitet.

- a) Rezultoi se nga shtetasi P. A., është kryer vetëm një telefonatë në drejtim të subjektit të rivlerësimit në vitin 2008, përpara 13 vitesh (shtetasi P. A., ka telefonuar subjektin e rivlerësimit), periudhë jashtë afatit të rivlerësimit, duke e konsideruar këtë fakt si rrethanë lehtësuese. Nga organet ligjzbatuese nuk janë evidentuar telefonata të tjera ndërmjet këtyre dy shtetasve si para ashtu edhe pas telefonatës së datës 19.1.2008. Kjo telefonatë ka qenë një dhe e vetme. Megjithëse fillimisht nga telefonata të krijohet ideja se të dy shtetasit kanë njohje me njëri-tjetrin (kjo mund të ketë qenë edhe për faktin se shtetasi P. A., ka qenë vëllai i një personi publik në atë kohë, ish-deputet në Kuvendin e Shqipërisë, argument ky i përmendur edhe nga vetë subjekti), fakti që ndërmjet tyre nuk ka pasur telefonata të tjera në vazhdimësi, si dhe fakti që nga organet ligjzbatuese nuk është siguruar asnjë provë tjetër që të vërtetojë kontaktin ndërmjet tyre, e zbeh drejt nivelit zero perceptimin fillestar të Komisionit se kemi të bëjmë me një kontakt jo rastësor të subjektit me këtë shtetas.
- b) Nuk u provua nga organet ligjzbatuese apo edhe nga Komisioni që përveç telefonatës së vetme që personi P. A., ka kryer në numrin e subjektit të rivlerësimit, të jenë administruar prova të tjera (filmim, vëzhgim, fotografim, përgjim etj..) që të vërtetojnë lidhje të ngushta, implikimin apo kontaktin më shumë se një herë, në vazhdimësi, të subjektit të rivlerësimit me shtetasin P. A.
- c) Nuk ka rezultuar që nga organet ligjzbatuese të jenë referuar të dhëna në Prokurorinë e Përgjithshme për përfshirje të subjektit të rivlerësimit Gjon Kodra, në veprimtari të paligjshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, për të cilin kjo prokurori do të kishte filluar një hetim ndaj subjektit, gjithashtu, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të jetë i dënuar nga gjykatat shqiptare.
- d) Edhe pse konfirmohet një kontakt telefonik nga shtetasi P. A., me subjektin e rivlerësimit në vitin 2008, marrë në konsideratë informacionin e organeve ligjzbatuese se shtetasi P. A., ishte i përfshirë në trafikun e lëndëve narkotike, i dënuar me vendim të Gjykatës së Milanos në vitin 2010, lënë në fuqi me vendimin e Gjykatës së Apelit të Milanos, datë 3.11.2011, si edhe procedimin penal në ngarkim të tij të regjistruar në PPKKO në vitin 2007 dhe të pushuar në vitin 2009, Komisioni i vlerësoi bindëse dhe të besueshme shpjegimet e subjektit, që kanë të bëjnë me padijeninë e tij në lidhje me procedimet dhe vendimet penale në ngarkim të shtetasit P. A. (që do ta klasifikonin këtë shtetas si një kontakt të papërshtatshëm për subjektin e rivlerësimit), për sa kohë që nuk u vërtetua, si gjatë hetimit ashtu edhe nga organet ligjzbatuese, lidhja e ngushtë ndërmjet tyre, kontakte apo implikime të çfarëdolloji ndërmjet tyre dhe në vazhdimësi, aplikimi i masave ndëshkimore të mësipërme nga subjekti apo institucioni ku punon, duke e vendosur subjektin nën dritën e rrethanave lehtësuese të pasqyruara në pikën 5/a dhe d, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016<sup>94</sup>
- e) Nga autoritetet italiane është përcjellë certifikata e dëshmisë së penalitetit e vitit 2021, ku subjekti Gjon Kodra rezulton i padënuar, për rrjedhojë përjashtohet implikimi i subjektit në veprimtari të paligjshme në shtetin italian.
- f) Nga korrespondenca e kryer me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi procedime penale të regjistruara në emër të shtetasit P. A., kjo prokurori ka përcjellë në Komision 6 procedime, ku në njërin prej tyre, dosja penale nr. \*\*\*, konstatohet regjistrimi i procedimit penal, datë 8.9 2000, për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve zyrtare. Në kapakun

---

<sup>94</sup>5.a. Subjekti i rivlerësimit në mënyrë të besueshme parashtroi se nuk është në dijeni të faktit se personi është i përfshirë në krimin e organizuar e vlerësuar kjo rrethanë nga Komisioni edhe në raport me pikën 4 të nenit 38); 5.d. kontaktet e subjektit të rivlerësimit kanë qenë 5 vjet më parë dhe nuk ka ndonjë tregues që ato vazhdojnë ende....

e fashikullit të dosjes janë regjistruar emrat e prokurorëve A. Th. dhe A. C., kurse në pjesën e pasme të pjesa e vendimit të gjykatës është shënuar emri i subjektit. Nga verifikimi i kësaj dosjeje, konstatohet se të gjitha veprimet hetimore janë kryer nga dy prokurorët A. Th. dhe A. C., ku prokurori A. Th. ka marrë edhe vendimin për dërgimin e çështjes në gjyq, për shkak të provimit të fajësisë së të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet. Konkluzionet me shkrim përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku është kërkuar deklarimi fajtor i të pandehurit P. A., për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve dhe dënimit të tij me kohën e paraburgimit mbajnë firmën e subjektit të rivlerësimit. Nuk konstatohet në dosje ndonjë urdhër apo vendim i prokurorit më të lartë për zëvendësimin e prokurorëve që kanë ndjekur çështjen me subjektin e rivlerësimit çka e bën paraqitjen e konkluzioneve në gjykatë me firmën e subjektit thjesht një formalitet për mos humbjen e seancës gjyqësore.

Nisur nga fakti që kjo çështje është regjistruar në emër të dy prokurorëve të tjerë, ku njëri prej tyre ka marrë edhe vendimin për dërgimin e çështjes në gjyq, fakti i depozitimit formalisht të konkluzioneve në gjykatë me firmën e subjektit, kërkesës së subjektit për dënim me burg të shtetasit P. A., faktit se kjo çështje është filluar shumë kohë më parë telefonatës së datës 19.1.2008 (çështja është regjistruar në vitin 2000 dhe është përfunduar në vitin 2001), përveç ushtrimit të detyrës nga ana e subjektit të rivlerësimit, nuk vërteton asnjë *indicie*, fakt apo provë që të vërtetojë njohjen personale të subjektit me shtetasin P. A. dhe aq më tepër kontakte apo lidhje të ngushtë mes tyre dhe në vazhdimësi.

- g) Nga verifikimi i mediave elektronike, konstatohet se shtetasi P. A., është vrarë në muajin maj të vitit 2011.
- h) Vetë organi i DSIK-së nuk ka konstatuar përfundimisht papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës, por konsiderimin nga ana e Komisionit të rrethanës lehtësuese në vendimmarrjen e tij, bazuar në nenin 38, pika 5/d, të ligjit nr. 84/2016.
- i) Po kështu edhe nga vëzhguesi ndërkombëtar vlerësohet se efekti i kohës së largët konsiderohet si rrethanë lehtësuese në vlerësim të komponentit të figurës.

Komisioni, nisur nga vlerësimi tërësor i rrethanave, fakteve, provave dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me kriterin e figurës, vlerëson se pavarësisht se shtetasi P. A., rezulton të ketë qenë person i përfshirë në krimin e organizuar, nuk rezulton e provuar në mënyrë të pakundërshtueshme që ky person të ketë qenë një kontakt i papërshtatshëm për subjektin e rivlerësimit. Ekzistenca e një telefonate në janar të vitit 2008 nga shtetasi P. A., në drejtim të subjektit, përveçse kohës së largët kur ka ndodhur dhe faktit se shtetasi P. A., ka ndërruar jetë në vitin 2011, konstatohet të jetë një dhe e vetme dhe, për rrjedhojë, rastësore dhe nuk është vërtetuar që subjekti të ketë pasur kontakte të tjera të drejtpërdrejta apo të tërthorta dhe në vazhdimësi me këtë shtetas, si dhe fakti që në kohën e telefonatës në vitin 2008 nuk kishte asnjë informacion që shtetasi P. A., ishte i përfshirë në veprimtari kriminale të trafikut ndërkombëtar të drogës. Subjekti i rivlerësimit ka qenë në padijeni të plotë të situatës ligjore të këtij personi dhe, për rrjedhojë, nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për pasje kontakti të papërshtatshëm dhe mosdeklarim të tij në deklaratën e kontrollit të figurës.

Komisioni vlerëson se duke marrë në konsideratë argumentet si më sipër, ekzistenca e një telefonate të vetme, pavarësisht përmbajtjes, nuk mund të arrijë një shkallë thelbësore dhe përcaktuese në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit, qoftë për kriterin e figurës apo vlerësimin tërësor të tij në kuadër të cenimit të besimit të publikut, deri në atë masë sa që ndaj tij të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm për kriterin e figurës dhe sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit

të Kushtetutës, duke konfirmuar kështu përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Gjon Kodra.

### C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

**14.** Rivlerësimi profesional, sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, është i bazuar në raportin e përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), si organi ndihmës për vlerësimin profesional dhe kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit<sup>95</sup>. Ky organ ka hartuar raportin vlerësues nr. \*\*\* prot., datë 8.7.2020, për subjektin Gjon Kodra.

14.1 Në raportin e Komisionit të Vlerësimit pranë KLP-së për subjektin e rivlerësimit janë evidentuar në nivele të mira aftësitë profesionale<sup>96</sup>, aftësitë organizative<sup>97</sup>, etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale<sup>98</sup> dhe aftësitë personale dhe angazhimi profesional<sup>99</sup>.

14.2 Subjekti i rivlerësimit Gjon Kodra, me vendim të Prokurorit të Përgjithshëm, është vlerësuar për punën e kryer prej tij, aftësitë e tij profesionale dhe etike për vitet 2014, 2015 dhe 2016, me “shumë mirë”.

#### 14.3 Tri dokumentet e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit

i) Dokumenti 1 – diskutim përfundimtar i paraqitur përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për çështjen penale nr. \*\*\* të vitit 2015.

ii) Dokumenti 2 – apel kundërshtues kundër ankimit të vendimit nr. \*\*\*, datë 24.3.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të ushtruar nga i pandehuri G. M., që i përket procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2015.

iii) Dokumenti 3 – kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2016.

Komisioni vëren se nga analiza e kryer për këto 3 dokumente ligjore, si nga grupi i punës pranë KLP-së, ashtu edhe nga Komisioni, nuk u konstatuan problematika që ngarkojnë me përgjegjësi disiplinore subjektin e rivlerësimit.

#### 14.4 Pesë dosjet gjyqësore të përzgjedhura me short referuar raportit të komisionit të vlerësimit pranë KLP-së

---

<sup>95</sup>Bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.”

<sup>96</sup>Ku përfshihen: a) *Njohuritë ligjore* – subjekti Gjon Kodra ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit; b) *Arsyetimi ligjor* – subjekti i rivlerësimit ka aftësi në arsyetimin ligjor të akteve.

<sup>97</sup>Ku përfshihen: a) *Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë* – rezulton se subjekti Gjon Kodra ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës, ku i ka kryer hetimet, si dhe drejtuar e kontrolluar veprimtarinë hetimore brenda një afati të arsyeshëm; b) *Aftësia për të kryer procedurat hetimore/gjyqësore* – rezulton se prokurori ka kryer veprimet e duhura hetimore në kohë të arsyeshme; c) *Aftësia për të administruar dosjet* – prokurori ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve, rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar në dosjet përkatëse.

<sup>98</sup>Ku përfshihen: a) *Etika në punë* – konstatohet nivel i pëlqyeshëm përgjegjshmërie në administrimin korrekt me kolegët, por njëkohësisht edhe sjellja ndaj eprorëve, vartësve, administratës etj.; b) *Integriteti* – nuk ka të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm, si dhe gjatë periudhës së rivlerësimit nuk ka pasur masa disiplinore; c) *Paanësia* – nuk janë evidentuar raste konflikti interesi apo papajtueshmëri për pjesëmarrje në procedime.

<sup>99</sup>Ku përfshihen: a) *Aftësitë e komunikimit* – bashkëpunimi, sjellja ndaj eprorëve, kolegëve, administratës ka qenë korrekte, duke respektuar dinjitetin dhe personalitetin e tyre; b) *Aftësia për të bashkëpunuar* – ka cilësi të mira bashkëpunuese dhe tregohet i gatshëm të punojë në grup dhe me agjenci të tjera ligjzbatuese; c) *Gatishmëria për t'u angazhuar* – në periudhën objekt vlerësimi subjekti nuk ka paraqitur të dhëna mbi angazhimin e tij në aktivitete profesionale.

i) Dosja 1 – kallëzimi penal nr. \*\*\*, datë 23.10.2015, i mosfilluar në datën 17.11.2015, i hetuar nga subjekti Gjon Kodra, në cilësinë e prokurorit të çështjes.

ii) Dosja nr. 2 – dokumentin ligjor, procedimi penal nr. \*\*\*, datë 5.11.2014, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pushuar në datën 31.12.2014.

iii) Dosja 4 – procedimi penal nr. \*\*\*, datë 12.6.2013, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dërguar për gjykim në datën 18.10.2013, në ngarkim të të pandehurit D. M., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “vjedhje”, të parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal.

iv) Dosja 5 – procedimi penal nr. \*\*\*, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në ngarkim të të pandehurit K. Z., i akuzuar për kryerjen e veprave penale “vrasje me dashje” dhe “mbajtje pa leje e armëve luftarake”, parashikuar nga nenet 76 dhe 278/3 të Kodit Penal.

Komisioni vëren se nga Grupi i Punës pranë KLP-së, si edhe pas administrimit të dokumentacionit nga Komisioni, nuk konstatohen problematika në 4 dosjet e përzgjedhura me short, për sa i përket kriterit profesional.

v) Dosja 3 – dokumenti ligjor “procedimi penal nr. \*\*\*, datë 4.5.2016, regjistruar për veprën penale “prodhim dhe shitje të narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit N. P., pushuar në datën 6.6.2016, i hetuar nga prokurori Gjon Kodra, në cilësinë e prokurorit të çështjes.

Ky procedim i referohet materialit referues nga Komisariati i Policisë nr. \*\*\* për arrestimin në flagrancë të shtetasit N. P., për veprën penale “prodhim dhe shitje të narkotikëve” me datë 3.5.2016, pasi i është kapur një qese me lëndë narkotike të dyshuar si e llojit *cannabis sativa* me peshë 2.20 gr<sup>100</sup>.

Në datën 6.6.2016 subjekti i rivlerësimit Gjon Kodra ka marrë vendimin “Mbi pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 4.5.2016”, me argumentin se *nisur nga procesverbali i përshkrimit dhe peshimit të provës materiale të sekuestruar, si dhe konkluzioneve të aktit të ekspertimit toksikologjik, rezulton se shtetasi N. P. ka mbajtur për përdorim vetjak lëndë narkotike në doza të vogla dhe, për rrjedhojë, nuk duhet të përgjigjet penalisht për veprën penale të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.*

Subjekti ka argumentuar se: *“Në rastin konkret rezulton të ndodhemi para kriterëve të vendosura në nenin 328, germa ‘ç; e Kodit Penal. Për rrjedhojë, hetimet e këtij procedimi penal duhet të pushohen, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale”.*

14.4.1 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konkluduar se aktekspertimi toksikologjik i datës 30.5.2016 ka përcaktuar vetëm praninë e elementeve *cannabis sativa* në mostrën e urinës së shtetasit N. P. Nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk është urdhëruar kryerja e një aktekspertimi nga ekspert të fushës për të përcaktuar nëse sasia prej 2.20 gram, e kapur personit nën hetim N. P. është për përdorim vetjak apo jo. Në fashikullin penal nuk rezulton të jetë marrë vendim nga subjekti për kryerjen e një ekspertimi të tillë. Në vendimin e pushimit të procedimit penal nuk gjejmë të pasqyruar argumentin se mbi ç’bazë subjekti i rivlerësimit ka vlerësuar se sasia 2.20 gram është sasi për përdorim personal.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 1, datë 27.3.2008, ndër të tjera, arsyetojnë: *“Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë [...] çmojnë gjithashtu se përcaktimi i*

---

<sup>100</sup>Pasi janë kryer veprimet procedurale nga OPGJ-ja e komisariatit (pyetja e personit në hetim, vendim për kryerje ekspertimi toksikologjik të shtetasit N. P., kontroll banese e personit nën hetim etj.) dhe materialet iu referuan Prokurorisë së Rrethit Tiranë. Subjekti Gjon Kodra, në cilësinë e prokurorit të çështjes, në datën 4.5.2016 ka përpiluar urdhrin e regjistrimit të procedimit penal për veprën penale “prodhim dhe shitje të narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit N. P. Janë bërë disa veprime procedurale nga subjekti Gjon Kodra (vendim për vleftësim sekuestro, administrim i aktekspertimit toksikologjik të shtetasit N. P., etj.)

*dozës së vogël të lëndës narkotike e psikotrope, për efekt të zbatimit të dispozitës së nenit 283 të Kodit Penal, duhet të bëhet me ndihmën e specialistëve të fushës (toksikologë etj.) të thirrur si ekspertë dhe rast pas rasti jo vetëm sipas llojit të lëndës narkotike e psikotrope, por edhe të cilësive fiziko-biologjike dhe shkallës së vartësisë nga droga të personit konkret-mbajtës i lëndës narkotike dhe psikotrope”.*

14.4.2 Konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka marrë mendimin e një eksperti të fushës (bërja e një akti toksikologjik) për të përcaktuar nëse sasia 2.20 gram e lëndës narkotike të kapur është sasi për përdorim vetjak apo jo, sipas përcaktimeve të vendimit të Gjykatës së Lartë.

Për konstatimin e mësipërm, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Kushtetutës.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

14.4.3 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, ka shpjeguar se në Prokurorinë e Rrethit Tiranë prej vitesh është konsoliduar praktika për qëndrimin që duhet mbajtur për veprën penale “prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike”, të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal. Kur nga organi i policisë dërgohen materiale referuese për këtë vepër penale, kryesisht për lëndën narkotike të llojit *canabis sativa* në sasi të vogla, praktika në Prokurorinë e Rrethit Tiranë është vendosur që për sasinë deri 3-4 gram procedohet me mosfillim kur provohet se shtetasi është përdorues i kësaj lënde dhe nuk rezulton të jetë shitës i saj. Ndërsa, kur organi i policisë ka proceduar me arrestimin e shtetasit që ka mbajtur këtë lloj lënde narkotike kur sasia është deri në 3 gr, është proceduar me kërkesë për pushimin e procedimit penal dhe kërkesat janë miratuar nga gjykata.

Në rastet kur lënda e sekuestruar është e llojit kokainë ose heroinë, pavarësisht sasisë, në të gjitha rastet kryhet aktekspertimi mjekoligjor për të saktësuar nëse kjo sasi është me një përdorim dhe është ose jo e dëmshme për shëndetin. Në varësi të aktit mjekoligjor procedohet me kërkesë për pushim apo me kërkesë për gjykim.

Në prapësime e tij subjekti ka depozituar: kërkesë për pushim çështjeje të procedimit nr. \*\*\* për veprën penale “prodhim dhe shitje të lëndës narkotike”, ku personit të dyshuar i janë sekuestruar 4.2 gram lëndë *canabis sativa*; vendim mosfillimi i procedimit penal i kallëzimit nr. \*\*\*; ku subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për personin e dyshuar për të njëjtën vepër penale ku i është sekuestruar 2 gram lëndë *canabis sativa*; vendim mosfillim hetimesh për kallëzimin penal nr. \*\*\* i prokurorit J. Xh. për personin e dyshuar për të njëjtën vepër penale ku i është sekuestruar sasia 2.4 gram lëndë *canabis sativa*.

Edhe në seancë dëgjimore subjekti i rivlerësimit ka dhënë të njëjtat shpjegime me ato të dhëna në prapësimet e tij.

#### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

14.4.4 Nga verifikimi i dokumentacionit të ndodhur në dosje, vërtetohet se lënda narkotike e sekuestruar nga Policia e Shtetit është e dyshuar e llojit *cannabis sativa*, e cila pas peshimit po nga ky organ rezulton të jetë në masën 2.2 gram.

14.4.5 Komisariati i Policisë nr. \*\*\*; më pas, ka marrë vendim për kryerjen e ekspertimit kimik të lëndës së sekuestruar shtetasit N. P., si dhe vendim për kryerjen e ekspertimit toksikologjik të këtij shtetasi.

14.4.6 Nga akti i ekspertimit toksikologjiko - ligjor nr. \*\*\*; i dërguar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, rezulton se në mostrën e urinës, objekt ekspertimi marrë këtij shtetasi, u zbuluan njolla të pranisë së produkteve të lëndës *cannabis sativa*. Pra, vërtetohet se shtetasi N. P. është përdorues i *cannabis sativa*. Në akt nuk ka të dhëna që ky shtetas të jetë përdorues edhe i llojeve të tjera të lëndëve narkotike. Në dosje nuk gjendet i depozituar aktekspertimi kimik.

14.4.7 Aplikimi i të njëjtës praktikë hetimi, i të njëjtave konkluzione dhe i të njëjtës vendimmarrje, për raste të njëjta apo të ngjashme, jo vetëm nga subjekti, por edhe nga prokurorë të tjerë, sipas praktikave të ngjashme të vëna në dispozicion nga subjekti, të çon në konkluzionin se kemi të bëjmë me një praktikë të konsoliduar, të njëjtë apo të ngjashme, hetimi, konkludimi dhe vendimmarrjeje për këto raste.

14.4.8 Pavarësisht kësaj dhe pavarësisht se është i vërtetuar fakti se kemi të bëjmë me një lëndë *cannabis sativa* në masë të vogël prej 2.2 gram dhe se shtetasi N. P. është përdorues i saj, Komisioni çmon se kryerja e aktekspertimit kimik ishte i nevojshëm për përcaktimin e saktë të llojit të lëndës narkotike, masën e saj dhe përcaktimit të limitit nëse ishte për përdorim vetjak.

Komisioni vlerëson se, pavarësisht aplikimit të një praktike hetimi dhe vendimmarrjeje të konsoliduar për raste të së njëjtës natyrë, nga ana e organit të akuzës ku subjekti është i punësuar, e cila vlerësohet si një rrethanë lehtësuese, moskryerja e aktekspertimit kimik vlerësohet si një mangësi procedurale, por duke marrë në konsideratë faktin se ky është një rast i vetëm në vlerësimin e kriterit profesional dhe në dosje rezultojnë të jenë kryer veprime të konsiderueshme procedurale që kanë orientuar subjektin në vendimmarrje, kjo shkelje nuk mund të vlerësohet deri në atë masë sa ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra për mangësi profesionale, në kuptim të pikës 4, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 apo cenim të besimit të publikut, në aplikim të nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016.

## 15. Të dhënat arkivore - ankesat dhe masat disiplinore

15.1 Drejtoria e Menaxhimit të Dokumentacionit<sup>101</sup> pranë Prokurorisë së Përgjithshme konfirmon se për subjektin Gjon Kodra, për periudhën 2006 – 2019, nuk rezulton që të ketë masa disiplinore.

15.2 Drejtoria Njerëzore dhe e Shërbimeve konfirmon se për subjektin e rivlerësimit Gjon Kodra, me urdhrin nr. \*\*\*, datë 26.2.2002, të Prokurorit të Përgjithshëm, për shkeljet e kryera ka marrë masë disiplinore “vërejtje”, pasi gjatë ushtrimit të detyrës ka kryer shkelje të ligjit në hetimin dhe gjykimin e 3 procedimeve penale të vitit 2000 dhe 7 procedimeve penale të vitit 2001. Për masën disiplinore subjekti Gjon Kodra ishte dakord dhe nuk pranoi të paraqitej në mbledhjen e Këshillit të Prokurorisë.

15.3 Sekretaria Sekrete<sup>102</sup> pranë Prokurorisë së Përgjithshme konfirmon se që nga viti 2012 (vit kur është krijuar sekretaria sekrete) e në vazhdim, nuk ka ndonjë të dhënë apo *indicie* të ardhur nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve ndaj tij.

15.4 Sektori i protokoll-arkivit<sup>103</sup> konfirmon se gjatë viteve 2006 - 2019 rezultojnë 4 ankesa ndaj subjektit të rivlerësimit, të cilat janë trajtuar nga Prokuroria e Përgjithshme<sup>104</sup>.

<sup>101</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2020.

<sup>102</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.1.2020.

<sup>103</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 31.1.2020.

<sup>104</sup>Praktika nr. \*\*\* e vitit 2009, nga avokat S. V. Në ankesën e tij avokati S. V., si përfaqësues i palëve në proces, ngre pretendimin se është kërcënuar nga prokurori Gjon Kodra. Nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme avokatit S. V. i është sugjeruar se nëse e çmon se nga prokurori janë konsumuar elementet e ndonjë vepre penale mund të paraqesë kallëzim sipas ligjit, por edhe nga Prokuroria e Përgjithshme do të mbahet parasysh kjo problematikë e ngritur; praktika nr. \*\*\* e vitit 2013, nga shtetasi E. M., i cili denoncon subjektin Gjon Kodra për korrupsion dhe se ka shkelur ligjin. Gjithashtu, shtetasi E. M. ka bërë ankim ndaj vendimit të pushimit të procedimit penal, për të cilin i është dhënë përgjigje më parë. Ankuesi është sqaruar nga Prokuroria e Përgjithshme që në lidhje me ankimin e bërë prej tij, përderisa është ankuar në gjykatë dhe vendimi i pushimit është lënë në fuqi nga gjykata, nuk mund të shfuqizohet vendimi i pushimit të çështjes së regjistruar mbi bazën e kallëzimit tuaj; praktika nr. \*\*\* e vitit 2016, nga shoqata “\*\*\*”, e cila ankohet për një vendim mosfillimi procedimi penal i subjektit Gjon Kodra. Prokuroria e Përgjithshme i ka komunikuar kësaj shoqate se kundërshtimi i vendimit të mosfillimit të procedimit penal të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk mund të jetë objekt i shqyrtimit në rrugë hierarkike; praktika nr. \*\*\* e vitit 2014, nga shtetasi S. L., i cili kërkon ndërprerjen e veprimeve të kundërligjshme

15.5 Prokuroritë e rretheve gjyqësore<sup>105</sup> konfirmojnë se nuk disponohen të dhëna nga agjencitë ligjzbatuese dhe nuk ka procedim disiplinor apo kallëzim të regjistruar në lidhje me subjektin Gjon Kodra.

## 16. Të dhëna nga organi i prokurorisë

16.1 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>106</sup> konfirmon se ndaj subjektit Gjon Kodra ka paraqitur kallëzim shtetasi N. L.<sup>107</sup>, kallëzim që është dërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila, pas veprimeve hetimore të kryera, ka vendosur “pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. \*\*\*, datë 8.6.2016” për veprën penale “shpërdorim detyre”. Ndaj vendimit të prokurorisë “për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 22.9.2016” është bërë ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila, me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.1.2017, ka vendosur “të mos pranojë ankimin e datës 11.10.2016” me objekt ankim kundër vendimit të pushimit të hetimeve të procedimit penal, datë 22.9.2016, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, vendim ky i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. \*\*\*, datë 7.7.2017.

16.2 Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar<sup>108</sup> konfirmon se ndaj subjektit Gjon Kodra është regjistruar kallëzimi penal nr. \*\*\* i vitit 2016 pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda, me kallëzues dy shtetas të cilët janë dënuar nga kjo gjykatë me burgim (5 dhe 3.6 vjet) për veprën penale “plagosje të rëndë me dashje”, duke pretenduar veprime korruptive të subjektit Gjon Kodra. Ndaj këtij kallëzimi pas veprimeve hetimore të kryera kjo prokurori ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Ndaj vendimit të mosfillimit të prokurorisë ka bërë ankim ankuesi B. K. në Gjykatën e Shkallës së Parë Për Krime të Rënda, e cila, me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.11.2016, ka vendosur “rrezimin e kërkesës”. Nuk ka informacion nëse ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Apelit.

## 17. Denoncime/ankesa nga publiku

Ndaj subjektit të rivlerësimit janë depozituar 12 denoncime/ankesa nga publiku.

### 17.1 Për denoncimet/ankesat:

---

të prokurorisë në kallëzimin që është paraqitur ndaj tij në këtë prokurori. Prokuroria e Përgjithshme i ka komunikuar ankuesit se nga prokuroria e rrethit po kryhen veprime verifikuese dhe në përfundim të tyre do të njiheni me vendimin që do merret. Ndaj vendimit të prokurorit ankuesi ka të drejtën e ankimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe tek Prokurori i Përgjithshëm.

<sup>105</sup>Shkresat: nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2020, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat; nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2020, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Përmet; nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2020, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë; nr. \*\*\* prot., datë 15.1.2020, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat; nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2020, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbini; nr. \*\*\* prot., datë 16.1.2020, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tropojë; nr. \*\*\* prot., datë 15.1.2020, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lushnjë; nr. \*\*\* prot., datë 15.1.2020, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë; nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2020, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan; nr. \*\*\* prot., datë 17.1.2020, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës; nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2020, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier; nr. \*\*\* prot., datë 17.1.2020, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër; nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2020, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër; nr. \*\*\* prot., datë 21.1.2020, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë; nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2020, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. \*\*\* prot., datë 17.1.2020, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pukë; nr. \*\*\* prot., datë 21.1.2020, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë; nr. \*\*\* prot., datë 28.9.2020, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë; nr. \*\*\* prot., datë 30.1.2020, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë; dhe nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2020, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

<sup>106</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.5.2020, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>107</sup>Shtetasi N. L. ka kërkuar ndjekjen penale për prokurorët S. S., E. K. dhe Gjon Kodra për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pasi kallëzuesit kanë pretenduar se nuk janë kryer hetime dhe verifikimet përkatëse nga prokurorët e sipërcituar që janë marrë me hetimin e kësaj çështjeje, të cilët kanë vendosur mosfillimin e procedimit penal.

<sup>108</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.1.2020, e PPKKKO-së.



- 1) nr. \*\*\* prot., datë 19.2.2018, i shtetasit H. H., i cili ngre ankesë ndaj subjektit Gjon Kodra për vendimin e mosfillimit të procedimit penal për kallëzimin e tij, për veprime korruptive në bashkëpunim me ekspertë të një çështjeje civile;
- 2) nr. \*\*\* prot., datë 24.8.2018, i shtetasit G. R., i cili ngre pretendimin se subjekti i rivlerësimit Gjon Kodra ka marrë një vendim mosfillimi pa pyetur kallëzuesin, duke e referuar si dëmtime të tjera me dashje çështje që ndiqet në gjykatë, ku rezulton se është gjykuar nga gjykata;
- 3) nr. \*\*\* prot., datë 26.7.2019, i shtetas K. T., e cila ngre pretendimin se subjekti ka bashkëpunuar me gjyqtarët që e kanë dënuar me burg djalin e saj;
- 4) nr. \*\*\* prot., datë 15.10.2019, e shtetasit T. Gj., i cili ka pretenduar se subjekti Gjon Kodra ka ndjekur metoda të paligjshme bashkë me OPGJ-në;
- 5) nr. \*\*\* prot., datë 30.8.2019, e shtetasit F. O., i cili ngre ankesë ndaj disa subjekteve, përfshirë edhe subjektin Gjon Kodra, për çështjen e prishjes së banesës së tij nga IMT-ja, ku subjekti Gjon Kodra ka marrë vendim mosfillimi ndaj kallëzimit të bërë për arsye se është konflikt me natyrë administrative/civile;
- 6) nr. \*\*\* prot., datë 21.11.2019, e shtetas B. B., e cila i është drejtuar me një memo subjektit Gjon Kodra për procesin ku ajo është marrë si e pandehur, duke i parashtruar disa kërkesa që subjekti t'i ketë parasysh gjatë hetimit;
- 7) nr. \*\*\* prot., datë 13.1.2021, e shtetasit K. M., i cili në ankesën e tij referon numra vendimesh, duke shënuar emrat e subjekteve përbri, por nuk ka referuar shkelje konkrete për subjektin Gjon Kodra;
- 8) nr. \*\*\* prot., datë 9.7.2018, i shtetasit D. T., i cili ngre ankesë ndaj disa subjekteve për një çështje të kallëzuar prej tij dhe njëkohësisht kallëzim ndaj tij. Për subjektin Gjon Kodra ngre pretendime për komunikim jo etik gjatë procesit të hetimeve për çështjen ku ai ishte kallëzues. Ankuesi nuk ka bashkëlidhur ndonjë dokument apo provë për të provuar pretendimin e tij.

Komisioni vëren se pas analizës së këtyre denoncimeve, si dhe dokumentacionit bashkëlidhur nga denoncuesit, nuk ka konstatuar *indicie* apo prova që e ngarkojnë subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi disiplinore, referuar kriterit profesional.

#### 17.2 Për denoncimet/ankesat:

(9 dhe 10) me nr. \*\*\* prot., datë 24.11.2017, dhe nr. \*\*\* prot., datë 22.6.2021, të shtetasve N. L. dhe M. L., të cilët pretendojnë se subjekti Gjon Kodra ka zvarritur hetimet dhe nuk ka kryer detyrat të lëna nga gjykata<sup>109</sup>, Komisioni ka administruar dosjen e procedimit penal nr. \*\*\*, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale “shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”<sup>110</sup>, si dhe vendimin gjyqësor nr. \*\*\* akti, datë 8.2.2008, të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pas verifikimit të dokumentacionit rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka shtyrë hetimet me 6 muaj për shkak të mosdorëzimit në kohë nga institucioni i IML-së i akteve të ekspertimit. Gjithashtu, rezultoi se në lidhje me detyrat e lëna nga gjykata, si kryerja e një akteksptimi auto-teknik me grup ekspertësh dhe kryerja e një akti mjekoligjor të kufomës me grup ekspertësh, nga dokumentacioni në dosje rezulton se këto veprime janë kryer nga subjekti i rivlerësimit në përmbushje të detyrës së tij<sup>111</sup>.

<sup>109</sup>Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, me vendimin nr. \*\*\* akti, datë 8.2.2008, ka vendosur “prishjen e vendimit të prokurorisë nr. \*\*\* dhe vazhdimin e mëtejshëm të hetimeve”, duke caktuar disa detyra: së pari, kryerja e një akti tjetër ekspertimi auto-teknik me grup ekspertësh që të sqarohet një herë e mirë a qëndron vepra penale e shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor; dhe së dyti, duhet bërë ekzaminimi përsëri i kufomës për të parë nëse viktima ka dëmtime të tjera me armë zjarri apo me mjete të tjera në pjesën e pasme të kokës dhe pjesë të tjera të trupit që nuk janë shkaktuar si pasojë e aksidentit dhe për këtë del e nevojshme zhvarrimi i kufomës dhe akti i ri duhet të realizohet nga një grup ekspertësh.

<sup>110</sup>Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.10.2021, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>111</sup>Shihni aktet në fashikullin penal: akteksptimin auto-teknik nga një grup ekspertësh, ku me aktin e datës 15.8.2008, konkluduar se shkaktar i aksidentit ka qenë këmbësori që ka prerë rrugën dhe jo drejtuesi i automjetit. Gjithashtu, subjekti Gjon Kodra ka marrë vendim për këqyrje të kufomës dhe ka urdhëruar kryerjen e një akti

11) nr. \*\*\* prot., datë 26.9.2018, i shtetases V. T., e cila ngre ankesë ndaj subjektit Gjon Kodra për zvarritje hetimesh dhe se nuk e ka njoftuar se çfarë është bërë me kallëzimin e saj. Komisioni ka administruar fashikullin e kallëzimit penal nr. \*\*\*, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>112</sup>, ku rezulton se subjekti ka marrë vendim për mosfillimin e procedimit penal, pasi ka rezultuar se denoncuesja V. T. ka paraqitur pranë kësaj prokurorie më parë edhe 3 kallëzime të njëjta me këtë kallëzim, kundër shtetases L. T., të cilat janë pushuar nga prokuroria dhe lënë në fuqi nga gjykatat. Rezulton se vendimi i është përcjellë Drejtuesit të Prokurorisë për konfirmim dhe ky i fundit, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.7.2017 “dërgim vendimi mosfillimi të procedimit penal”, drejtuar shtetases V. T. me adresë: rr. “\*\*\*”, pranë kompleksit \*\*\*, pallati \*\*\*, Tiranë, është bërë njoftimi. Nga shërbimi postar është kthyer njoftimi “adresë e pasaktë”.

12) nr. \*\*\* prot, datë 18.1.2018, i shtetasi I. Th., i cili ngre ankesë ndaj subjektit Gjon Kodra se i ka pushuar padrejtësisht çështjen dhe se subjekti nuk e ka vënë në dijeni për vendimin. Komisioni ka administruar fashikullin penal nr. \*\*\*, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>113</sup>, si dhe librin e protokollit. Ka rezultuar se subjekti ka marrë vendim për pushim procedimi, pasi kallëzimi është i natyrës civile që zgjidhet nga gjykata, ashtu siç ka zgjidhur njëren prej këtyre marrëdhënieve. Nga libri i protokollit ka rezultuar se shtetasi I. Th. është njoftuar për vendimin e pushimit të procedimit në adresën e lënë prej tij.

**Komisioni vëren se lidhur me denoncimet/ankesat e mësipërme, nisur nga pretendimet për shkelje procedurale nga subjekti i rivlerësimit, administroi dosjet përkatëse dhe pas verifikimit u konstatua se subjekti nuk ka kryer shkeljet e pretenduara. Komisioni nuk konstatoi *indicie* apo prova për ta ngarkuar subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi disiplinore për kriterin e aftësive profesionale.**

### KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjyqësor, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, kreut IV dhe nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludoi se subjekti i rivlerësimit Gjon Kodra:

- a) Ka kryer deklaram të mjaftueshëm dhe në vlerësim tërësor të saktë të pasurisë, duke u konstatuar pasaktësi të karakterit minimal (mosdeklarimi i pjesës takuese të pasurive të luajtshme e të paluajtshme të tij dhe të bashkëshortes dhe mosdeklarimi i burimit të krijimit/të ardhurave në deklaratat e pasurisë), konsiderohen si pasaktësi me peshë minimale dhe që nuk kanë pasur për qëllim fshehje pasurie.

Nga analiza financiare rezulton se me të ardhurat e fituara dhe shpenzimet e kryera, subjekti dhe personi i lidhur me të, bashkëshortja, kanë rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme në shumën 908,163 lekë, për periudhën 2003 – 2016, balancë e cila, bazuar në parimin e proporcionalitetit, nuk përbën shkak të mjaftueshëm për aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit të subjektit të rivlerësimit, sipas pikës 1, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

---

mjeko-ligjor të kufomës me një grup ekspertësh, ku me aktin e datës 24.5.2008 kanë konkluduar se dëmtimet e konstatuara në kufomën e skeletizuar të viktimës janë karakteristike për traumat e ndodhura brenda kabinës së automjetit të përfshirë në një aksident automobilistik. Bazuar në aktekspertimet e bëra sipas detyrave të gjykatës, prokurori Gjon Kodra, me vendimin e datës 3.9.2008, ka vendosur “pushimin e procedimit penal nr. \*\*\* për mungesë provash për fajësinë e të pandehurit A. N.”.

<sup>112</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 5.10.2021, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>113</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 5.10.2021, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- b) Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit Gjon Kodra ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- c) Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, trupi gjykues çmon se referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë”, duke arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Gjon Kodra, prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 21.12.2021.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Valbona SANXHAKTARI**  
**Kryesuese**

**Olsi KOMICI**  
**Relator**

**Xhensila PINE**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Olsida Goxhaj*